


Behxhet Mustafa, Avni Hajdari, Shpresa Sojeva-Mustafa

Biologjia

Për klasën e tetë të arsimit të mesëm të ulët

Libri i mësimdhënësit/es

8



PËRMBAJTJA

Parathënie	5
Temat mësimore të shpërndara gjatë muajve (planifikimi vjetor).....	6-7
PERIUDHA I	
Planifikimi dymujor: shtator—tetor	7-12
Planifikimi dymujor: nëntor—dhjetor	13-16
PERIUDHA II	
Planifikimi tremujor: janar—shkurt—mars	17-22
PERIUDHA III	
Planifikimi tremujor: prill—maj—qershor.....	23-29
PLANIFIKIMI I ORËS MËSIMORE	30-118

PJESA E PARË

QELIZA - NDËRTUESJA THEMELORE E GJALLESAVE

QELIZAT PROKARIOTE DHE QELIZAT EUKARIOTE

VEÇORITË FIZIKE DHE KIMIKE TË QELIZËS

QELIZAT JAPIN INDET

NGA INDET TE ORGANET DHE SISTEMET E ORGANEVE

PJESA E DYTË

NDËRTIMI DHE FUNKSIONI I INDEVE, ORGANEVE DHE SISTEMIT TË

ORGANEVE TE SHTAZËT PAKURRIZORE

NDËRTIMI DHE FUNKSIONI I INDEVE, ORGANEVE DHE SISTEMIT TË

ORGANEVE TE SHTAZËT KURRIZORE

INDET, ORGANET DHE SISTEMET E ORGANEVE MUSKULORE

INDET, ORGANET DHE SISTEMET E ORGANEVE TË TRETJES TE SHTAZËT

PAKURRIZORE

INDET, ORGANET DHE SISTEMET E ORGANEVE TË TRETJES TË SHTAZËVE

KURRIZORE

SËMUNDJET E ORGANEVE TË TRETJES

**SISTEMI I QARKULLIMIT TË LËNGJEVE TRUPORE - GJAKUT TE SHTAZËT
DISA NGA SËMUNDJET E GJAKUT, ZEMRËS DHE ENËVE TË GJAKUT
TRANSFUZIONI I GJAKUT DHE GRUPET E GJAKUT
SËMUNDJET IMUNOLOGJIKE DHE SISTEMI IMUNITAR
SISTEMI I ORGANEVE TË FRYMËMARRJES TE SHTAZËT
SËMUNDJET E RRUGËVE TË FRYMËMARRJES DHE MUSHKËRIVE
SISTEMI I ORGANEVE TË TAJITJES (EKSKRETIMIT)
MBULESA TRUPORE TE GRUPET E NDRYSHME TË SHTAZËVE
SISTEMI NERVOR - KOORDINATOR I FUNKSIONEVE JETËSORE
SHQISAT - SISTEM I ORGANEVE NDIJORE
SISTEMI ENDOKRIN
SISTEMI I RIPRODHIMIT TE SHTAZËT**

PJESA E TRETË

**INDET E BIMËVE
ORGANET DHE SISTEMET E ORGANEVE TË BIMËVE
BIMËT JOENËZORE DHE ENËZORE PA FARA
BIMËT ME FARË TË ZHVESHUR
BIMËT ME FARË TË VESHUR
RIPRODHIMI I BIMËVE ME FARË TË VESHUR
SI FORMOHEN FARAT DHE FRUTAT**

PJESA E KATËRT

**USHQIMI DHE SHËNDETI I NJERIUT
LËNDËT USHQYESE QË SIGUROJNË ENERGJI
LËNDËT USHQYESE QË NUK SIGUROJNË ENERGJI
USHQIMI JO I SHËNDETSHËM DHE JO I RREGULLT - ME PASOJA TË MËDHA**

PJESA E PESTË

NDËRTIMI DHE FUNKSIONI I ORGANEVE RIPODHUESE TE NJERIU

**METODAT DHE MJETET E PARANDALIMIT TË SHITATZËNISË DHE
SËMUNDJEVE SEKSUALISHT TË TRANSMETUESHME (KONTRACEPTIVËT)**

PËRDORIMI I DROGAVE ME PASOJA TË MËDHA PËR ORGANIZMIN

TEST VLERËSUES..... 119-120

PARATHËNIE

Libri i mësimdhënësit/es "Biologjia 8" është hartuar në bazë të planprogramit mësimor, sipas Kurrikulës së re të aprovuar nga Ministria e Arsimit, Shkencës, Teknologjisë dhe e Inovacionit e Kosovës. Libri është përgatitur për fushën kurrikulare: Shkencat e natyrës, lëndën: Biologji 8, Shkalla e kurrikulës: III.

Ky libër është pjesë e kompletit të librit të mësimit "Biologjia 8" dhe do t'u shërbejë mësimdhënësve/eve si mjet ndihmës për të zbërthyer përmbajtjen e lëndës, e cila është organizuar sipas koncepteve, temave, njësive mësimore dhe rezultateve të të nxënit të lëndës (RNL).

Në këtë libër keni modelet për planin vjetor, planet dymujore, ato tremujore, si dhe është dhënë një model i orës së mësimit për secilën njësi mësimore (zhvillim), i cili mund të përdoret për realizimin e orës mësimore. Për çdo njësi mësimore janë të prezantuara rezultatet e të nxënit të lëndës (RNL), kriteret e suksesit, fjalët kyçe, burimet, lidhja me lëndët e tjera mësimore dhe/apo çështjet ndërkurrikulare, metodologjia dhe veprimtaritë e nxënësve. Në Librin e mësimdhënësit/es jepen shembuj të ndryshëm të metodologjive që mund të përdoren për ta bërë përmbajtjen e arritshme për nxënësit. Në libër gjeni dhe një test si shembull që ju ndihmon për vlerësimin e nxënësve.

Mirëpo, kjo nuk do të thotë që mësimdhënësit/et nuk mund të përzgjedhin metoda dhe planifikime të tjera për realizimin e njësive mësimore. Ata mund t'i përshtatin metodologjitë, strategjitë dhe teknikat e mësimdhënies, varësisht nga nevojat dhe kërkesat e nxënësve, me qëllim të arritjes së rezultateve të pritura të të nxënit për orë mësimore. Ky model i librit të mësimdhënësit/es është bërë duke u konsultuar dhe me mësimdhënësit të biologjisë të shkollës së mesme të ulët dhe të lartë.

Koha mësimore (orë mësimore) për një njësi mbetet në kompetencat e mësimdhënësit/es.

Suksese në mësimdhënie dhe arritje në rezultate të të nxënit ju dëshirojnë,
Autorët.

PLANI VJETOR

TEMAT MËSIMORE TË SHPËRNDARA GJATË MUAJVE (PLANI VJETOR)

Fusha kurrikulare: Shkencat e natyrës	Lënda: Biologji	Shkalla e kurrikulës: Shkalla IV	Klasa: 8
---	---------------------------	--	--------------------

Koncepti: Bota e gjallë			
PERIUDHA (I)		PERIUDHA (II)	PERIUDHA (III)
shtator—tetor	nëntor—dhjetor	janar—shkurt—mars	prill—maj—qershor
- Biologjia e qelizës - Indet, organet dhe sistemet e organeve te shtazët	- Indet, organet dhe sistemet e organeve te shtazët	- Indet, organet dhe sistemet e organeve te shtazët	- Indet, organet dhe sistemet e organeve te bimët - Ushqimi te njeriu - Shëndeti, sjelljet dhe emocionet e njeriut
Kontributi në rezultatet e të nxënit për kompetencat kryesore të shkallës IV, klasa e VIII			
I - Kompetenca e komunikimit dhe e të shprehurit - Komunikues efektiv 1, 2, 4, 5, 6, 8;			
II - Kompetenca e të menduarit - Mendimtar kreativ 1, 2, 5, 7, 8;			
III - Kompetenca e të nxënit - Nxënës i suksesshëm 1, 4, 6, 7, 8;			
IV - Kompetenca për jetë, për punë dhe për mjedis - Kontribues produktiv 1;			
V - Kompetenca personale - Individ i shëndoshë 1, 2, 3, 7, 8, 9;			
VI - Kompetenca qytetare - Qytetar i përgjegjshëm 1, 5, 8.			

Fusha kurrikulare: Shkencat e natyrës	Lënda: Biologji	Shkalla e kurrikulës: Shkalla IV	Klasa: 8
---	---------------------------	--	--------------------

PLANI DYMUJOR: shtator—tetor

Temat mësimore: Biologjia e qelizës

Indet, organet dhe sistemet e organeve te shtazët

RNK - Rezultatet e të nxënit për kompetencat kryesore të shkallës që synohet të arrihen

I.

1. Transmeton saktë të dhënat e mbledhura për një temë konkrete, në formë tekstuale, numerike, verbale, elektronike apo në ndonjë formë tjetër të të shprehurit.
5. Prezanton para të tjerëve një projekt për një temë të dhënë, të përgatitur vetë ose në bashkëpunim me grupin, duke gërshetuar format e komunikimit verbal, elektronik dhe veprimin praktik.
6. Analizon përmbajtjen dhe kuptimin e nocioneve (koncepteve) të reja, duke përdorur leksikun adekuat, të përshtatshëm dhe të saktë, si dhe i bën ato pjesë të dosjes mësimore.
8. Inicion biseda shoqërore me moshatarët dhe me të rriturit për tema me interes mësimor/shoqëror, duke shtruar pyetje për temën dhe duke u përgjigjur dhe veçuar informatën kryesore.

II.

2. Përzgjedh informata nga burime të ndryshme, për një temë konkrete, i klasifikon ato në bazë të një kriteri të caktuar dhe i përdor ato për marrjen e një vendimi apo për zgjidhjen e një problemi/detyre.
8. Identifikon me anë të krahasimit dallimet dhe ngjashmëritë midis ligjeve dhe dukurive që ndodhin në natyrë me ato në shoqëri, duke vënë në dukje lidhjen shkak-pasojë midis këtyre dukurive.

III.

1. Regjistron në formë të shkruar, grafike, me TI etj., informatat ose faktet për një temë të caktuar duke i veçuar, me anë të teknikave të ndryshme, pjesët e rëndësishme dhe më pak të rëndësishme të nevojshme për atë temë/detyrë të dhënë.
4. I parashtron pyetje vetes për çështjet që trajton dhe organizon mendimet për të gjetur përgjigje për temën apo problemin e caktuar duke regjistruar përparimin apo ngecjen derisa të gjejë zgjidhjen përfundimtare.
6. Ndjek në mënyrë të pavarur udhëzimet apo skicat e dhëna në libër, skicë, plan, partiturë muzikore, skenar, koreografi etj., ose të ndonjë burimi tjetër, për të performuar një veprim, aktivitet ose detyrë që kërkohet prej tij/saj.

7. Shfrytëzon në mënyrë të efektshme teknika të ndryshme gjatë të nxënimit të temës së dhënë, duke veçuar informatat që i kupton nga informatat e reja, të panjohura, si dhe informatat që për të mbeten ende të paqarta.

IV.

1. Vlerëson rëndësinë e punës individuale dhe në grupe për zhvillimin e komunitetit, duke paraqitur, në forma të ndryshme të të shprehurit, shembuj konkretë nga jeta e përditshme.

RNF - Rezultatet e të nxënimit të fushës kurrikulare të shkallës që synohet të arrihen përmes shtjellimit të temës/ave:

Dallon dhe krahason ndërtimin dhe funksionin e qelizës, indeve, organeve dhe sistemeve të organeve, duke iu referuar biodiversitetit të qenieve të gjalla, shkaktarët e sëmundjeve të njeriut, shtazët, bimët dhe mënyrat e kontrollit të tyre, metabolizmin, zhvillimin individual të njeriut dhe evolucionin e qenieve të gjalla. Shpjegon rolin e karbohidrateve, mineraleve, lipideve, proteinave, vitaminave, ujit dhe fibrave për dietë të shëndetshme dhe llogarit nevojën ditore për energji nga ushqimet e konsumuara.

Temat mësimore	Rezultatet e të nxënimit të lëndës	Njësitë Mësimore	Koha mësimore (orë mësimore)	Metodologjia e mësimdhënies	Metodologjia e vlerësimit	Ndërlidhja me lëndë të tjera mësimore, me çështjet ndërkurrikulare	Burimet
Biologjia e qelizës	Hulumton dhe përshkruan ndërtimin dhe funksionin e qelizës. Aplikon teknikat laboratorike në bazë të punës vetanake.	Qeliza - ndërtuesja themelore e gjallesave Çfarë ndërtimi kanë qelizat bimore dhe ato shtazore?	17	Mësimdhënie e drejtëpërdrejtë (shpjegim, sqarim, ushtrime praktike dhe shembujt); Mësimdhënie jo e drejtëpërdrejtë (shqyrtimi,	Vlerësimi me gojë (diskutime, debate, prezantime); Vlerësimi me shkrim, i cili realizohet përmes teknikave të ndryshme (testeve, kuizeve, eseve, raportet e punës);	Gjuhë dhe komunikim; Fizikë; Kimi; TIK; Art Figurativ;	Libri: "Biologjia 8"

<p>Indet, organet dhe sistemet e organeve te shtazët</p>	<p>Emërton pjesët ndërtuese të qelizës nga fotografia, skema, skica etj.;</p> <p>Shpjegon pjesët kryesore të qelizës: murin, membranën, bërthamën, mitokondritë, ribosomet etj.;</p> <p>Shpjegon se në qelizë vazhdimisht kryhet shkëmbimi i materies dhe energjisë;</p> <p>Dallon qelizën bimore nga ajo shtazore;</p> <p>Krahason qelizat prokariote me ato eukariote;</p> <p>Argumenton unitetin e botës së gjallë dhe jo</p>	<p>Qelizat prokariote dhe qelizat eukariote;</p> <p>Veçoritë fizike dhe kimike të qelizës;</p> <p>Qelizat japin indet;</p> <p>Nga indet te organet dhe sistemet e organeve;</p> <p>Ndërtimi dhe funksioni i indeve, i organeve dhe i sistemeve të organeve të shtazëve pakurrizore;</p> <p>Ndërtimi dhe funksioni i indeve, i</p>	<p>zbulimi, zgjidhja e problemeve); Mësimdhënie me anë të pyetjeve (teknika e pyetjeve drejtuar nxënësve);</p> <p>Mësimdhënie përmes vrojtimit, demonstrimit dhe eksperimentit;</p> <p>Diskutimi dhe të nxënët në bashkëpunim (në grupe të vogla, grupe më të mëdha dhe me të gjithë nxënësit);</p> <p>Të mësuarit dhe të nxënët përmes mjeteve multimediale e në veçanti përmes kompjuterit;</p>	<p>Vlerësimi i punës praktike/eksperimentale</p> <p>Vlerësimi individual dhe grupor gjatë punës kërkimore;</p> <p>Vlerësimi i detyrave të shtëpisë;</p>	<p>Ekologjia dhe mjedisi;</p> <p>Gjeografi.</p>	
---	--	---	---	---	---	--

	<p>të gjallë nëpërmjet njohjes së përbërjes kimike dhe veçorive fiziko-kimike të qelizës;</p> <p>Organizon lidhshmërinë e koncepteve hierarkike: qelizë, inde, organe, sisteme të organeve dhe organizëm;</p> <p>Organizon lidhshmërinë e koncepteve hierarkike të organizmave: organizma njëqelizorë, kolonialë dhe shumëqelizorë;</p> <p>Hulumton dhe përshkruan ndërtimin dhe funksionin e indeve, organeve dhe të</p>	<p>organeve dhe i sistemeve të organeve të shtazëve kurrizore.</p>		<p>Mësimdhënie që nxit hulumtimin e pavarur.</p>			
--	---	--	--	--	--	--	--

<p>sistemeve të organeve te shtazët;</p> <p>Organizon lidhshmërinë e koncepteve hierarkike të organizmave: organizma njëqelizorë, kolonialë dhe shumëqelizorë;</p> <p>Përshkruan ndërlidhjen e ndërtimit dhe të funksionit ndërmjet organeve të ndryshme;</p> <p>Përdor terminologjinë korrekte anatomike, kur shqipton topografinë e pjesëve të trupit të jokurrizorëve dhe të kurrizorëve;</p>							
--	--	--	--	--	--	--	--

Hulumton dhe përshkruan ndërtimin dhe funksionin e indeve, organeve dhe të sistemeve të organeve të shtazët;

Emërton indet kryesore shtazore, përshkruan ndërtimin dhe funksionin e tyre;

Përshkruan ndërlidhjen e ndërtimit dhe të funksionit ndërmjet organeve të ndryshme.

Fusha kurrikulare: Shkencat e natyrës	Lënda: Biologji	Shkalla e kurrikulës: Shkalla IV	Klasa: 8
---	---------------------------	--	--------------------

PLANI DYMUJOR: nëntor—dhjetor

Temat mësimore: Indet, organet dhe sistemet e organeve te shtazët

RNK - Rezultatet e të nxënit për kompetencat kryesore të shkallës që synohet të arrihen

I

1. Transmeton saktë të dhënat e mbledhura për një temë konkrete, në formë tekstuale, numerike, verbale, elektronike apo në ndonjë formë tjetër të të shprehurit.
2. Përshkruan një ngjarje, të dhënë si detyrë, të lexuar ose të dëgjuar më parë, në formë verbale, vizuale ose me shkrim, duke ruajtur rrjedhën logjike të saj.
5. Prezanton para të tjerëve një projekt për një temë të dhënë, të përgatitur vetë ose në bashkëpunim me grupin, duke gërshetuar format e komunikimit verbal, elektronik dhe veprimin praktik
6. Analizon përmbajtjen dhe kuptimin e nocioneve (koncepteve) të reja, duke përdorur leksikun adekuat, të përshtatshëm dhe të saktë dhe i bën ato pjesë të dosjes mësimore.

II

1. Paraqet, në formë gojore ose të shkruar, grafike, me simbole, argumente të veçanta për të sforcuar mendimin apo qëndrimin e vet për një problem nga fusha të caktuara.
2. Përzgjedh informata nga burime të ndryshme, për një temë konkrete, i klasifikon ato në bazë të një kriteri të caktuar dhe i përdor ato për marrjen e një vendimi apo për zgjidhjen e një problemi/detyre.
7. Interpretin me fjalë, me shkrim/me gojë një rregull, koncept apo proces të caktuar duke e ilustruar atë me shembuj konkretë nga situata të jetës së përditshme.
8. Identifikon me anë të krahasimit dallimet dhe ngjashmëritë midis ligjeve dhe dukurive që ndodhin në natyrë me ato në shoqëri, duke vënë në dukje lidhjen shkak-pasojë midis këtyre dukurive.

III

6. Ndjek në mënyrë të pavarur udhëzimet apo skicat e dhëna në libër, skicë, plan, partiturë muzikore, skenar, koreografi etj., ose të ndonjë burimi tjetër, për të performuar një veprim, aktivitet ose detyrë që kërkohet prej tij/saj.
7. Shfrytëzon në mënyrë të efektshme teknika të ndryshme gjatë të nxënit të temës së dhënë duke veçuar informatat që i

kupton nga informatat e reja, të panjohura, si dhe informatat që për të mbeten ende të paqarta.

IV

1. Vlerëson rëndësinë e punës individuale dhe në grupe për zhvillimin e komunitetit duke paraqitur, në forma të ndryshme të të shprehurit, shembuj konkretë nga jeta e përditshme.

V

1. Vlerëson përmbajtjen dhe vlerat ushqyese të llojeve të ushqimeve, të cilat njeriu i konsumon, duke i kategorizuar ato në bazë të nevojave të individit për to në situata të ndryshme, si: gjatë stinëve, sëmundjeve etj.

2. Argumenton nevojën e respektimit të regjimit për ushqyerje të shëndetshme dhe rekreacion ditor, javor apo mujor, sipas udhëzimeve të lexuara ose të dëgjara nga mjeku gjatë një diskutimi në klasë, në shkollë apo në familje.

3. Vlerëson domosdoshmërinë e kushteve të mira higjienike për përgatitjen dhe konsumimin e ushqimeve dhe pijeve dhe shpjegon rrethanat e mundshme të helmimit nga ushqimet dhe papastërtia.

RNF- Rezultatet e të nxënit të fushës kurrikulare të shkallës që synohet të arrihen përmes shtjellimit të temës/ve:

Dallon dhe krahason ndërtimin dhe funksionin e qelizës, indeve, organeve dhe sistemeve të organeve, duke iu referuar biodiversitetit të qenieve të gjalla, shkaktarët e sëmundjeve të njeriu, shtazët bimët dhe mënyrat e kontrollit të tyre, metabolizmin, zhvillimin individual të njeriut dhe evolucionin e qenieve të gjalla. Shpjegon rolin e karbohidrateve, mineraleve, lipideve, proteinave, vitaminave, ujit dhe fibrave për dietë të shëndetshme dhe llogarit nevojën ditore për energji nga ushqimet e konsumuara.

Temat mësimore	Rezultatet e të nxënit për lëndë	Njësitë mësimore	Koha mësimore (orë mësimore)	Metodologjia e mësimdhënies	Metodologjia e vlerësimit	Ndërlidhja me lëndë të tjera mësimore, me çështjet ndërkurrikulare	Burimet
Indet, organet dhe sistemet e organeve të shtazët	<p>Emërton dhe shpjegon indet, organet dhe sistemin e organeve muskulore;</p> <p>Emërton dhe shpjegon indet, organet dhe sistemin e organeve të tretjes, organet kryesore të sistemit tretës dhe përshkruan ndërtimin dhe funksionin e tyre;</p> <p>Emërton disa çrregullime në zhvillimin e organeve të</p>	<p>Indet, organet dhe sistemet e organeve muskulore;</p> <p>Indet, organet dhe sistemet e organeve të tretjes të shtazëve;</p> <p>Sistemi i organeve të tretjes (digjestiv) te gjitarët;</p> <p>Sëmundjet e organeve të tretjes;</p> <p>Sistemi i qarkullimit i lëngjeve të pakurrizorëve;</p>	16	<p>Mësimdhënie dhe të nxënët që nxit hulumtimin e pavarur;</p> <p>Mësimdhënie e drejtëpërdrejtë (shpjegim, sqarim, ushtrime praktike dhe shembuj);</p> <p>Mësimdhënie me anë të pyetjeve (teknika e pyetjeve drejtuar nxënësve);</p> <p>Mësimdhënie indirekte (shqyrtimi, zbulimi, zgjidhja e problemeve);</p>	<p>Vlerësim për nxënie (informatë kthyesë, vlerësim i ndërsjellë);</p> <p>Vlerësimi i punës praktike/eksperimentale;</p> <p>Vlerësimi me gojë (diskutime, debate, prezantime);</p> <p>Vlerësim për ecurinë dhe produktin e punës me projekte.</p>	<p>Gjuhë dhe komunikim;</p> <p>Fizikë;</p> <p>Kimi;</p> <p>TIK;</p> <p>Art Figurativ;</p> <p>Ekologjia dhe mjedisi;</p> <p>Gjeografi.</p>	“Biologjia 8”

<p>tretjes si dhe sëmundjet më të shpeshta të sistemit tretës;</p> <p>Përshkruan ndërtimin dhe funksionin e zembrës dhe të enëve të gjakut, përkatësisht sistemin e organeve të qarkullimit të gjakut;</p> <p>Emërton dhe të përshkruan disa sëmundje të gjakut, të zembrës dhe të enëve të gjakut;</p> <p>Shpjegon procesin e transfuzionit të gjakut dhe</p>	<p>Sistemi i qarkullimit i lëngjeve të kurrizorëve;</p> <p>Disa nga sëmundjet e gjakut, zembrës dhe enëve të gjakut;</p> <p>Transfuzioni i gjakut dhe grupet e gjakut.</p>		<p>Mësimdhënie përmes projekteve, punëve kërkimore;</p> <p>Diskutimi dhe të nxënët në bashkëpunim (në grupe të vogla dhe të mëdha dhe me të gjithë nxënësit);</p> <p>Mësimdhënie dhe të nxënët përmes mjeteve multimediale;</p> <p>Mësimdhënie që nxit të menduarit kritik, krijues dhe zgjidhjen e problemeve.</p>			
--	---	--	---	--	--	--

si caktohen grupet e gjakut të sistemit ABO.							
--	--	--	--	--	--	--	--

Periudha II
Janar-shkurt-mars

Fusha kurrikulare: Shkencat e natyrës	Lënda: Biologji	Shkalla e kurrikulës: Shkalla IV	Klasa: 8
---	---------------------------	---	---------------------------

PLANI TREMUJOR: janar—shkurt—mars

Temat mësimore: Indet, organet dhe sistemet e organeve te shtazët

RNK - Rezultatet e të nxënit për kompetencat kryesore të shkallës që synohet të arrihen

I

1. Transmeton saktë të dhënat e mbledhura për një temë konkrete, në formë tekstuale, numerike, verbale, elektronike apo në ndonjë formë tjetër të të shprehurit.
2. Përshkruan një ngjarje, të dhënë si detyrë, të lexuar ose të dëgjuar më parë, në formë verbale, vizuale ose me shkrim, duke ruajtur rrjedhën logjike të saj.
6. Analizon përmbajtjen dhe kuptimin e nocioneve (koncepteve) të reja, duke përdorur leksikun adekuat, të përshtatshëm dhe të saktë dhe i bën ato pjesë të dosjes mësimore.

II

2. Përzgjedh informata nga burime të ndryshme, për një temë konkrete, i klasifikon ato në bazë të një kriteri të caktuar dhe i përdor ato për marrjen e një vendimi apo për zgjidhjen e një problemi/detyre.

5. Arsyeton ndërmarrjen e hapave konkretë, të cilët kanë rezultuar përfundimin e një detyre/aktiviteti, zgjidhjen e një problemi apo të ndonjë punimi në klasë/shkollë apo gjetiu.
7. Identifikon burime të ndryshme të informacionit për arsimim, orientimin profesional dhe harton një plan individual për zhvillimin e karrierës në fushën e komunikimit (gazetar etj.).
8. Identifikon me anë të krahasimit dallimet dhe ngjashmëritë midis ligjeve dhe dukurive që ndodhin në natyrë me ato në shoqëri, duke vënë në dukje lidhjen shkak-pasojë midis këtyre dukurive.

III

6. Ndjek në mënyrë të pavarur udhëzimet apo skicat e dhëna në libër, skicë, plan, partiturë muzikore, skenar, koreografi etj., ose të ndonjë burimi tjetër, për të performuar një veprim, aktivitet ose detyrë që kërkohet prej tij/saj.
7. Shfrytëzon në mënyrë të efektshme teknika të ndryshme gjatë të nxënimit të temës së dhënë duke veçuar informatat që i kupton nga informatat e reja, të panjohura, si dhe informatat që për të mbeten ende të paqarta.

IV

1. Vlerëson rëndësinë e punës individuale dhe në grupe për zhvillimin e komunitetit duke paraqitur, në forma të ndryshme të të shprehurit, shembuj konkretë nga jeta e përditshme.

RNF - Rezultatet e të nxënimit të fushës kurrikulare të shkallës që synohet të arrihen përmes shtjellimit të temës/ve:

Dallon dhe krahason ndërtimin dhe funksionin e qelizës, indeve, organeve dhe sistemeve të organeve, duke iu referuar biodiversitetit të qenieve të gjalla, shkaktarët e sëmundjeve të njeriut, shtazët bimët dhe mënyrat e kontrollit të tyre, metabolizmin, zhvillimin individual të njeriut dhe evolucionin e qenieve të gjalla. Shpjegon rolin e karbohidrateve, mineraleve, lipideve, proteinave, vitaminave, ujit dhe fibrave për dietë të shëndetshme dhe llogarit nevojën ditore për energji nga ushqimet e konsumuara.

Temat mësimore	Rezultatet e të nxënimit të lëndës	Njësitë mësimore	Koha mësimore (në orë mësimore)	Metodologjia e mësimdhënies	Metodologjia e vlerësimit	Ndërlidhja me lëndë të tjera mësimore, me çështjet ndërkurrikulare	Burimet

<p>Indet, organet dhe sistemet e organeve te shtazët</p>	<p>Identifikon disa sëmundje imunologjike dhe përshkruan shfaqjen e tyre;</p> <p>Emërton dhe shpjegon rrugët e frymëmarrjes, ndërtimin dhe funksionin e tyre;</p> <p>Përshkruan mekanizmat e frymëmarrjes mushkërore, branshiale dhe trakeidale si dhe rregullimin e saj;</p> <p>Emërton disa sëmundje kryesore të sistemit të frymëmarrjes;</p> <p>Aplikon masazhin e zemrës, frymëmarrjen artificiale dhe</p>	<p>Sëmundjet imunologjike dhe sistemi imunitar</p> <p>Sistemi i organeve të frymëmarrjes te shtazët</p> <p>Sëmundjet e rrugëve të frymëmarrjes dhe mushkërive</p> <p>Sistemi i organeve të tajitjes (ekskretimit)</p>	<p>22</p>	<p>Mësimdhënie dhe të nxënë të që nxit hulumtimin e pavarur;</p> <p>Mësimdhënie e drejtëpërdrejtë (shpjegim, sqarim, ushtrime praktike dhe shembuj);</p> <p>Mësimdhënie me anë të pyetjeve (teknika e pyetjeve drejtuar nxënësve);</p> <p>Mësimdhënie indirekte (shqyrtimi, zbulimi, zgjidhja e problemeve);</p> <p>Mësimdhënie përmes projekteve, punëve kërkimore;</p>	<p>Vlerësim për nxënie (informatë kthyesë, vlerësim i ndërsjellë);</p> <p>Vlerësimi i punës praktike/eksperimentale;</p> <p>Vlerësimi me gojë (diskutime, debate, prezantime);</p> <p>Vlerësim për ecurinë dhe produktin e punës me projekte.</p>	<p>Gjuhë dhe komunikim;</p> <p>Fizikë;</p> <p>Kimi;</p> <p>TIK;</p> <p>Art Figurativ;</p> <p>Ekologjia dhe mjedisi;</p> <p>Gjeografi.</p>	<p>“Biologjia 8”</p>
---	---	---	-----------	--	---	---	----------------------

<p>Vlerëson rolin e higjienës së lëkurës (posaçërisht të duarve) për të evituar sëmundjet e sistemit tretës;</p> <p>Emërton dhe shpjegon indin nervor, organet dhe sistemin e organeve nervore;</p> <p>Analizon evolucionin e sistemit nervor të shtazët;</p> <p>Analizon procesin e funksionimit të sistemit nervor prej pranimit të ngacmimit deri te reagimi.</p> <p>Shpjegon ndërtimin e shqisës së të parit, dëgjuarit, ekuilibrit,</p>	<p>Shqisat - sistem i organeve ndijore</p> <p>Sistemi endokrin</p> <p>Sistemi i riprodhimit te shtazët</p>						
--	---	--	--	--	--	--	--

shijes,
nuhatjes,
shqisave
lëkurore dhe
analizon
funksionin e
tyre;

Përshkruan dhe
shpjegon
ndërtimin dhe
funksionin e
gjëndrave
endokrine;

Liston
hormonet më
të rëndësishme
të gjëndrave
endokrine dhe
përshkruan
rolin fiziologjik
të tyre te
shtazët;

Identifikon
sëmundje që
shfaqen si
pasojë e
çrregullimit të
funksionit të
sistemit
endokrin;

	<p>Emërton dhe shpjegon ndërtimin dhe funksionin e sistemit për riprodhim të grupeve shtazore;</p> <p>Shpjegon mënyrat e shumimit të grupeve të ndryshme shtazore.</p>						
--	--	--	--	--	--	--	--

Periudha III

Prill—maj—qershor

Fusha kurrikulare:	Lënda:	Shkalla e kurrikulës:	Klasa:
Shkencat e natyrës	Biologji	Shkalla IV	8

PLANI TREMUJOR: prill—maj—qershor

Temat mësimore: Indet, organet dhe sistemet e organeve të bimëve, Ushqimi te njeriu, Shëndeti, sjelljet dhe emocionet e njeriut

RNK - Rezultatet e të nxënit për kompetencat kryesore të shkallës që synohet të arrihen

I

1. Transmeton saktë të dhënat e mbledhura për një temë konkrete, në formë tekstuale, numerike, verbale, elektronike apo në ndonjë formë tjetër të të shprehurit
4. Harton një tekst, deri në pesëqind fjalë, duke e vazhduar një rrëfim gojor apo tekst të lexuar paraprakisht, duke u bazuar në imagjinatën e vet.
6. Analizon përmbajtjen dhe kuptimin e nocioneve (koncepteve) të reja, duke përdorur leksikun adekuat, të përshtatshëm dhe të saktë dhe i bën ato pjesë të dosjes mësimore.

II

2. Përzgjedh informata nga burime të ndryshme, për një temë konkrete, i klasifikon ato në bazë të një kriteri të caktuar dhe i përdor ato për marrjen e një vendimi apo për zgjidhjen e një problemi/detyre.
7. Interpretin me fjalë, me shkrim/me gojë një rregull, koncept apo proces të caktuar duke e ilustruar atë me shembuj konkretë nga situata të jetës së përditshme.
8. Identifikon me anë të krahasimit dallimet dhe ngjashmëritë midis ligjeve dhe dukurive që ndodhin në natyrë me ato në shoqëri, duke vënë në dukje lidhjen shkak-pasojë midis këtyre dukurive.

III

6. Ndjek në mënyrë të pavarur udhëzimet apo skicat e dhëna në libër, skicë, plan, partiturë muzikore, skenar, koreografi etj., ose të ndonjë burimi tjetër, për të performuar një veprim, aktivitet ose detyrë që kërkohet prej tij/saj.

- 7.** Shfrytëzon në mënyrë të efektshme teknika të ndryshme gjatë të nxënës të temës së dhënë, duke veçuar informatat që i kupton nga informatat e reja, të panjohura, si dhe informatat që për të mbeten ende të paqarta.
- 8.** Zbaton elementet e dosjes personale për identifikimin e anëve të veta të forta, i shfrytëzon ato për orientim në profesionin e ardhshëm, si dhe për vetëvlerësimin e përparimit, qoftë përmirësimin apo ngecjen në fusha të ndryshme mësimore.

IV

- 1.** Vlerëson rëndësinë e punës individuale dhe në grupe për zhvillimin e komunitetit duke paraqitur, në forma të ndryshme të të shprehurit, shembuj konkretë nga jeta e përditshme.

V

- 1.** Vlerëson përmbajtjen dhe vlerat ushqyese të llojeve të ushqimeve të cilat njeriu i konsumon, duke i kategorizuar ato në bazë të nevojave të individit për to në situata të ndryshme, si: gjatë stinëve, sëmundjeve etj.
- 2.** Argumenton nevojën e respektimit të regjimit për ushqyerje të shëndetshme dhe rekreacion ditor, javor apo mujor, sipas udhëzimeve të lexuara ose të dëgjura nga mjeku gjatë një diskutimi në klasë, në shkollë apo në familje.
- 7.** U shpjegon moshatarëve, me forma dhe mjete të ndryshme të komunikimit, rëndësinë e identifikimit të personave dhe shërbimeve kompetente, veç e veç, të nevojshme për mbështetje në situata që konsiderohen potencialisht të rrezikshme për shëndetin fizik dhe mendor.
- 8.** Përshkruan mundësitë, rreziqet dhe pasojat e infeksioneve dhe sëmundjeve seksualisht të transmetueshme dhe sqaron mënyrat dhe mjetet për parandalimin e tyre, duke përdorur forma të ndryshme të prezantimit (të folur, të shkruar, grafike, pllakate, pamflete, lojë teatrale, performancë artistike etj.).
- 9.** Reagon ndaj sjelljeve asociale të moshatarëve., duke identifikuar shkaqet e shfaqjes dhe pasojat e mundshme për shëndetin dhe mirëqenien e individit nga dukuritë dhe shprehjet negative (p.sh.: përdorimi i duhanit, i alkoolit apo drogës) etj.

VI

- 1.** Praktikton të drejtat dhe detyrimet e qytetarisë në situata konkrete jetësore të përditshme, qoftë në klasë, qoftë në shkollë apo gjetiu (si: gjatë diskutimit, respektimit të mendimit të tjetrit etj.).
- 5.** Reagon me maturi ndaj sjelljeve apo veprimeve jo të mira që ndodhin në klasë/shkollë apo jashtë saj, promovon sjelljet dhe veprimet e mira, duke vënë në pah shkaqet dhe pasojat e manifestimit të tyre për individin dhe për të tjerët.
- 8.** Përshkruan, në forma të ndryshme të të shprehurit, procedurat dhe institucionet përgjegjëse për hartimin dhe ndryshimin e ligjeve duke argumentuar domosdoshmërinë e zbatimit të tyre në jetën e përditshme.

RNF- Rezultatet e të nxënit të fushës kurrikulare të shkallës që synohet të arrihen përmes shtjellimit të temës/ve:

Dallon dhe krahason ndërtimin dhe funksionin e qelizës, indeve, organeve dhe sistemeve të organeve, duke iu referuar biodiversitetit të qenieve të gjalla, shkaktarët e sëmundjeve të njeriut, shtazët bimët dhe mënyrat e kontrollit të tyre, metabolizmin, zhvillimin individual të njeriut dhe evolucionin e qenieve të gjalla. Shpjegon rolin e karbohidrateve, mineraleve, lipideve, proteinave, vitaminave, ujit dhe fibrave për dietë të shëndetshme dhe llogarit nevojën ditore për energji nga ushqimet e konsumuara.

Temat mësimore	Rezultatet e të nxënit të lëndës	Njësitë Mësimore	Koha mësimore (orë mësimore)	Metodologjia e mësimdhënies	Metodologjia e vlerësimit	Ndërlidhja me lëndë të tjera mësimore, me çështjet ndërkurrikulare	Burimet
Indet, organet dhe sistemet e organeve të bimëve	Hulumton dhe përshkruan ndërtimin dhe funksionin e indeve dhe organeve bimore; Përshkruan veçoritë themelore të bimëve duke u bazuar në ndërtimin e indeve dhe organeve; Emërton dhe dallon indet dhe organet e	Indet e bimëve; Organet dhe sistemet e	20	Mësimdhënie dhe të nxënët që nxit hulumtimin e pavarur; Mësimdhënie e drejtëpërdrejtë (shpjegim, sqarim, ushtrime praktike dhe shembuj); Mësimdhënie me anë të pyetjeve (teknika e pyetjeve drejtuar nxënësve); Mësimdhënie indirekte (shqyrtimi,	Vlerësim për nxënie (informatë kthyesë, vlerësim i ndërsjellë); Vlerësimi i punës praktike/eksperimentale; Vlerësimi me gojë (diskutime, debate, prezantime);	Gjuhë dhe komunikim, Fizikë; Kimi, TIK, Art Figurativ Ekologjia dhe mjedisi, Gjeografi.	“Biologjia 8”

<p>Shpjegon çka do të ndodhë kur një organ bimor nuk funksionon;</p> <p>Shpjegon pse fiernat u përkasin bimëve;</p> <p>Përshkruan sistemin e organeve riproduktive të bimët;</p> <p>Identifikon dallimet thelbësore sa i përket ndërtimit të lules së bimëve farëzhveshura dhe farëveshura;</p> <p>Analizon dallimet bazë mes bimëve monokotiledone dhe dikotiledone;</p> <p>Krahason ndërtimin e organeve vegjetative (p.sh., kërcellit) të</p>	<p>Bimët me farë të veshur;</p> <p>Si formohen farat dhe frutat;</p> <p>Lëndët ushqyese që sigurojnë energji;</p> <p>Lëndët ushqyese që nuk sigurojnë energji;</p> <p>Ushqimi jo i shëndetshëm dhe</p>					
--	---	--	--	--	--	--

	<p>bimëve njëthelbore dhe dythelbore;</p> <p>Definon dhe shpjegon termat polenizim dhe frytnim; Shpjegon si formohet fryti dhe dhe fara dhe dallon llojet e fryteve e farave;</p> <p>Shpjegon rëndësinë e frytnimit artificial për fisnikërimin e bimëve;</p> <p>Emërton disa lloje bimore sipas vlerave përdoruese: ushqim, mjekësi, ekonomi etj. ushqime të njeriut;</p> <p>Shpjegon rolin dhe rëndësinë e përbërësve të ushqimit;</p>	<p>jo i rregullt - me pasoja të mëdha;</p> <p>Ndërtimi dhe funksioni i organeve riprodhuese te njeriu;</p> <p>Metodat dhe mjetet e parandalimit të shtatzënisë dhe sëmundjeve seksualisht të transmetueshme (kontrceptivët); Përdorimi i drogave me pasoja të mëdha për organizmin.</p>					
--	--	--	--	--	--	--	--

Emërton lloje të vitaminave dhe identifikon ushqime me përbërje vitaminoze;

Shpjegon pasojat e ushqyerjes jo të rregullt;

Hulumton informacione për dietë;
Diskuton për rregullat e ushqyerjes në fazat e jetës së njeriut;

Identifikon dhe shpjegon për ushqimet jo të shëndetshme.

Shpjegon ndërtimin dhe funksionin e organeve riprodhuese dhe kupton proceset si menstruacioni, spermatogjeneza,

<p>ovulimi dhe fertilizimi;</p> <p>Përshkruan metodat tradicionale dhe moderne kontraceptive;</p> <p>Kupton rëndësinë, mënyrat e vetëkontrollit të trupit dhe di ku duhet të drejtohet për të marrë këshilla dhe ndihmë;</p> <p>Diskuton ndikimin e alkoolit dhe drogave në sjelljen e vendimeve të përgjegjshme.</p>						
---	--	--	--	--	--	--

PLANIFIKIMI I ORËS MËSIMORE

ASPEKTET E PËRGJITHSHME TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE

Fusha kurrikulare: Shkencat e natyrës Lënda: Biologji Shkalla e kurrikulës: IV
Klasa: VIII

Tema (nga
plani
dymujor):
**Biologjia e
qelizës**

Rezultati i të nxënit të temës (nga plani dymujor):

*Hulumton dhe përshkruan ndërtimin dhe funksionin e qelizës.
Aplikon teknikat laboratorike në bazë të punës vetanake.*

Rezultatet e të nxënit për kompetencat kryesore të shkallës (të synuara):

I 5. *Prezanton para të tjerëve një projekt për një temë të dhënë, të përgatitur vetë ose në bashkëpunim me grupin, duke gërshetuar format e komunikimit verbal, elektronik dhe veprimin praktik.*

II 2. *Përzgjedh informata nga burime të ndryshme, për një temë konkrete, i klasifikon ato në bazë të një kriteri të caktuar dhe i përdor ato për marrjen e një vendimi apo për zgjidhjen e një problemi/detyre.*

III 7. *Shfrytëzon në mënyrë të efektshme teknika të ndryshme gjatë të nxënit të temës së dhënë, duke veçuar informatat që i kupton nga informatat e reja, të panjohura, si dhe informatat që për të mbeten ende të paqarta.*

Rezultatet e fushës së kurrikulës (të synuara):

Dallon dhe krahason ndërtimin dhe funksionin e qelizës, indeve, organeve dhe sistemeve të organeve, duke iu referuar biodiversitetit të qenieve të gjalla, shkaktarët e sëmundjeve të njeriut, shtazët bimët dhe mënyrat e kontrollit të tyre, metabolizmin, zhvillimin individual të njeriut dhe evolucionin e qenieve të gjalla. Shpjegon rolin e karbohidrateve, mineraleve, lipideve, proteinave, vitaminave, ujit dhe fibrave për dietë të shëndetshme dhe llogarit nevojën ditore për energji nga ushqimet e konsumuara.

ASPEKTET SPECIFIKE TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE

Njësia mësimore: **Qeliza - ndërtuesja themelore e gjallesave**

Fjalët kyçe: *qelizë, ndërtim, energji, epiteliale, seksuale, nervore, muskulore.*

Rezultati/et e të nxënit për orë mësimore:

*Definon konceptin qelizë;
Përshkruan ndërtimin e qelizës;
Sqaron funksionin e qelizës.*

Kriteret e suksesit:

*Sqaro konceptin qelizë;
Vlerëso rolin e qelizës.*

Burimet, mjetet e konkretizimit dhe materialet mësimore:

Libri Biologjia 8, mikroskopi, qepa, preparati.

Lidhja me lëndët e tjera mësimore dhe/apo me çështjet ndërkurrikulare dhe situatat jetësore:

Gjuhë dhe komunikim, art figurativ, kimi.

PËRSHKRIMI I METODOLOGJISË DHE VEPRIMTARITË E PUNËS ME NXËNËS GJATË ORËS MËSIMORE

STUHI MENDIMESH

Mësimdhënësi/ja shkruan në tabelë titullin “Qeliza - ndërtuesja e gjallesave”, dhe u kërkon nxënësve të mendojnë për disa minuta lidhur me temën e dhënë. Pasi kanë menduar në heshtje, u jep fjalën nxënësve të shprehin atë çfarë kanë menduar, mendimet e tyre mësimdhënësi/ja i shkruan në tabelë pa i mohuar apo pohuar ato, pasi këto mendime do të vlerësohen nga nxënësit si të sakta apo të gabuara në fund të orës mësimore.


INSERT

Në këtë fazë bëhet leximi i pjesës duke vendosur shenjat , =, -, ?. Nënvizimet e bëra në libër hidhen në tabelën e INSERT-it. Pra, pjesët kryesore të mësimit të shënuara me shenjat përkatëse hidhen në tabelë, (shenja V vendoset për atë pjesë që nxënësit dinë, shenja + për pjesën që është shtuar e re, shenja – për pjesën që nuk e dinë, dhe shenja ? për pjesën që nuk kuptojnë).

<input checked="" type="checkbox"/>	+	-	?

PUNË PRAKTIKE

Pasi nxënësit të kenë plotësuar tabelën INSERT, mësimdhënësi/ja bën prerjen tërthore të qepës (nëse ka preparat të gatshëm, e shfrytëzon atë) e vendos në mikroskop dhe fton të gjithë nxënësit të vrojtojnë qelizën bimore.



(foto shembull)

VLERËSIMI I NXËNËSVE

Vlerësimi me gojë (diskutime, debate, prezantime).

DETYRAT DHE PUNA E PAVARUR

Hulumtoni për historikun e zbulimit të qelizës.

REFLEKTIM PËR RRJEDHËN E ORËS MËSIMORE

PLANIFIKIMI I ORËS MËSIMORE

ASPEKTET E PËRGJITHSHME TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE

Fusha kurrikulare: Shkencat e natyrës Lënda: Biologji Shkalla e kurrikulës: IV
Klasa: VIII

Tema (nga plani dymujor):

Biologjia e qelizës

Rezultati i të nxënit të temës (nga plani dymujor):

Emërton pjesët ndërtuese të qelizës nga fotografia, skema, skica etj; Shpjegon pjesët kryesore të qelizës: murin, membranën, bërthamën, mitokondritë, ribosomet etj; Shpjegon se në qelizë vazhdimisht kryhet shkëmbimi i materies dhe energjisë; Dallon qelizën bimore nga ajo shtazore.

Rezultatet e të nxënit për kompetencat kryesore të shkallës (të synuara):

I **1.** Transmeton saktë të dhënat e mbledhura për një temë konkrete, në formë tekstuale, numerike, verbale, elektronike apo në ndonjë formë tjetër të të shprehurit.

I **8.** Inicion biseda shoqërore me moshatarët dhe me të rriturit për tema me interes mësimor/shoqëror, duke shtruar pyetje për temën dhe duke u përgjigjur dhe veçuar informatën kryesore.

II **8.** Identifikon me anë të krahasimit dallimet dhe ngjashmëritë midis ligjeve dhe dukurive që ndodhin në natyrë me ato në shoqëri, duke vënë në dukje lidhjen shkak-pasojë midis këtyre dukurive.

Rezultatet e fushës së kurrikulës (të synuara):

Dallon dhe krahason ndërtimin dhe funksionin e qelizës, indeve, organeve dhe sistemeve të organeve, duke iu referuar biodiversitetit të qenieve të gjalla, shkaktarët e sëmundjeve të njeriut, shtazët bimët dhe mënyrat e kontrollit të tyre, metabolizmin, zhvillimin individual të njeriut dhe evolucionin e qenieve të gjalla.

Shpjegon rolin e karbohidrateve, mineraleve, lipideve, proteinave, vitaminave, ujit dhe fibrave për dietë të shëndetshme dhe llogarit nevojën ditore për energji nga ushqimet e konsumuara.

PLANIFIKIMI I ORËS MËSIMORE

ASPEKTET SPECIFIKE TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE

Njësia mësimore: **Çfarë ndërtimi kanë qelizat bimore dhe ato shtazore**

Fjalët kyçe: *qelizë bimore, qelizë shtazore, organele qelizore, kloroplaste, mitokondri.*

Rezultati/et e të nxënit për orë mësimore:

*Shpjegon ndërtimin e qelizës shtazore dhe asaj bimore;
Demonstron ndërtimin e qelizës bimore përmes modelit/fotografisë;
Arsyeton pse bimët janë me ngjyrë të gjelbër.*

Kriteret e suksesit:

*Krahaso qelizën bimore nga qeliza shtazore;
Dallo organelet identifikuese të qelizës bimore dhe asaj shtazore;
Specifik funksionin e kloroplasteve.*

Burimet, mjetet e konkretizimit dhe materialet mësimore: *Libri Biologjia 8, kubi.*

Lidhja me lëndët e tjera mësimore dhe/apo me çështjet ndërkurrikulare dhe situatat jetësore: *Gjuhë dhe komunikim, art figurativ, kimi.*

PËRSHKRIMI I METODOLOGJISË DHE VEPRIMTARITË E PUNËS ME NXËNËS GJATË ORËS MËSIMORE

GRUPI GUMËZHITËS

Mësimdhënësi/ja shkruan në tabelë "Qeliza - bimore dhe shtazore", dhe u kërkon nxënësve të mendojnë për disa minuta lidhur me temën e dhënë. Pasi kanë menduar në heshtje, u kërkon që të gumëzhisin (bisedojnë me zë të ulët) në çifte që të shkëmbejnë idetë e tyre, pastaj u jep fjalën të shprehin atë çfarë kanë menduar, mendimet e tyre mësimdhënësi/ja i shkruan në tabelë, pa i mohuar apo pohuar ato, pasi këto mendime do të vlerësohen nga nxënësit si të sakta apo të gabuara në fund të orës mësimore.

KUBIMI

Nxënësit ndahen në grupe pune. Pasi të kenë lexuar njësinë mësimore dhe sqaruar gjithçka paraprakisht. Nga grupet zgjidhet nga një përfaqësues i grupit dhe, përmes zgjedhjes së faqes së kubit, ai zgjedh edhe pyetjen që do t'i përgjigjet, nëse përfaqësuesi i grupit ka vështirësi të përgjigjet, atëherë e ndihmojnë pjesëtarët e tjerë të grupit. Në faqet e kubit janë shkruar fjalët: përshkruani, krahasoni, shpjegoni, ndërtoni, zbatoni, argumentoni.

Grupi 1 - Përshkruani karakteristikat e dy tipave të qelizave.

Grupi 2 - Krahasoni llojet e organeleve që ndodhen në dy tipat e qelizave.

Grupi 3 - Shpjegoni ndërtimin e qelizës bimore dhe organelet përbërëse.


Grupi 4 - Analizoni ndërtimin e qelizës shtazore dhe organelet përbërëse.

Grupi 5 - Argumentoni tri ndryshimet kryesore të dy tipave të qelizave.

Grupi 6 - Zbatoni dhe vizatoni një qelizë bimore dhe një shtazore.

DIAGRAMI I VENIT

Përmes Diagramit të Venit nxënësit do të përcaktojnë dallimet mes qelizës bimore dhe qelizës shtazore



VLERËSIMI I NXËNËSVE

Vlerësimi me gojë (diskutime, debate, prezantime).

DETYRAT DHE PUNA E PAVARUR

Punoni qelizën bimore dhe shtazore me mjetet që keni në shtëpi duke i specifikuar organelet qelizore.

REFLEKTIM PËR RRJEDHËN EORËS MËSIMORE

PLANIFIKIMI I ORËS MËSIMORE


ASPEKTET E PËRGJITHSHME TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE		
Fusha kurrikulare: Shkencat e natyrës Klasa: VIII	Lënda: Biologji	Shkalla e kurrikulës: IV
Tema (nga plani dymujor): Biologjia e qelizës	Rezultati i të nxënit të temës (nga plani dymujor): <i>Krahason qelizat prokariote me ato eukariote.</i>	
Rezultatet e të nxënit për kompetencat kryesore të shkallës (të synuara):		
<p>III 4. <i>I parashtron pyetje vetes për çështjet që trajton dhe organizon mendimet për të gjetur përgjigje për temën apo problemin e caktuar, duke regjistruar përparimin apo ngecjen derisa të gjejë zgjidhjen përfundimtare.</i></p> <p>III 6. <i>Ndjek në mënyrë të pavarur udhëzimet apo skicat e dhëna në libër, skicë, plan, partiturë muzikore, skenar, koreografi etj., ose të ndonjë burimi tjetër, për të performuar një veprim, aktivitet ose detyrë që kërkohet prej tij/saj.</i></p> <p>IV 1. <i>Vlerëson rëndësinë e punës individuale dhe në grupe për zhvillimin e komunitetit duke paraqitur, në forma të ndryshme të të shprehurit, shembuj konkretë nga jeta e përditshme.</i></p>		
Rezultatet e fushës së kurrikulës (të synuara):		
<i>Dallon dhe krahason ndërtimin dhe funksionin e qelizës, indeve, organeve dhe sistemeve të organeve, duke iu referuar biodiversitetit të qenieve të gjalla, shkaktarët e sëmundjeve të njeriut, shtazët bimët dhe mënyrat e kontrollit të tyre, metabolizmin, zhvillimin individual të njeriut dhe evolucionin e qenieve të gjalla. Shpjegon rolin e karbohidrateve, mineraleve, lipideve, proteinave, vitaminave, ujit dhe fibrave për dietë të shëndetshme dhe llogarit nevojën ditore për energji nga ushqimet e konsumuara.</i>		
ASPEKTET SPECIFIKE TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE		
Njësia mësimore: Qeliza prokariote dhe eukariote		
Fjalët kyçe: <i>qelizë eukariote, prokariote, mur qelizor, bërthamë.</i>		
Rezultati/et e të nxënit për orë mësimore:		
<i>Përmend karakteristikat e përbashkëta që kanë të gjitha qelizat; Shpjegon ndërtimin e një qelize prokariote e eukariote; Krahason duke gjetur anët e përbashkëta dhe ndryshimet midis një qelize prokariote dhe një qelize eukariote.</i>		
Kriteret e suksesit:		
<i>Rendit të paktën tri karakteristika të përbashkëta që kanë të gjitha qelizat; Dallo qelizën eukariote nga qeliza prokariote.</i>		
Burimet, mjetet e konkretizimit dhe materialet mësimore:		
<i>Libri Biologjia 8, kubi, laptop, projektor, fotografi.</i>		

Lidhja me lëndët e tjera mësimore dhe/apo me çështjet ndërkurrikulare dhe situatat jetësore: *Gjuhë dhe komunikim, Art figurativ, Kimi, TIK.*

PËRSHKRIMI I METODOLOGJISË DHE VEPRIMTARITË E PUNËS ME NXËNËS GJATË ORËS MËSIMORE

IMAGJINATË E DREJTUAR

Mësimdhënësi/ja paraqet në ekran dy fotografi njëra eukariote e tjetra prokariote, dhe i udhëzon nxënësit të shikojnë me vëmendje fotografitë për disa minuta dhe pastaj të komentojnë çfarë kanë vërejtur.



KUBIMI


Nxënësit ndahen në grupe me 5-6 nxënës dhe u jepet detyrë të lexojnë temën “qeliza prokariote dhe eukariote”. Secilit grup i është dhënë nga një kub, në faqet e të cilit janë shkruar foljet: përshkruani, krahasoni, shpjegoni, analizoni, zbatoni dhe argumentoni. Për secilën nga këto veprime, mësimdhënësi/ja ka përgatitur pyetje e ushtrime, të cilat i ka shkruar në tabelë. Nxënësit e lexojnë me kujdes tekstin, për të gjetur përgjigjet e pyetjeve:

- 1. Përshkruani karakteristikat e bërthamës në një qelizë prokariote dhe në një qelizë eukariote.*
- 2. Krahasoni llojet e organeleve që ndodhen në dy tipat e qelizave.*
- 3. Shpjegoni ndërtimin e përgjithshëm të qelizës prokariote dhe eukariote.*
- 4. Analizoni se përse bakteret janë më primitive në qelizat e tjera.*
- 5. Zbatoni: Jepni dy shembuj nga jeta e përditshme, ku bakteret janë të domosdoshme në jetën tonë.*
- 6. Argumentoni se si qeliza eukariote ka mundësi të kryejë njëkohësisht shumë funksione të pavarura nga njëri-tjetri.*

DIAGRAMI I VENIT

Mësimdhënësi/ja i udhëzon nxënësit që të ndërtojnë në tabelë Diagramin e Venit dhe të përcaktojnë organelet e përbashkëta dhe ndryshimet që kanë dy llojet e qelizave prokariote dhe eukariote bazuar edhe në njohuritë që fituan.

Shembull:



VLERËSIMI I NXËNËSVE

Vlerësimi me gojë (diskutime, debate, prezantime).

DETYRAT DHE PUNA E PAVARUR

Punoni qelizën eukariote dhe prokariote me mjetet që keni në shtëpi.

REFLEKTIM PËR RRJEDHËN EORËS MËSIMORE

PLANIFIKIMI I ORËS MËSIMORE

ASPEKTET E PËRGJITHSHME TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE		
Fusha kurrikulare: Shkencat e natyrës Klasa: VIII	Lënda: Biologji	Shkalla e kurrikulës: IV
Tema (nga plani dymujor): Biologjia e qelizës	Rezultati i të nxënit të temës (nga plani dymujor): <i>Argumenton unitetin e botës së gjallë dhe jo të gjallë nëpërmjet njohjes së përbërjes kimike dhe veçorive fiziko-kimike të qelizës.</i>	
Rezultatet e të nxënit për kompetencat kryesore të shkallës (të synuara):		
<p>I 1. Transmeton saktë të dhënat e mbledhura për një temë konkrete, në formë tekstuale, numerike, verbale, elektronike apo në ndonjë formë tjetër të të shprehurit.</p> <p>II 8. Identifikon me anë të krahasimit dallimet dhe ngjashmëritë midis ligjeve dhe dukurive që ndodhin në natyrë me ato në shoqëri, duke vënë në dukje lidhjen shkak-pasojë midis këtyre dukurive.</p>		
Rezultatet e fushës së kurrikulës (të synuara):		
<p><i>Dallon dhe krahason ndërtimin dhe funksionin e qelizës, indeve, organeve dhe sistemeve të organeve, duke iu referuar biodiversitetit të qenieve të gjalla, shkaktarët e sëmundjeve të njeriut, shtazët, bimët dhe mënyrat e kontrollit të tyre, metabolizmin, zhvillimin individual të njeriut dhe evolucionin e qenieve të gjalla.</i></p> <p style="text-align: right;"><i>Shpjegon rolin e karbohidrateve, mineraleve, lipideve, proteinave, vitaminave, ujit dhe fibrave për dietë të shëndetshme dhe llogarit nevojën ditore për energji nga ushqimet e konsumuara.</i></p>		
ASPEKTET SPECIFIKE TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE		
Njësia mësimore: Veçoritë fizike dhe kimike të qelizës		
Fjalët kyçe: <i>qelizë, ujë, përbërës organik, përbërës joorganik.</i>		
Rezultati/et e të nxënit për orë mësimore:		
<p><i>Dallon përbërjen kimike të qelizës;</i> <i>Shpjegon rolin që ka uji në përbërjen e qelizës;</i> <i>Arsyeton rëndësinë e përbërësve organikë që marrin pjesë në ndërtimin e qelizës.</i></p>		
Kriteret e suksesit:		
<p><i>Numëro të paktën pesë elemente kimike që hyjnë në përbërje të qelizës;</i> <i>Specifikon mënyrat e pjesëmarrjes së ujit në përbërje të qelizës;</i> <i>Defino përbërësit organikë që marrin pjesë në ndërtimin e qelizës.</i></p>		
Burimet, mjetet e konkretizimit dhe materialet mësimore:		
<i>Libri Biologjia 8, tabela, fletorja.</i>		


Lidhja me lëndët e tjera mësimore dhe/apo me çështjet ndërkurrikulare dhe situatat jetësore: *Gjuhë dhe komunikim, art figurativ, kimi.*

PËRSHKRIMI I METODOLOGJISË DHE VEPRIMTARITË E PUNËS ME NXËNËS GJATË ORËS MËSIMORE

Kllaster

Mësimdhënësi/ja shkruan në tabelë temën e re “Veçoritë fizike dhe kimike të qelizës”, dhe u kërkon nxënësve të mendojnë për disa minuta lidhur me temën e dhënë dhe të punojnë një kllaster me njohuritë që tashmë kanë fituar për qelizën dhe ndërtimin e saj duke u bazuar në temën e re. Kllasteri punohet në tabelë në mënyrë që idetë e nxënësve të nxisin njëri-tjetrin të jenë sa më aktivë.

Kjo teknikë nxit nxënësit që të mendojnë në mënyrë kritike dhe të arrijnë të shkruajnë sa më shumë informacione, këto të fundit sigurisht nuk janë të pakta, pasi nxënësit tashmë i kanë njohuritë bazë për përbërjen e qelizës.



Shembull i kllasterit

Leksion i avancuar

Mësimdhënësi/ja, pasi shikon se si ka rrjedhur realizimi i pjesës së parë, atëherë mësimdhënësi-ja u shpjegon nxënësve më në detaje njësinë mësimore. Shpjegon se qeliza si njësi e organizuar mirë e jetës, paraqet një kompleks të ndërlikuar të shumë substancave kimike joorganike dhe organike. Në materiet joorganike, që marrin pjesë në përbërjen e qelizës, bëjnë pjesë: uji dhe elementet kimike, qoftë në formë kripërash të ndryshme minerale apo në formë të joneve. Analizat kimike të qelizave të ndryshme bimore e shtazore dëshmojnë se në sasi më të mëdha përmbajnë: oksigjen, karbon dhe hidrogjen. Me sasi shumë të vogla janë elementet e tjera, si p.sh.: silici, kalciumi, azoti, kaliumi, fosfori, magnezi, klori, natriumi, hekuri etj. Me lidhje të ndërsjellë të materieve inorganike krijohen biomolekula organike. Këto biomolekula organike shfrytëzohen për sintezë të pjesëve ndërtuese qelizore, që sintetizojnë makromolekula me rëndësi të veçantë. Ekzistojnë katër klasa makromolekulash në qelizë: acide nukleinike, proteina, polisaharide dhe lipide. Pastaj i udhëzon nxënësit që të lexojnë njësinë mësimore në libër, u jep sqarimet e nevojshme aty ku ata kanë vështirësi.

DISKUTIM

Krejt në fund mësimdhënësi/ja realizon një diskutim me nxënësit orientuar me pyetje nga ai/ajo, me qëllim që të kuptohet se sa janë arritur rezultatet e të nxënit. Sigurisht u jepet përparësi nxënësve që janë më të heshtur që të flasin, duke mos anashkaluar edhe nxënësit më aktivë, sepse kështu bëjmë një matje më reale të realizimit të njësisë mësimore.

VLERËSIMI I NXËNËSVE

Vlerësimi me gojë (diskutime, debate, prezantime).

DETYRAT DHE PUNA E PAVARUR

REFLEKTIM PËR RRJEDHËN EORËS MËSIMORE

PLANIFIKIMI I ORËS MËSIMORE

ASPEKTET E PËRGJITHSHME TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE

Fusha kurrikulare: Shkencat e natyrës
Klasa: VIII

Lënda: Biologji

Shkalla e kurrikulës: IV

Tema (nga plani dymujor):

Biologjia e qelizës

Rezultati i të nxënit të temës (nga plani dymujor):

Organizon lidhshmërinë e koncepteve hierarkike: qelizë, inde, organe, sisteme të organeve dhe organizëm;

Organizon lidhshmërinë e koncepteve hierarkike të organizmave: organizma njëqelizorë, kolonialë dhe shumëqelizorë.

Rezultatet e të nxënit për kompetencat kryesore të shkallës (të synuara):

I 6. Analizon përmbajtjen dhe kuptimin e nocioneve (koncepteve) të reja, duke përdorur leksikun adekuat, të përshtatshëm dhe të saktë dhe i bën ato pjesë të dosjes mësimore.

III 1. Regjistron në formë të shkruar, grafike, me TI etj., informatat ose faktet për një temë të caktuar duke i veçuar, me anë të teknikave të ndryshme, pjesët e rëndësishme dhe më pak të rëndësishme të nevojshme për atë temë/detyrë të dhënë.

III 4. I parashtron pyetje vetes për çështjet që trajton dhe organizon mendimet për të gjetur përgjigje për temën apo problemin e caktuar, duke regjistruar përparimin apo ngecjen derisa të gjejë zgjidhjen përfundimtare.

Rezultatet e fushës së kurrikulës (të synuara):

Dallon dhe krahason ndërtimin dhe funksionin e qelizës, indeve, organeve dhe sistemeve të organeve, duke iu referuar biodiversitetit të qenieve të gjalla, shkaktarët e sëmundjeve te njeriu, shtazët, bimët dhe mënyrat e kontrollit të tyre, metabolizmin, zhvillimin individual të njeriut dhe evolucionin e qenieve të gjalla.

Shpjegon rolin e karbohidrateve, mineraleve, lipideve, proteinave, vitaminave, ujit dhe fibrave për dietë të shëndetshme dhe llogarit nevojën ditore për energji nga ushqimet e konsumuara.

ASPEKTET SPECIFIKE TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE

Njësia mësimore: Qelizat japin indet

Fjalët kyçe: qelizë, ind, organ, sistem i organeve, organizëm.

Rezultati/et e të nxënit për orë mësimore:

Definon qartë konceptet qelizë, ind, organ, organizëm;

Përshkruan radhitjen logjike të koncepteve qelizë, ind, organ;

Sqaron funksionin e indeve kryesore.

Kriteret e suksesit:

Identifikon nga figura qelizën, indin, organin, organizmin;

Jep një shembull të organizimit hierarkik të një organizmi;

Dallo funksionet e indeve kryesore.


Burimet, mjetet e konkretizimit dhe materialet mësimore: Libri *Biologjia 8*, laptop, projektor, fotografi.

Lidhja me lëndët e tjera mësimore dhe/apo me çështjet ndërkurrikulare dhe situatat jetësore: Gjuhë dhe komunikim, art figurativ, kimi, TIK.

PËRSHKRIMI I METODOLOGJISË DHE VEPRIMTARITË E PUNËS ME NXËNËS GJATË ORËS MËSIMORE

ALFABETI I NJËPASNJËSHËM

Mësimdhënësi/ja paraqet në ekran disa fotografi me numrat përkatës dhe u kërkon nxënësve t'i shikojnë me vëmendje fotografitë dhe t'i rendisin ato, duke filluar nga më të thjeshtat deri te më të ndërlikuarat. Pastaj fton nxënësit të fillojnë diskutimin, mirëpo nuk jep ndonjë koment nëse janë renditur mirë fotografitë apo jo, pasi këtë vlerësim nxënësit do ta bëjnë në fund të mëimit.




INSERT

Në këtë fazë bëhet leximi i pjesës duke vendosur shenjat , =, -, ?. Nënvizimet e bëra në libër hidhen në tabelën e INSERT-it. Pra, pjesët kryesore të mësimit, të shënuara me shenjat përkatëse, hidhen në tabelë, (shenja V vendoset për atë pjesë që nxënësit dinë, shenja + për pjesën që është shtuar e re, shenja – për pjesën që nuk e dinë, dhe shenja ? për pjesën që nuk kuptojnë.)

<input checked="" type="checkbox"/>	+	-	?

DISKUTIM

Pasi nxënësit kanë përfunduar tabelën INSERT, tani mësimitdhënësi/ja u sqaron atyre përmbajtjet për të cilët ata kanë vendosur shenjen ?. Pastaj fillon një diskutim i hapur për të gjithë klasën. Gjithashtu, mësimitdhënësi vendos në fund fotografitë në bazë të renditjes adekuate.



VLERËSIMI I NXËNËSVE

Vlerësimi individual dhe grupor gjatë punës kërkimore.

DETYRAT DHE PUNA E PAVARUR

Hulumtoni për ndërtimin dhe funksionin e indeve të organizmave shtazorë.

REFLEKTIM PËR RRJEDHËN EORËS MËSIMORE

PLANIFIKIMI I ORËS MËSIMORE

ASPEKTET E PËRGJITHSHME TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE		
<p>Fusha kurrikulare: Shkencat e natyrës Lënda: Biologji Shkalla e kurrikulës: IV Klasa: VIII</p>		
<p>Tema (nga plani dymujor): Indet, organet dhe sistemet e organeve te shtazët</p>	<p>Rezultati i të nxënit të temës (nga plani dymujor): <i>Hulumton dhe përshkruan ndërtimin dhe funksionin e indeve, organeve dhe të sistemeve të organeve të shtazët; Organizon lidhshmërinë e koncepteve hierarkike të organizmave: organizma njëqelizorë, kolonialë dhe shumëqelizorë; Përshkruan ndërlidhjen e ndërtimit dhe të funksionit ndërmjet organeve të ndryshme.</i></p>	
<p>Rezultatet e të nxënit për kompetencat kryesore të shkallës (të synuara):</p> <p>II 2. <i>Përzgjedh informata nga burime të ndryshme, për një temë konkrete, i klasifikon ato në bazë të një kriteri të caktuar dhe i përdor ato për marrjen e një vendimi apo për zgjidhjen e një problemi/detyre.</i></p> <p>III 7. <i>Shfrytëzon në mënyrë të efektshme teknika të ndryshme gjatë të nxënit të temës së dhënë, duke veçuar informatat që i kupton nga informatat e reja, të panjohura, si dhe informatat që për të mbeten ende të paqarta.</i></p>		
<p>Rezultatet e fushës së kurrikulës (të synuara):</p> <p><i>Dallon dhe krahason ndërtimin dhe funksionin e qelizës, indeve, organeve dhe sistemeve të organeve, duke iu referuar biodiversitetit të qenieve të gjalla, shkaktarët e sëmundjeve te njeriu, shtazët, bimët dhe mënyrat e kontrollit të tyre, metabolizmin, zhvillimin individual të njeriut dhe evolucionin e qenieve të gjalla.</i></p> <p><i>Shpjegon rolin e karbohidrateve, mineraleve, lipideve, proteinave, vitaminave, ujit dhe fibrave për dietë të shëndetshme dhe llogarit nevojën ditore për energji nga ushqimet e konsumuara.</i></p>		
ASPEKTET SPECIFIKE TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE		
<p>Njësia mësimore: Nga indet te organet dhe sistemet e organeve</p>		
<p>Fjalët kyçe: <i>ind, organe, mëlqia, rrënja, veshkët, organizëm.</i></p>		
<p>Rezultati/et e të nxënit për orë mësimore:</p> <p><i>Definon konceptin ind;</i> <i>Tregon dallimin në mes të indeve dhe organeve.</i></p> <p>Kriteret e suksesit:</p> <p><i>Sqaro konceptin ind, organ, organizëm;</i> <i>Krahaso indin-organet.</i></p>		

Burimet, mjetet e konkretizimit dhe materialet mësimore:

Libri Biologjia 8.

Lidhja me lëndët e tjera mësimore dhe/apo me çështjet ndërkurrikulare dhe situatat jetësore:

Gjuhë dhe komunikim, kimi.

PËRSHKRIMI I METODOLOGJISË DHE VEPRIMTARITË E PUNËS ME NXËNËS GJATË ORËS MËSIMORE

STUHI MENDIMESH

Mësimdhënësi/ja shkruan në tabelë titullin “Nga indet te organet dhe sistemet e organeve”, dhe u kërkon nxënësve të shpalosin njohuritë e tyre lidhur me temën duke u bazuar në njohuritë paraprake. Pasi kanë menduar në heshtje, u jep fjalën nxënësve të shprehin atë çfarë kanë menduar, mendimet e tyre mësimdhënësi/ja i shkruan në tabelë pa i mohuar apo pohuar ato.

DRTA

Në vijim mësimdhënësi/ja u shpjegon nxënësve procedurën, e cila do të zhvillohet si më poshtë: Hapet teksti në temën mësimore “Nga indet te organet dhe sistemet e organeve” dhe u kërkon nxënësve që të lexojnë me pjesë të ndara, pra sipas leximit të drejtuar DRTA, duke realizuar kështu realizimin e kuptimit.

SHKRIM I LIRË - ESE

*Pasi nxënësit të kenë mbaruar leximin dhe kanë sqaruar çdo paqartësi, ata i udhëzon mësimdhënësi të shkruajnë nga një ese të shkurtër lidhur me temën dhe çfarë mbajtën në mend.
(foto shembull)*

VLERËSIMI I NXËNËSVE

Vlerësimi me gojë (diskutime, debate, prezantime).

DETYRAT DHE PUNA E PAVARUR

REFLEKTIM PËR RRJEDHËN EORËS MËSIMORE

PLANIFIKIMI I ORËS MËSIMORE

ASPEKTET E PËRGJITHSHME TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE	
Fusha kurrikulare: Shkencat e natyrës Lënda: Biologji Shkalla e kurrikulës: IV Klasa: VIII	
Tema (nga plani dymujor): Indet, organet dhe sistemet e organeve te shtazët	Rezultati i të nxënit të temës (nga plani dymujor): <i>Përdor terminologjinë korrekte anatomike, kur shqipton topografinë e pjesëve të trupit të jokurrizorëve dhe të kurrizorëve;</i> <i>Hulumton dhe përshkruan ndërtimin dhe funksionin e indeve, organeve dhe të sistemeve të organeve të shtazët;</i> <i>Emërton indet kryesore shtazore, përshkruan ndërtimin dhe funksionin e tyre.</i>
Rezultatet e të nxënit për kompetencat kryesore të shkallës (të synuara): I 1. Transmeton saktë të dhënat e mbledhura për një temë konkrete, në formë tekstuale, numerike, verbale, elektronike apo në ndonjë formë tjetër të të shprehurit. I 6. Analizon përmbajtjen dhe kuptimin e nocioneve (koncepteve) të reja, duke përdorur leksikon adekuat, të përshtatshëm dhe të saktë dhe i bën ato pjesë të dosjes mësimore. II 2. Përzgjedh informata nga burime të ndryshme, për një temë konkrete, i klasifikon ato në bazë të një kriteri të caktuar dhe i përdor ato për marrjen e një vendimi apo për zgjidhjen e një problemi/detyre.	
Rezultatet e fushës së kurrikulës (të synuara): <i>Dallon dhe krahason ndërtimin dhe funksionin e qelizës, indeve, organeve dhe sistemeve të organeve, duke iu referuar biodiversitetit të qenieve të gjalla, shkaktarët e sëmundjeve te njeriu, shtazët, bimët dhe mënyrat e kontrollit të tyre, metabolizmin, zhvillimin individual të njeriut dhe evolucionin e qenieve të gjalla.</i> <i>Shpjegon rolin e karbohidrateve, mineraleve, lipideve, proteinave, vitaminave, ujit dhe fibrave për dietë të shëndetshme dhe llogarit nevojën ditore për energji nga ushqimet e konsumuara.</i>	
ASPEKTET SPECIFIKE TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE	
Njësia mësimore: Ndërtimi dhe funksioni i indeve, i organeve dhe i sistemeve të organeve të shtazëve pakurrizore	
Fjalët kyçe: <i>sfungjerë, grykorë, krimba, këmbënyjtuar, butakë, organe, inde.</i>	
Rezultati/et e të nxënit për orë mësimore: <i>Sqaron veçoritë kryesore të shtazëve me inde, por pa organe;</i> <i>Konkludon pse quhen këmbënyjtuar;</i> <i>Shpjegon veçoritë e butakëve.</i>	
Kriteret e suksesit: <i>Numëro grupet kryesore të shtazëve pakurrizore;</i>	

Emërto grupet më të rëndësishme të këmbënyjësuarve;
Trego kush bën pjesë në butakë dhe pse janë emërtuar të tillë.

Burimet, mjetet e konkretizimit dhe materialet mësimore: *Libri Biologjia 8*.

Lidhja me lëndët e tjera mësimore dhe/apo me çështjet ndërkurrikulare dhe situatat jetësore:
Gjuhë dhe komunikim, gjeografi, ekologji.

PËRSHKRIMI I METODOLOGJISË DHE VEPRIMTARITË E PUNËS ME NXËNËS GJATË ORËS MËSIMORE

STUHI MENDIMESH

Mësimdhënësi/ja kërkon nga nxënësit që të shprehin mendimet e tyre në lidhje me njësinë mësimore **“Ndërtimi dhe funksioni i indeve, i organeve dhe i sistemeve të organeve të shtazëve pakurrizore”**. Fillimisht u kërkon të dallojnë cilat shtazë bëjnë pjesë në grupin e shtazëve pakurrizore, e pastaj edhe të flasin për karakteristikat dalluese të tyre.

DITARI DYPJESËSH

Mësimdhënësi/ja organizon në dyshe grupet e punës. Udhëzon nxënësit se çfarë duhet të lexojnë duke mbajtur shënime dhe të interpretojnë duke plotësuar modelin e ditarit dypjesësh, të cilin e punojnë në fletë A4 (që e përdorin pastaj si pjesë të dosjes së mësimt), si në tabelë. Në njërën anë do të shkruajnë koceptet kryesore, e përkrah saj do të sqarojnë këto koncepte me fjali të shkurta dhe kuptim plot.

Konceptet	Sqarimet
Sfungjerët - shtazët pa inde	Trupin e kanë të ndërtuar nga dy shtresa qelizash. Shtresa e jashtme përbëhet nga qeliza shumëkëndëshe të shtypura, që kanë rol mbrojtës. Nuk kanë inde të vërteta, ata kanë qeliza të specializuara që kryejnë funksione të ndryshme.
Grykorët	
Krimbat	Në bazë të ndërtimit të trupit, dallohen tre tipa të krimbave: krimbat e shtypur, krimbat e rrumbullakët dhe krimbat unazorë. Kanë sisteme të thjeshta të organeve, ndër më kryesoret janë: sistemi i tretjes, i tajitjes, i qarkullimit të lëngjeve trupore dhe sistemi nervor.
Këmbënyjësuarit	
Butakët	
Lëkurëgjemborët	

Shembull i ditarit dypjesësh:

RRJETI I DISKUTIMIT

Pasi nxënësit të kenë plotësuar ditarin dypjesësh, mësimdhënësi/ja fton ata për diskutim lidhur me sqarimet e koncepteve, dhe në të njëjtën kohë kontrollon nëse janë dhënë sqarimet e sakta lidhur me konceptet.

VLERËSIMI I NXËNËSVE

Vlerësimi me gojë (diskutime, debate, prezantime).

DETYRAT DHE PUNA E PAVARUR

REFLEKTIM PËR RRJEDHËN EORËS MËSIMORE

PLANIFIKIMI I ORËS MËSIMORE

ASPEKTET E PËRGJITHSHME TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE

Fusha kurrikulare: Shkencat e natyrës Lënda: Biologji Shkalla e kurrikulës: IV
Klasa: VIII

Tema (nga plani dymujor):
Indet, organet dhe sistemet e organeve te shtazët

Rezultati i të nxënit të temës (nga plani dymujor):

Përdor terminologjinë korrekte anatomike kur shqipton topografinë e pjesëve të trupit të jokurrizorëve dhe të kurrizorëve. Hulumton dhe përshkruan ndërtimin dhe funksionin e indeve, organeve dhe të sistemeve të organeve të shtazët. Emërton indet kryesore shtazore, përshkruan ndërtimin dhe funksionin e tyre. Përshkruan ndërlidhjen e ndërtimit dhe të funksionit ndërmjet organeve të ndryshme.

Rezultatet e të nxënit për kompetencat kryesore të shkallës (të synuara):

I 1. Transmeton saktë të dhënat e mbledhura për një temë konkrete, në formë tekstuale, numerike, verbale, elektronike apo në ndonjë formë tjetër të të shprehurit.

I 5. Prezanton para të tjerëve një projekt për një temë të dhënë, të përgatitur vetë ose në bashkëpunim me grupin, duke gërshetuar format e komunikimit verbal, elektronik dhe veprimin praktik.

II 8. Identifikon me anë të krahasimit dallimet dhe ngjashmëritë midis ligjeve dhe dukurive që ndodhin në natyrë me ato në shoqëri, duke vënë në dukje lidhjen shkak-pasojë midis këtyre dukurive.

Rezultatet e fushës së kurrikulës (të synuara):

Dallon dhe krahason ndërtimin dhe funksionin e qelizës, indeve, organeve dhe sistemeve të organeve, duke iu referuar biodiversitetit të qenieve të gjalla, shkaktarët e sëmundjeve të njeriut, shtazët, bimët dhe mënyrat e kontrollit të tyre, metabolizmin, zhvillimin individual të njeriut dhe evolucionin e qenieve të gjalla. Shpjegon rolin e karbohidrateve, mineraleve, lipideve, proteinave, vitaminave, ujit dhe fibrave për dietë të shëndetshme dhe llogarit nevojën ditore për energji nga ushqimet e konsumuara.

ASPEKTET SPECIFIKE TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE

Njësia mësimore: Ndërtimi dhe funksioni i indeve, i organeve dhe i sistemit të organeve të shtazëve kurrizore

Fjalët kyçe: *shtyllë kurrizore, luspa, penda, lesh, ekzoterm, endoterm.*

Rezultati/et e të nxënit për orë mësimore:

*Përshkruan karakteristikat e kurrizorëve;
Veçon dallimet specifike për secilin grup të kurrizorëve.*

Kriteret e suksesit:

*Krahaso kurrizorët nga pakurrizorët;
Specifiko të pesë grupet e kurrizorëve, mbulesën trupore, lëvizjen, përshtatjen me jetën në përgjithësi.*

Burimet, mjetet e konkretizimit dhe materialet mësimore:

Libri Biologjia 8, lapotopi, projektori, video.

Lidhja me lëndët e tjera mësimore dhe/apo me çështjet ndërkurrikulare dhe situatat jetësore:

Gjuhë dhe komunikim, kimi, gjeografi, ekologjia dhe mjedisi, TIK, art figurativ.

PËRSHKRIMI I METODOLOGJISË DHE VEPRIMTARITË E PUNËS ME NXËNËS GJATË ORËS MËSIMORE

IMAGJINATË E DREJTUAR

Gjatë kësaj faze, mësimdhënësi/ja u kërkon nxënësve të shikojnë në ekran një video në të cilën bëhet një përshkrim i botës shtazore, duke filluar nga peshqit, ujëtokësorët, zvarranikët, shpendët dhe gjitarët. Bëhet një përshkrim i pamjes së jashtme dhe i vendit ku jetojnë. U kërkon nxënësve që të përcjellin me vëmendje videon, edhe pasi kanë përcjellë, fillon diskutimin, çfarë kanë parë në video, çfarë është e veçanta e videos etj.

<https://www.youtube.com/watch?v=mRidGna-V4E>

LEKSION I AVANCUAR

Mësimdhënësi/ja u shpjegon nxënësve në pika të shkurta karakteristikat dalluese të kurrizorëve që i dallojnë nga pakurrizorët. Shtazët kurrizore i kanë të zhvilluara mirë sistemet e organeve. Kurrizorët janë ose ekotermë ose endotermë. Peshqit kanë trup që është përshtatur mirë me jetën në ujë. Shumica e peshqve e kanë të mbuluar trupin me luspa të cilat e mbrojnë atë. Kanë pendë teke (penda e kurrizit dhe e bishtit) apo çifte (pendët shpinore dhe barkore), që u ndihmojnë për notim. Ujëtokësorët ndryshe quhen edhe amfibë. Amfib (greqisht) do të thotë “jetë e dyfishtë”, përkatësisht “jetë uji”, meqë vezët e larvat e tyre jetojnë në ujë, dhe “jetë tokësore”, meqë të rritura jetojnë në tokë. Zvarranikët kanë lëkurë të trashë, të thatë, të mbuluar nga një shtresë e brirëzuar. Shtresa e brirëzuar mund të jetë në forma luspash ose pllakash. Shpendët (zogjtë) janë shtazë me gjak të ngrohtë (endotermik). Janë kurrizorët e vetëm që kanë pupla, të cilat janë izoluese të mira dhe i ndihmojnë zogjtë ta ruajnë temperaturën konstante (të qëndrueshme) të trupit. Gjitarët janë kurrizorët e vetëm që kanë gjëndra qumështore,

prej nga e kanë marrë edhe emrin gjitarë. Janë organizma me gjak të ngrohtë (endotermik). Trupin e kanë të mbuluar me qime.

KLLASTER

Pasi nxënësit kanë lexuar njësinë mësimore në heshtje, mësimdhënësi/ja i fton ata të punojnë një kllaster në formë të përmbledhjes, fillimisht punojnë në grupe. Pastaj mësimdhënësi/ja i fton ata që të njëjtin ta punojnë edhe në tabelë, duke bashkëpunuar njëri me tjetrin.



Shembull i kllasterit.

VLERËSIMI I NXËNËSVE

Vlerësimi me gojë (diskutime, debate, prezantime).

DETYRAT DHE PUNA E PAVARUR

REFLEKTIM PËR RRJEDHËN E ORËS MËSIMORE

PLANIFIKIMI I ORËS MËSIMORE

ASPEKTET E PËRGJITHSHME TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE	
Fusha kurrikulare: Shkencat e natyrës Klasa: VIII	Lënda: Biologji Shkalla e kurrikulës: IV
Tema (nga plani dymujor): Indet, organet dhe sistemet e organeve te shtazët	Rezultati i të nxënit të temës (nga plani dymujor): Emërton dhe shpjegon indet, organet dhe sistemin e organeve muskulore.
Rezultatet e të nxënit për kompetencat kryesore të shkallës (të synuara):	
<p>I 1. Transmeton saktë të dhënat e mbledhura për një temë konkrete, në formë tekstuale, numerike, verbale, elektronike apo në ndonjë formë tjetër të të shprehurit.</p> <p>I 6. Analizon përmbajtjen dhe kuptimin e nocioneve (koncepteve) të reja, duke përdorur leksikun adekuat, të përshtatshëm dhe të saktë dhe i bën ato pjesë të dosjes mësimore.</p> <p>III 6. Ndjek në mënyrë të pavarur udhëzimet apo skicat e dhëna në libër, skicë, plan, partiturë muzikore, skenar, koreografi etj., ose të ndonjë burimi tjetër, për të performuar një veprim, aktivitet ose detyrë që kërkohet prej tij/saj.</p>	
Rezultatet e fushës së kurrikulës (të synuara):	
<p>Dallon dhe krahason ndërtimin dhe funksionin e qelizës, indeve, organeve dhe sistemeve të organeve, duke iu referuar biodiversitetit të qenieve të gjalla, shkaktarët e sëmundjeve te njeriu, shtazët, bimët dhe mënyrat e kontrollit të tyre, metabolizmin, zhvillimin individual të njeriut dhe evolucionin e qenieve të gjalla.</p> <p style="text-align: right;">Shpjegon rolin e karbohidrateve, mineraleve, lipideve, proteinave, vitaminave, ujit dhe fibrave për dietë të shëndetshme dhe llogarit nevojën ditore për energji nga ushqimet e konsumuara.</p>	
ASPEKTET SPECIFIKE TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE	
Njësia mësimore: Indet, organet dhe sistemet e organeve muskulore	
Fjalët kyçe: <i>ind muskolor, muskuj, eshtra, lëvizje.</i>	
Rezultati/et e të nxënit për orë mësimore:	
<p><i>Përshkruan ndërtimin e muskujve;</i> <i>Numëron llojet e indeve muskulore;</i> <i>Analizon ndërtimin dhe rëndësinë që kanë muskujt për lëvizje te shtazët e ndryshme.</i></p>	
Kriteret e suksesit:	
<p><i>Emërto pjesët ndërtuese të muskujve bazuar në fotografi;</i> <i>Konkretizo se cilat inde muskulore cilat lloje të muskujve i përbëjnë;</i> <i>Vlerëso rolin e muskujve te shtazët e ndryshme.</i></p>	
Burimet, mjetet e konkretizimit dhe materialet mësimore:	
<i>Libri Biologjia 8, tabela, fotografi (të printuara ose nga laptopi)</i>	

Lidhja me lëndët e tjera mësimore dhe/apo me çështjet ndërkurrikulare dhe situatat jetësore: *Gjuhë dhe komunikim, Kimi, Gjeografi, Ekologjia dhe mjedisi.*

PËRSHKRIMI I METODOLOGJISË DHE VEPRIMTARITË E PUNËS ME NXËNËS GJATË ORËS MËSIMORE

KLLASTER

Mësimdhënësi/ja kërkon nga nxënësit që të punojnë një kllaster me njohuritë që tashmë kanë për muskujt dhe lëvizjen. Sigurisht nxënësve do t'u kujtohen mjaft informacione pasi këtë njësi e kanë mësuar edhe më parë.


INSERT

Në këtë fazë bëhet leximi i pjesës (fillimisht paragrafi i parë) duke vendosur shenjat , =, -, ?. Shenja vendoset për atë pjesë që nxënësit dinë, shenja + për pjesën që është shtuar e re, shenja – për pjesën që nuk e dinë, dhe shenja ? për pjesën që nuk kuptojnë. (në tabelë vendosen vetëm informacionet që kanë shenjën ?, pasi duhet të sqarohen nga mësimdhënësi/ja). Kështu vazhdohet edhe me paragrafinë e dytë e kështu me radhë.

<input checked="" type="checkbox"/>	+	-	?

PYETJE - PËRGJIGJE

Mësimdhënësi/ja vendos në tri gota pyetje për të tria nivelet e njohurive. Nxënësit janë të ndarë në grupe, mësimdhënësi/ja fton nxënësit që të tërheqin letrën në mënyrë rastësore, të lexojnë pyetjen dhe të përgjigjen. Kështu, nxënësit nominojnë njëri-tjetrin që të tërheqin pyetjet dhe të përgjigjen. Nominimi bëhet me radhë në mënyrë që secili nxënës në grup të përfshihet, ndërsa mësimdhënësi monitoron procesin dhe në një pjesë të tabelës mban shënime me pikë për përgjigjet e sakta të nxënësve, kështu mësimnxënia merr karakter garues.



Për shembull:

- Emërto pjesët e muskulit në fotografi.
- Numëro llojet e indeve muskulore.
- Vlerëso rëndësinë e muskujeve te organizmat e ndryshëm

VLERËSIMI I NXËNËSVE

Vlerësim për nxënie (informatë kthyesë, vlerësim i ndërsjellët).

DETYRAT DHE PUNA E PAVARUR

Hulumtoni dhe gjeni veçoritë e sistemit të tretjes te shtazët e ndryshme.

REFLEKTIM PËR RRJEDHËN E ORËS MËSIMORE

PLANIFIKIMI I ORËS MËSIMORE
ASPEKTET E PËRGJITHSHME TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE

Fusha kurrikulare: Shkencat e natyrës Lënda: biologji Shkalla e kurrikulës: IV
Klasa: VIII

Tema (nga plani dymujor):

Indet, organet dhe sistemet e organeve te shtazët

Rezultati i të nxënit të temës (nga plani dymujor):

Emërton dhe shpjegon indet, organet dhe sistemin e organeve të tretjes, organet kryesore të sistemit tretës dhe përshkruan ndërtimin dhe funksionin e tyre

Rezultatet e të nxënit për kompetencat kryesore të shkallës (të synuara):

I 1. *Transmeton saktë të dhënat e mbledhura për një temë konkrete, në formë tekstuale, numerike, verbale, elektronike apo në ndonjë formë tjetër të të shprehurit.*

III 6. *Ndjek në mënyrë të pavarur udhëzimet apo skicat e dhëna në libër, skicë, plan, partiturë muzikore, skenar, koreografi etj., ose të ndonjë burimi tjetër, për të performuar një veprim, aktivitet ose detyrë që kërkohet prej tij/saj.*

III 7. *Shfrytëzon në mënyrë të efektshme teknika të ndryshme gjatë të nxënit të temës së dhënë duke veçuar informatat që i kupton nga informatat e reja, të panjohura, si dhe informatat që për të mbeten ende të paqarta.*

Rezultatet e fushës së kurrikulës (të synuara):

Dallon dhe krahason ndërtimin dhe funksionin e qelizës, indeve, organeve dhe sistemeve të organeve, duke iu referuar biodiversitetit të qenieve të gjalla, shkaktarët e sëmundjeve të njeriut, shtazët, bimët dhe mënyrat e kontrollit të tyre, metabolizmin, zhvillimin individual të njeriut dhe evolucionin e qenieve të gjalla.

Shpjegon rolin e karbohidrateve, mineraleve, lipideve, proteinave, vitaminave, ujit dhe fibrave për dietë të shëndetshme dhe llogarit nevojën ditore për energji nga ushqimet e konsumuara.

ASPEKTET SPECIFIKE TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE

Njësia mësimore: **Indet, organet dhe sistemet e organeve të tretjes të shtazëve**

Fjalët kyçe: *tretje, ushqim, gojë, ezofag, radulë.*

Rezultati/et e të nxënit për orë mësimore:

Përshkruan rrugën e tretjes së ushqimit te butakët;

Tregon dallimet e tretjes së ushqimit te këmbënyjtuarit dhe lëkurëgjemborët;

Analizon ndërtimin e sistemit tretës te shpendët dhe peshqit.

Kriteret e suksesit:

Emërto pjesët e sistemit tretës te butakët;

Krahaso tretjen e ushqimit te këmbënyjtuarit dhe lëkurëgjemborët;

Defino si bëhet tretja e ushqimit te shpendët dhe peshqit.

Burimet, mjetet e konkretizimit dhe materialet mësimore:

Libri Biologjia 8, tabela.

Lidhja me lëndët e tjera mësimore dhe/apo me çështjet ndërkurrikulare dhe situatat jetësore:

Gjuhë dhe komunikim, kimi.

PËRSHKRIMI I METODOLOGJISË DHE VEPRIMTARITË E PUNËS ME NXËNËS GJATË ORËS MËSIMORE

STUHI MENDIMESH

*Mësimdhënësi/ja kërkon nga nxënësit të rikujtojnë njohuritë e tyre në lidhje me sistemin e organeve të tretjes. Kështu, shkruan në tabelë titullin e njësisë së re mësimore “**Indet, organet dhe sistemet e organeve të tretjes të shtazëve**”. Informacionet e kësaj njësie mësimore nxënësit tashmë i kanë të freskëta pasi edhe kishin për detyrë të hulumtonin për këtë sistem në detyra të shtëpisë.*

DITARI DYPJESËSH

Mësimdhënësi/ja organizon në dyshe grupet e punës. Udhëzon nxënësit se çfarë duhet të lexojnë duke mbajtur shënime dhe të interpretojnë duke plotësuar modelin e ditarit dypjesësh, si në tabelë. Në njërën anë do të shkruajnë koceptet kryesore e përkrah saj do të sqarojnë këto koncepte me fjali të shkurta dhe kuptimplota. Shembull:

Koncepti	Sqarimi
<i>Tretje e ushqimit te grykorët</i>	
<i>Tretje e ushqimit te krimbat e shtypur</i>	<i>Sistemi i tretjes përbëhet nga goja dhe zorra e mesme, që te disa lloje është e degëzuar deri në fund të trupit. Sistemi i tretjes i krimbave të rrumbullakët dhe unazorë përbëhet nga organet për tretje, siç janë: goja, ezofagu, zorra (ku tretet ushqimi) dhe vrima anale.</i>
<i>Tretje e ushqimit te butakët</i>	
<i>Tretje e ushqimit te këmbënyjëtuarit</i>	
<i>Tretje e ushqimit te lëkurëgjemborët</i>	
<i>Tretje e ushqimit te peshqit</i>	<i>Sistemi i tretjes përbëhet nga goja, ezofagu, lukthi dhe zorra. Në zorrë bëhet tretja e ushqimit, që ndihmohet edhe nga lëngu i mëlçisë. Ky sistem përfundon me vrimën anale, përmes së cilës del jashtë ushqimi i patretur.</i>
<i>Tretje e ushqimit te ujëtokësorët</i>	
<i>Tretje e ushqimit te zvarranikët</i>	
<i>Tretje e ushqimit te shpendët</i>	

RRJETI I DISKUTIMIT

Pasi nxënësit të kenë plotësuar ditarin dypjesësh, mësimsdhënësi/ja fton ata për diskutim lidhur me sqarimet e koncepteve, dhe në të njëjtën kohë kontrollon nëse janë dhënë sqarimet e sakta lidhur me konceptet.

VLERËSIMI I NXËNËSVE

Vlerësim për nxënie (informatë kthyesë, vlerësim i ndërsjelltë).

DETYRAT DHE PUNA E PAVARUR

Hulumtoni dhe gjeni veçoritë e sistemit të tretjes te gjitarët.

REFLEKTIM PËR RRJEDHËN E ORËS MËSIMORE

PLANIFIKIMI I ORËS MËSIMORE

ASPEKTET E PËRGJITHSHME TË PLANIT TË ORËS MËSIMOR

Fusha kurrikulare: Shkencat e natyrës Lënda: Biologji Shkalla e kurrikulës: IV
Klasa: VIII

Tema (nga plani dymujor):

Indet, organet dhe sistemet e organeve te shtazët

Rezultati i të nxënit të temës (nga plani dymujor):

Emërton dhe shpjegon indet, organet dhe sistemin e organeve të tretjes, organet kryesore të sistemit tretës dhe të përshkran ndërtimin dhe funksionin e tyre.

Rezultatet e të nxënit për kompetencat kryesore të shkallës (të synuara):

I 1. Transmeton saktë të dhënat e mbledhura për një temë konkrete, në formë tekstuale, numerike, verbale, elektronike apo në ndonjë formë tjetër të të shprehurit.

I 5. Prezanton para të tjerëve një projekt për një temë të dhënë, të përgatitur vetë ose në bashkëpunim me grupin, duke gërshetuar format e komunikimit verbal, elektronik dhe veprimin praktik.

II 8. Identifikon me anë të krahasimit dallimet dhe ngjashmëritë midis ligjeve dhe dukurive që ndodhin në natyrë me ato në shoqëri, duke vënë në dukje lidhjen shkak-pasojë midis këtyre dukurive.

Rezultatet e fushës së kurrikulës (të synuara):

Dallon dhe krahason ndërtimin dhe funksionin e qelizës, indeve, organeve dhe sistemeve të organeve, duke iu referuar biodiversitetit të qenieve të gjalla, shkaktarët e sëmundjeve te njeriu, shtazët, bimët dhe mënyrat e kontrollit të tyre, metabolizmin, zhvillimin individual të njeriut dhe evolucionin e qenieve të gjalla.

Shpjegon rolin e karbohidrateve, mineraleve, lipideve, proteinave, vitaminave, ujit dhe fibrave për dietë të shëndetshme dhe llogarit nevojën ditore për energji nga ushqimet e konsumuara.

ASPEKTET SPECIFIKE TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE

Njësia mësimore: Sistemi i organeve të tretjes (digjestiv) te gjitarët

Fjalët kyçe: *gjitarë, lukth, ripërtpës, barngrënës, mishngrënës.*

Rezultati/et e të nxënit për orë mësimore:

Përshkruan procesin e tretje së ushqimit te gjitarët;

Krahason sistemin digjestiv te barngrënësit dhe mishngrënësit.

Kriteret e suksesit:

Emërto organet e sistemit digjestiv duke specifikuar funksionin e secilës;

Sqaro pse sistemi digjestiv te barngrënësit kanë sistemin tretës më të gjatë në krahasim me mishngrënësit.

Burimet, mjetet e konkretizimit dhe materialet mësimore:

Libri Biologjia 8.

Lidhja me lëndët e tjera mësimore dhe/apo me çështjet ndërkurrikulare dhe situatat jetësore:

Gjuhë dhe komunikim, kimi.

PËRSHKRIMI I METODOLOGJISË DHE VEPRIMTARITË E PUNËS ME NXËNËS GJATË ORËS MËSIMORE

KLLASTER

Mësimdhënësi/ja pjesën e parë të orës mësimore e realizon përmes teknikës kllaster, duke marrë parasysh që nxënësit kishin për detyrë të hulumtonin për sistemin e organeve të tretjes te gjitarët, dhe marrë parasysh që sistemi digjestiv te njeri është mësuar edhe në klasën VII, atëherë ky kllaster do të jetë shumë i pasur me informacione.

DITARI DYPJESËSH (I MODIFIKUAR)

Mësimdhënësi/ja ndan klasën në tri grupe kryesore (nëse ka shumë nxënës mund të jenë 6 grupe, apo nëse klasa është e ndarë në rreshta punohet edhe ashtu). Fillimisht u caktohet nxënësve pjesa e njësisë mësimore që duhet të lexohet, p.sh., grupi i parë: barëngrënësit, grupi i dytë: mishëngrënësit, dhe grupi i tretë: gjithçkangrënësit.

Ndërkohë deri sa nxënësit lexojnë paragrafin e tyre përkatës, mësimdhënësi/ja punon në tabelë një tabelë në formë të ditarit dypjesësh.

Koncepti	Sqarimi
Tretja e ushqimit te barëngrënësit	
Tretja e ushqimit te mishngrënësit	<i>Në gojë pranë dhëmbëve prerës, i kanë dhëmbët e syrit shumë të fortë (ndryshe quhen dhëmbë qensh), që shërbejnë për ta kapur gjahun dhe për t'i prerë e shqyer fijet e muskujve. Zorrët e tyre janë relativisht të shkurtra.</i>
Tretja e ushqimit te gjithçkangrënësit	

Nxënësit që kishin për detyrë të lexonin paragrafin e parë posa ta mbaronin leximin, kanë për detyrë ta

shpjegojnë para nxënësve të tjerë pjesën e tyre, duke u munduar që të bëhet një përmbledhje e shkurtër dhe e saktë e pjesës së mësimi. Pastaj nxënësi që prezanton ka për detyrë të zgjedhë ndonjë nxënësi nga dy grupet e tjera, ku informacionet që ka mbajtur në mend, t'i përmbledhë në tabelë. Pra, grupi që rezultojnë me sa më shumë informacione në tabelë, konsiderohet të jetë si më i suksesshmi. (Kështu, mësimi merr edhe karakter garues).

VLERËSIMI I NXËNËSVE

Vlerësimi me gojë (diskutime, debate, prezantime).

DETYRAT DHE PUNA E PAVARUR

REFLEKTIM PËR RRJEDHËN E ORËS MËSIMORE

PLANIFIKIMI I ORËS MËSIMORE

ASPEKTET E PËRGJITHSHME TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE

Fusha kurrikulare: Shkencat e natyrës Lënda: Biologji Shkalla e kurrikulës: IV
Klasa: VIII

Tema (nga plani dymujor):

Indet, organet dhe sistemet e organeve te shtazët

Rezultati i të nxënit të temës (nga plani dymujor):

Emërton disa çrregullime në zhvillimin e organeve të tretjes si dhe sëmundjet më të shpeshta të sistemit tretës;

Rezultatet e të nxënit për kompetencat kryesore të shkallës (të synuara):

V 1. Vlerëson përmbajtjen dhe vlerat ushqyese të llojeve të ushqimeve të cilat njeriu i konsumon, duke i kategorizuar ato në bazë të nevojave të individit për to në situata të ndryshme, si: gjatë stinëve, sëmundjeve etj.

2. Argumenton nevojën e respektimit të regjimit për ushqyerje të shëndetshme dhe rekreacion ditor, javor apo mujor, sipas udhëzimeve të lexuara ose të dëgjura nga mjeku gjatë një diskutimi në klasë, në shkollë apo në familje.

3. Vlerëson domosdoshmërinë e kushteve të mira higjienike për përgatitjen dhe konsumimin e ushqimeve dhe pijeve dhe shpjegon rrethanat e mundshme të helmimit nga ushqimet dhe papastra.

II 7. Interpreton me fjalë, me shkrim/me gojë një rregull, koncept apo proces të caktuar duke e ilustruar atë me shembuj konkretë nga situata të jetës së përditshme.

Rezultatet e fushës së kurrikulës (të synuara):

Dallon dhe krahason ndërtimin dhe funksionin e qelizës, indeve, organeve dhe sistemeve të organeve, duke ju referuar biodiversitetit të genieve të gjalla, shkaktarët e sëmundjeve të njeriu, shtazët bimët dhe

mënyrat e kontrollit të tyre, metabolizmin, zhvillimin individual të njeriut dhe evolucionin e qenieve të gjalla.

Shpjegon rolin e karbohidrateve, mineraleve, lipideve, proteinave, vitaminave, ujit dhe fibrave për dietë të shëndetshme dhe llogarit nevojën ditore për energji nga ushqimet e konsumuara.

ASPEKTET SPECIFIKE TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE

Njësia mësimore: **Sëmundjet e organeve të tretjes**

Fjalët kyçe: kariesi, vjellja, diarreja, gastriti, mukozë, pezmatim.

Rezultati/et e të nxënit për orë mësimore:

Emërton sëmundjet e organeve të tretjes;

Shpjegon cilat organe të sistemit tretës i prek ulcera gastrike;

Vlerëson rolin e ushqimit në shfaqjen e sëmundjeve të sistemit tretës.

Kriteret e suksesit:

Specifikon sëmundjet përkatëse të sistemit tretës duke treguar pasojat për secilën nga to;

Trego në cilat raste shfaqen gurët e tëmthit, ulcera gastrike;

Numëro masat parandaluese për shfaqjen e sëmundjeve të sistemit të tretjes.

Burimet, mjetet e konkretizimit dhe materialet mësimore:

Libri Biologjia 8, lapotopi, projektori.



Lidhja me lëndët e tjera mësimore dhe/apo me çështjet ndërkurrikulare dhe situatat jetësore:

Gjuhë dhe komunikim, kimi, art figurativ, teknologji.

PËRSHKRIMI I METODOLOGJISË DHE VEPRIMTARITË E PUNËS ME NXËNËS GJATË ORËS MËSIMORE

IMAGJINATË E DREJTUAR

Mësimdhënësi/ja pjesën e parë të orës mësimore e realizon përmes teknikës imagjinatë e drejtuar, kërkon nga nxënësit që të përcjellin në ekran fotografi të caktuara dhe pastaj të komentojnë se çfarë kanë parë.



LEKSION I AVANCUAR

Mësimdhënësi/ja kërkon nga nxënësit që, pas diskutimit të pjesës së parë, të dëgjojnë sqarimet përkatëse nga ai/ajo për këtë njësi mësimore.

Ushqimi duhet të jetë higjienik, përndryshe mund të paraqiten sëmundje të rënda infektive, parazitare dhe joinfektive të organeve të tretjes si dhe helmime, të cilat çrregullojnë jo vetëm punën e organeve

të tretjes, por edhe shëndetin e tërë organizmit. Në aparatën tretës ndodhin shumë çrregullime, të cilat, nëse nuk kemi kujdes, shpeshherë përfundojnë me pasoja të rënda. Disa nga ato çrregullime janë kariesi (vrmat në dhëmbë), vjellja dhe diarreja, gastriti (thartira), ulcera, gurët e tëmthit, verdhëza, apendiciti. Në kanalën zorror të njeriut shpesh parazitohen krimbat e ndryshëm, si p.sh., skraja e fëmijëve (*Ascaris lumbricoides*), shiriti, bubëza e fëmijëve etj. Vezët ose larvat e këtyre krimbave parazitare përmes ushqimit të papastër, mishit të infektuar apo duarve të papastra arrijnë në traktin digjestiv të njeriut dhe vazhdojnë aty jetën e tyre. Për njeriun është i rrezikshëm shiriti i qenit (*ehinokoku*).

Pastaj nxënësit udhëzohen që të lexojnë njësinë mësimore në libër dhe të shohin nëse kanë paqartësi eventuale të cilat sqarohen pastaj nga mësuesi/ja.

KLLASTER

Pjesën e fundit të orës mësimore mësuesi/ja kërkon nga nxënësit që të punojnë një kllaster me njohuritë që tashmë i fituan. Të njëjtin pastaj e punojnë në tabelë së bashku. Nxënësit udhëzohen që kllasterin ta punojnë në fletë A4, në mënyrë që pastaj ta bëjnë pjesë të dosjes së tyre.

VLERËSIMI I NXËNËSVE

Vlerësimi me gojë (diskutime, debate, prezantime).

DETYRAT DHE PUNA E PAVARUR

REFLEKTIM PËR RRJEDHËN E ORËS MËSIMORE

PLANIFIKIMI I ORËS MËSIMORE

ASPEKTET E PËRGJITHSHME TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE		
Fusha kurrikulare: Shkencat e natyrës	Lënda: Biologji	Shkalla e kurrikulës: IV
Klasa: VIII		
Tema (nga plani dymujor): Indet, organet dhe sistemet e organeve te shtazët	Rezultati i të nxënit të temës (nga plani dymujor): <i>Përshkruan ndërtimin dhe funksionin e zembrës dhe të enëve të gjakut, përkatësisht sistemin e organeve të qarkullimit të gjakut.</i>	
Rezultatet e të nxënit për kompetencat kryesore të shkallës (të synuara):		
<p>I 5. <i>Prezanton para të tjerëve një projekt për një temë të dhënë, të përgatitur vetë ose në bashkëpunim me grupin, duke gërrshetur format e komunikimit verbal, elektronik dhe veprimin praktik.</i></p> <p>II 2. <i>Përzgjedh informata nga burime të ndryshme, për një temë konkrete, i klasifikon ato në bazë të një kriteri të caktuar dhe i përdor ato për marrjen e një vendimi apo për zgjidhjen e një problemi/detyre.</i></p> <p>II 8. <i>Identifikon me anë të krahasimit dallimet dhe ngjashmëritë midis ligjeve dhe dukurive që ndodhin në natyrë me ato në shoqëri, duke vënë në dukje lidhjen shkak-pasojë midis këtyre dukurive.</i></p>		
Rezultatet e fushës së kurrikulës (të synuara): <i>Dallon dhe krahason ndërtimin dhe funksionin e qelizës, indeve, organeve dhe sistemeve të organeve, duke iu referuar biodiversitetit të qenieve të gjalla, shkaktarët e sëmundjeve te njeriu, shtazët, bimët dhe mënyrat e kontrollit të tyre, metabolizmin, zhvillimin individual të njeriut dhe evolucionin e qenieve të gjalla.</i> <i>Shpjegon rolin e</i> <i>karbohidrateve, mineraleve, lipideve, proteinave, vitaminave, ujit dhe fibrave për dietë të shëndetshme dhe llogarit nevojën ditore për energji nga ushqimet e konsumuara.</i>		
ASPEKTET SPECIFIKE TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE		
Njësia mësimore: Sistemi i qarkullimit i lëngjeve të pakurrizorëve		
Fjalët kyçe: <i>lëngë trupor, enë e gjakut, oksigjen.</i>		
Rezultati/et e të nxënit për orë mësimore: <i>Shpjegon qarkullimin e lëngjeve trupore - gjakun te krimbi i tokës dhe këmbënyjtuarit; Specifikon qarkullimin e lëngjeve trupore - gjakun te butakët dhe lëkurëgjemborët.</i>		
Kriteret e suksesit: <i>Krahaso sistemin e lëngjeve trupore - gjakut te krimbi i tokës dhe këmbënyjtuarit; Dallo si bëhet qarkullimi i lëngjeve trupore - gjakut te butakët dhe lëkurëgjemborët.</i>		
Burimet, mjetet e konkretizimit dhe materialet mësimore: <i>Libri Biologjia 8.</i>		

Lidhja me lëndët e tjera mësimore dhe/apo me çështjet ndërkurrikulare dhe situatat jetësore:
Gjuhë dhe komunikim, kimi.

PËRSHKRIMI I METODOLOGJISË DHE VEPRIMTARITË E PUNËS ME NXËNËS GJATË ORËS MËSIMORE

STUHI MENDIMESH

Mësimdhënësi/ja kërkon nga nxënësit që rikujtojnë njohuritë e tyre në lidhje me sistemin e qarkullimit të lëngjeve trupore. Kështu shkruan në tabelë titullin e njësisë së re mësimore “Sistemi i qarkullimit i lëngjeve të pakurizorëve”.

LEKSION I AVANCUAR

Mësimdhënësi/ja kërkon nga nxënësit që pas diskutimit të pjesës së parë të dëgjojnë sqarimet përkatëse nga ai/a jo për këtë njësi mësimore.

Sfungjerët, grykorët, krimbat e shtypur dhe të rrumbullakët, si shtazë me ndërtim të thjeshtë trupor, nuk kanë organe për qarkullimin e lëngjeve trupore. Sfungjerët e përdorin ujin e mjedisit për të qarkulluar materiet, duke e kaluar ujin nëpër trupin e tyre.

Grykorët (p.sh., hidra) e përdorin gjithashtu ujin e mjedisit dhe e qarkullojnë atë nëpër zgavrën gastrovaskulare. Qelizat që kufizojnë zgavrën e trupit marrin nga uji gaze dhe lëndë ushqyese, ndërsa mbetjet i lëshojnë në të. Krimbi i tokës (skraja e shiut) - ka sistem të thjeshtë të qarkullimit të gjakut. Sistemi i qarkullimit të gjakut të krimbit të tokës përbëhet nga ena shpinore dhe barkore të cilat janë të lidhur mes vete me kapilar. Këmbënyjëtuarit kanë sistem të hapur të qarkullimit të gjakut, ku gjaku del nga enët e gjakut në hapësirat trupore. Kanë zemër që shtrihet në anën shpinore, e cila pompon gjakun nëpër tërë trupin. Butakët kanë sistem të hapur të qarkullimit të gjakut që përfaqësohet nga ena shpinore në të cilën është e vendosur edhe zemra. Lëkurëgjemborët nuk kanë sistem të qarkullimit të gjakut, ata kanë një sistem të veçantë enëzor të qarkullimit të ujit.

Pastaj, nxënësit udhëzohen që të lexojnë njësinë mësimore në libër dhe të shohin nëse kanë paqartësi eventuale, të cilat sqarohen pastaj nga mësimdhënësi/ja.

KLLASTER

Pjesën e fundit të orës mësimore mësimdhënësi/ja kërkon nga nxënësit që të punojnë një kllaster me njohuritë që tashmë i fituan. Të njëjtin pastaj e punojnë në tablë së bashku. Nxënësit udhëzohen që kllasterin ta punojnë në fletë A4, në mënyrë që pastaj ta bëjnë pjesë të dosjes së tyre.

VLERËSIMI I NXËNËSVE

Vlerësimi me gojë (diskutime, debate, prezantime).

DETYRAT DHE PUNA E PAVARUR

REFLEKTIM PËR RRJEDHËN E ORËS MËSIMORE

PLANIFIKIMI I ORËS MËSIMORE

ASPEKTET E PËRGJITHSHME TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE

Fusha kurrikulare: Shkencat e natyrës
Klasa: VIII

Lënda: Biologji

Shkalla e kurrikulës: IV

Tema (nga plani dymujor):

Indet, organet dhe sistemet e organeve te shtazët

Rezultati i të nxënit të temës (nga plani dymujor):

Përshkruan ndërtimin dhe funksionin e zemrës dhe të enëve të gjakut, përkatësisht sistemin e organeve të qarkullimit të gjakut.

Rezultatet e të nxënit për kompetencat kryesore të shkallës (të synuara):

I **2.** Përshkruan një ngjarje, të dhënë si detyrë, të lexuar ose të dëgjuar më parë, në formë verbale, vizuale ose me shkrim, duke ruajtur rrjedhën logjike të saj.

II **1.** Paraqet, në formë gojore ose të shkruar, grafike, me simbole, argumente të veçanta për të sforcuar mendimin apo qëndrimin e vet për një problem nga fusha të caktuara.

II **8.** Identifikon me anë të krahasimit dallimet dhe ngjashmëritë midis ligjeve dhe dukurive që ndodhin në natyrë me ato në shoqëri, duke vënë në dukje lidhjen shkak-pasojë midis këtyre dukurive.

Rezultatet e fushës së kurrikulës (të synuara):

Dallon dhe krahason ndërtimin dhe funksionin e qelizës, indeve, organeve dhe sistemeve të organeve, duke iu referuar biodiversitetit të qenieve të gjalla, shkaktarët e sëmundjeve te njeriu, shtazët, bimët dhe mënyrat e kontrollit të tyre, metabolizmin, zhvillimin individual të njeriut dhe evolucionin e qenieve të gjalla. Shpjegon rolin e karbohidrateve, mineraleve, lipideve, proteinave, vitaminave, ujit dhe fibrave për dietë të shëndetshme dhe llogarit nevojën ditore për energji nga ushqimet e konsumuara.

ASPEKTET SPECIFIKE TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE

Njësia mësimore: **Sistemi i qarkullimit i lëngjeve të kurrizorëve**

Fjalët kyçe: gjak, okigjen, zemër, vena, arterie, kapilar.

Rezultati/et e të nxënit për orë mësimore:

*Shpjegon qarkullimin e gjakut te shtazët kurrizore;
Dallon ndërtimin e zemrës te peshqit, zvarranikët dhe shpezët.*

Kriteret e suksesit:

*Krahaso sistemin e qarkullimit të gjakut në mes grupeve të ndryshme të kurrizorëve duke u bazuar në ndërtimin e zemrës së tyre;
Specifikko pse përzierja e gjakut të pastër dhe atij të papastër te zvarranikët bëhet me një sasi më të vogël, sesa tek ujëtokësorët.*

Burimet, mjetet e konkretizimit dhe materialet mësimore:

Libri Biologjia 8.

Lidhja me lëndët e tjera mësimore dhe/apo me çështjet ndërkurrikulare dhe situatat jetësore:
Gjuhë dhe komunikim, kimi.

PËRSHKRIMI I METODOLOGJISË DHE VEPRIMTARITË E PUNËS ME NXËNËS GJATË ORËS MËSIMORE

STUHI MENDIMESH

Mësimdhënësi/ja kërkon nga nxënësit që rikujtojnë njohuritë e tyre në lidhje me sistemin e qarkullimit të lëngjeve trupore. Kështu shkruan në tabelë titullin e njësis së re mësimore “Sistemi i qarkullimit i lëngjeve të pakurriorëve”.

DITARI DYPJESËSH (I MODIFIKUAR)

Mësimdhënësi/ja ndan klasën në pesë grupe kryesore. Fillimisht u caktohet nxënësve pjesa e njësisë mësimore që duhet të lexohet, p.sh., grupi i parë: qarkullimi i gjakut te peshqit, grupi i dytë: qarkullimi i gjakut te ujëtokësorët, grupi i tretë: qarkullimi i gjakut te zvarranikët, qarkullimi i gjakut te shpendët dhe grupi i fundit: qarkullimi i gjakut te gjitarët.

Ndërkohë, derisa nxënësit lexojnë paragrafin e tyre përkatës, mësimdhënësi/ja punon në tabelë një tabelë në formë të ditarit dypjesësh.

Koncepti	Sqarimi
Qarkullimi i gjakut te peshqit	
Qarkullimi i gjakut te ujëtokësorët	
Qarkullimi i gjakut te zvarranikët	Zemra është e ndarë në tri dhomëza (në dy veshëza dhe një barkushe), por te zvarranikët në barkushe ndodhet njëfarë perdeje, e cila e ndan këtë në një gjysmë (të majtë dhe në një gjysmë të djathtë). Edhe te këto shtazë gjaku i pastër vazhdon të përziehet me gjakun e papastër, por kjo përzierje është më e vogël sesa tek ujëtokësorët falë perdes në barkushe.
Qarkullimi i gjakut te shpendët	
Qarkullimi i gjakut te gjitarët	

Shembull.

Nxënësit që kishin për detyrë të lexonin paragrafin e parë, posa ta mbarojnë leximin, kanë për detyrë ta shpjegojnë para nxënësve të tjerë pjesën e tyre, duke u munduar që të bëhet një përmbledhje e shkurtër dhe e saktë e pjesës së mësimimit. Pastaj, nxënësi që prezanton ka për detyrë të zgjedhë ndonjë nxënës nga dy grupet e tjera, ku informacionet që ka mbajtur në mend, t’i përmbledhë në tabelë. Pra, grupi që rezulton me sa më shumë informacione në tabelë, konsiderohet të jetë si më i suksesshmi. (Kështu mësimi merr edhe karakter garues).

VLERËSIMI I NXËNËSVE

Vlerësimi me gojë (diskutime, debate, prezantime).

DETYRAT DHE PUNA E PAVARUR

REFLEKTIM PËR RRJEDHËN E ORËS MËSIMORE

PLANIFIKIMI I ORËS MËSIMORE

ASPEKTET E PËRGJITHSHME TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE		
Fusha kurrikulare: Shkencat e natyrës Klasa: VIII	Lënda: Biologji	Shkalla e kurrikulës: IV
Tema (nga plani dymujor): Indet, organet dhe sistemet e organeve te shtazët	Rezultati i të nxënit të temës (nga plani dymujor): <i>Emërton dhe përshkruan disa sëmundje të gjakut, të zemrës dhe të enëve të gjakut.</i>	
Rezultatet e të nxënit për kompetencat kryesore të shkallës (të synuara):		
<p>I 6. <i>Analizon përmbajtjen dhe kuptimin e nocioneve (koncepteve) të reja, duke përdorur leksikun adekuat, të përshtatshëm dhe të saktë dhe i bën ato pjesë të dosjes mësimore.</i></p> <p>II 8. <i>Identifikon me anë të krahasimit dallimet dhe ngjashmëritë midis ligjeve dhe dukurive që ndodhin në natyrë me ato në shoqëri, duke vënë në dukje lidhjen shkak-pasojë midis këtyre dukurive.</i></p> <p>III 7. <i>Shfrytëzon në mënyrë të efektshme teknika të ndryshme gjatë të nxënit të temës së dhënë, duke veçuar informatat që i kupton nga informatat e reja, të panjohura, si dhe informatat që për të mbeten ende të paqarta.</i></p>		
Rezultatet e fushës së kurrikulës (të synuara):		
<i>Dallon dhe krahason ndërtimin dhe funksionin e qelizës, indeve, organeve dhe sistemeve të organeve, duke iu referuar biodiversitetit të qenieve të gjalla, shkaktarët e sëmundjeve të njeriu, shtazët, bimët dhe mënyrat e kontrollit të tyre, metabolizmin, zhvillimin individual të njeriut dhe evolucionin e qenieve të gjalla. Shpjegon rolin e karbohidrateve, mineraleve, lipideve, proteinave, vitaminave, ujit dhe fibrave për dietë të shëndetshme dhe llogarit nevojën ditore për energji nga ushqimet e konsumuara.</i>		
ASPEKTET SPECIFIKE TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE		
Njësia mësimore: Disa nga sëmundjet e gjakut, zemrës dhe enëve të gjakut		
Fjalët kyçe: <i>leukemi, trombozë, dëmtim i zemrës.</i>		
Rezultati/et e të nxënit për orë mësimore:		
<i>Përshkruan përbërjen e gjakut; Shpjegon cilat janë shkaqet që çojnë në shfaqjen e sëmundjeve të gjakut; Definon arsyet përse këshillohet vazhdimisht të përsëriten analizat e gjakut.</i>		
Kriteret e suksesit:		
<i>Veçon rolin e përbërësve të gjakut; Emërto sëmundjet më të shpeshta të gjakut, bazuar në fotografi; Vlerëso rëndësinë e kujdesit të vazhdueshëm për shëndetin.</i>		
Burimet, mjetet e konkretizimit dhe materialet mësimore:		
<i>Libri Biologjia 8, laptop, projektor, fotografi të printuara.</i>		

Lidhja me lëndët e tjera mësimore dhe/apo me çështjet ndërkurrikulare dhe situatat jetësore: *Gjuhë dhe komunikim, kimi, teknologji.*

PËRSHKRIMI I METODOLOGJISË DHE VEPRIMTARITË E PUNËS ME NXËNËS GJATË ORËS MËSIMORE

STUHI MENDIMESH

Mësimdhënësi/ja kërkon nga nxënësit të rikujtojnë njohuritë e tyre në lidhje me


sistemin e qarkullimit të lëngjeve trupore. Kështu, shkruan në tabelë titullin e njësisë së re mësimore "Sëmundjet e gjakut, zemrës dhe enëve të gjakut".




LEKSION I AVANCUAR

Mësimdhënësi/ja kërkon nga nxënësit që, pas diskutimit të pjesës së parë, të dëgjojnë sqarimet përkatëse nga ai/ajo për këtë njësi mësimore.

Hemofila është një nga çrregullimet e koagulimit të gjakut; gjaku nuk mpikset (ngjizet). Çrregullimi i koagulimit të gjakut mund të shkaktohet nga një sëmundje e trashëguar ose nga përdorimi i medikamenteve.




Tromboza (mpiksja e gjakut brenda trupit) është një tjetër çrregullim i koagulimit të gjakut. Gjaku koagullohet brenda enëve dhe mund t'i bllokojë ato. Në paraqitjen e trombozës ndikojnë faktorë të ndryshëm, si. p.sh., aktiviteti i ulët fizik, përdorimi i ilaçeve (p.sh., i kontraceptivëve), pirja e duhanit etj.



Aritmia - ndodh kur zemra nuk ka një ritëm normal të rrahjeve. Ka lloje të ndryshme të aritmive. Zemra mund të rrahë shumë ngadalë, shumë shpejt ose në mënyrë të parregullt. Aritmia ndikon në mosfunksionimin e duhur të sistemit të qarkullimit të gjakut.

Stenoza e zemrës - është sëmundje që vjen si pasojë e ngushtimit të valvulave të zemrës. Valvulat e zemrës nuk hapen mjaftueshëm për të lejuar rrjedhën normale të gjakut.



Dështimi i zemrës - Zemra nuk pompon gjak sa duhet, por kjo nuk do të thotë që zemra ndalon së rrahuri. Zemra vazhdon të punojë, por nevojat e trupit për gjak dhe oksigjen nuk plotësohen.

Sëmundja e arterieve (arteroskleroza) - ndodh si rezultat i ngushtimit të arterieve. Ngushtimi shkaktohet nga depozitimi i kolesterolit (lloj yndyre) dhe i substancave të tjera në muret e arterieve që furnizojnë me gjak zemrën, ose

pjesët e tjera të trupit.

Hipertensioni (tensioni i lartë i gjakut) është sëmundje që shkaktohet jo vetëm nga ngushtimi i enëve të gjakut, ngurtësimi dhe humbja e elasticitetit të tyre, por dhe nga të ushqyerit jo i shëndetshëm dhe aktiviteti jo i duhur fizik.

Gjatë leksionit përdoren edhe fotografi të përkatëse për sëmundjen në fjalë. (fotografi të printuara, apo edhe përmes projektorit).


Pastaj, nxënësit udhëzohen që të lexojnë njësinë mësimore në libër dhe të shohin nëse kanë paqartësi eventuale, të cilat sqarohen pastaj nga mësimdhënësi/ja.

PYETJE - PËRGJIGJJE

Pjesën e fundit të orës mësimore mësimdhënësi/ja e realizon përmes pyetjeve, u kërkon nxënësve që t'i mbyllin librat dhe të përgjigjen në pyetje.

Shembull i pyetjeve:

- *Numëro cilët janë përbërësit e gjakut.*
- *Përshkruaj rolin e përbërësve të gjakut.*
- *Shpjego rëndësinë e një analize gjaku.*
- *Emërto sëmundjet e gjakut dhe shpjego si vjen deri te ato. (përdor fotografi përkatëse).*
- *Përmend disa nga sëmundjet e zemrës dhe enëve të gjakut.*
- *Sqaro shkaqet e paraqitjes së sëmundjeve të gjakut.*



VLERËSIMI I NXËNËSVE

Vlerësimi me gojë (diskutime, debate, prezantime).

DETYRAT DHE PUNA E PAVARUR

Hulumtoni dhe gjeni informacione për transfuzionin e gjakut.

REFLEKTIM PËR RRJEDHËN E ORËS MËSIMORE

PLANIFIKIMI I ORËS MËSIMORE

ASPEKTET E PËRGJITHSHME TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE		
Fusha kurrikulare: Shkencat e natyrës	Lënda: Biologji	Shkalla e kurrikulës: IV
Klasa: VIII		
Tema (nga plani dymujor): Indet, organet dhe sistemet e organeve te shtazët	Rezultati i të nxënit të temës (nga plani dymujor): <i>Emërton dhe përshkruan disa sëmundje të gjakut, të zembrës dhe të enëve të gjakut;</i> <i>Shpjegon procesin e transfuzionit të gjakut dhe si caktohen grupet e gjakut të sistemit ABO.</i>	
Rezultatet e të nxënit për kompetencat kryesore të shkallës (të synuara): I 6. <i>Analizon përmbajtjen dhe kuptimin e nocioneve (koncepteve) të reja, duke përdorur leksikun adekuat, të përshtatshëm dhe të saktë dhe i bën ato pjesë të dosjes mësimore.</i> III 7. <i>Shfrytëzon në mënyrë të efektshme teknika të ndryshme gjatë të nxënit të temës së dhënë, duke veçuar informatat që i kupton nga informatat e reja, të panjohura, si dhe informatat që për të mbeten ende të paqarta.</i> IV 1. <i>Vlerëson rëndësinë e punës individuale dhe në grupe për zhvillimin e komunitetit duke paraqitur, në forma të ndryshme të të shprehurit, shembuj konkretë nga jeta e përditshme.</i>		
Rezultatet e fushës së kurrikulës (të synuara): <i>Dallon dhe krahason ndërtimin dhe funksionin e qelizës, indeve, organeve dhe sistemeve të organeve, duke iu referuar biodiversitetit të qenieve të gjalla, shkaktarët e sëmundjeve të njeriut, shtazët, bimët dhe mënyrat e kontrollit të tyre, metabolizmin, zhvillimin individual të njeriut dhe evolucionin e qenieve të gjalla.</i> <i>Shpjegon rolin e karbohidrateve, mineraleve, lipideve, proteinave, vitaminave, ujit dhe fibrave për dietë të shëndetshme dhe llogarit nevojën ditore për energji nga ushqimet e konsumuara.</i>		
ASPEKTET SPECIFIKE TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE		
Njësia mësimore: Transfuzioni i gjakut dhe grupet e gjakut		
Fjalët kyçe: <i>grupe të gjakut, transfuzion, faktori Rh.</i>		
Rezultati/et e të nxënit për orë mësimore: <i>Përshkruan procesin e transfuzionit të gjakut (në cilat raste është i mundur).</i>		
Kriteret e suksesit: <i>Emërto grupet e gjakut;</i> <i>Trego pse gjatë një transfuzioni grupet e gjakut të dhuruesit dhe të marrësit duhet të përputhen.</i>		
Burimet, mjetet e konkretizimit dhe materialet mësimore: <i>Libri Biologjia 8.</i>		

Lidhja me lëndët e tjera mësimore dhe/apo me çështjet ndërkurrikulare dhe situatat jetësore:
Gjuhë dhe komunikim, kimi.

PËRSHKRIMI I METODOLOGJISË DHE VEPRIMTARITË E PUNËS ME NXËNËS GJATË ORËS MËSIMORE

KLLASTER

Mësimdhënësi/ja pjesën e parë të orës mësimore e realizon përmes teknikës kllaster, duke marrë parasysh që nxënësit kishin për detyrë të hulumtonin për grupet e gjakut dhe transfuzionin, atëherë ky kllaster do të jetë shumë i pasur me informacione dhe nxënësit nuk do të kenë vështirësi në realizimin e tij.

INSERT

Në këtë fazë bëhet leximi i pjesës duke vendosur shenjat , =, -, ?. Nënvizimet e bëra në libër hidhen në tabelën e INSERT-it. Pra, pjesët kryesore të mësimit të shënuara me shenjat përkatëse hidhen në tabelë, (shenja V vendoset për atë pjesë që nxënësit dinë, shenja + për pjesën që është shtuar e re, shenja – për pjesën që nuk e dinë, dhe shenja ? për pjesën që nuk kuptojnë).

<input checked="" type="checkbox"/>	+	-	?

DISKUTIM

Pasi nxënësit kanë përfunduar tabelën INSERT, tani mësimdhënësi/ja u sqaron atyre përmbajtjet për të cilën ata kanë vendosur shenjen ?. Pastaj fillon një diskutim i hapur për të gjithë klasën.

VLERËSIMI I NXËNËSVE

Vlerësimi me gojë (diskutime, debate, prezantime).

DETYRAT DHE PUNA E PAVARUR

Sillni në klasë kartelat e vaksinimit kur keni qenë fëmijë.

REFLEKTIM PËR RRJEDHËN E ORËS MËSIMORE

PLANIFIKIMI I ORËS MËSIMORE

ASPEKTET E PËRGJITHSHME TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE	
Fusha kurrikulare: Shkencat e natyrës Lënda: Biologji Shkalla e kurrikulës: IV Klasa: VIII	
Tema (nga plani dymujor): Indet, organet dhe sistemet e organeve te shtazët	Rezultati i të nxënit të temës (nga plani dymujor): <i>Identifikon disa sëmundje imunologjike dhe përshkruan shfaqjen e tyre.</i>
Rezultatet e të nxënit për kompetencat kryesore të shkallës (të synuara): I 6. <i>Analizon përmbajtjen dhe kuptimin e nocioneve (koncepteve) të reja, duke përdorur leksikun adekuat, të përshtatshëm dhe të saktë dhe i bën ato pjesë të dosjes mësimore.</i> III 6. <i>Ndjek në mënyrë të pavarur udhëzimet apo skicat e dhëna në libër, skicë, plan, partiturë muzikore, skenar, koreografi etj., ose të ndonjë burimi tjetër, për të performuar një veprim, aktivitet ose detyrë që kërkohet prej tij/saj.</i> III 7. <i>Shfrytëzon në mënyrë të efektshme teknika të ndryshme gjatë të nxënit të temës së dhënë duke veçuar informatat që i kupton nga informatat e reja, të panjohura, si dhe informatat që për të mbeten ende të paqarta.</i>	
Rezultatet e fushës së kurrikulës (të synuara): <i>Dallon dhe krahason ndërtimin dhe funksionin e qelizës, indeve, organeve dhe sistemeve të organeve, duke iu referuar biodiversitetit të qenieve të gjalla, shkaktarët e sëmundjeve të njeriut, shtazët bimët dhe mënyrat e kontrollit të tyre, metabolizmin, zhvillimin individual të njeriut dhe evolucionin e qenieve të gjalla. Shpjegon rolin e karbohidrateve, mineraleve, lipideve, proteinave, vitaminave, ujit dhe fibrave për dietë të shëndetshme dhe llogarit nevojën ditore për energji nga ushqimet e konsumuara.</i>	
ASPEKTET SPECIFIKE TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE	
Njësia mësimore: Sëmundjet imunologjike dhe sistemi imunitar	
Fjalët kyçe: <i>sistem imunitar, limfocite, antigjen, virus, vaksinim, imunitet artificial.</i>	
Rezultati/et e të nxënit për orë mësimore: <i>Definon termin imunitet; Shpjegon sëmundjet imunobiologjike duke treguar arsyet e shfaqjes së tyre.</i>	
Kriteret e suksesit: <i>Krahaso dy tipat e imunitetit (imunitet natyral dhe artificial); Numëro sëmundjet imunologjike.</i>	

Burimet, mjetet e konkretizimit dhe materialet mësimore: *Libri Biologjia 8, kartoni i vaksinimit, tabela.*

Lidhja me lëndët e tjera mësimore dhe/apo me çështjet ndërkurrikulare dhe situatat jetësore: *Gjuhë dhe komunikim, kimi.*

PËRSHKRIMI I METODOLOGJISË DHE VEPRIMTARITË E PUNËS ME NXËNËS GJATË ORËS MËSIMORE

IMAGJINATË E DREJTUAR

Mësimdhënësi/ja në fillim të orës u shpjegon nxënësve se sistemi i mbrojtjes njerëzore shpesh krahasohet me atë të një kështjelle. Në kështjellë, forma e parë e mbrojtjes është muri i jashtëm. Nëse hapet një vrimë në mur, ushtarët punojnë shpejt për të mbyllur vrimën. Këta ushtarë janë linja e dytë e mbrojtjes. Nëse disa pushtues kalojnë, atëherë përballen me formën e tretë të mbrojtjes, barrikadën e brendshme, që përbëhet nga mbrojtës të aftë. Te ne, lëkura është linja jonë e parë e mbrojtjes. Ajo vepron si një pengesë për të parandaluar hyrjen e mikroorganizmave në trup. Nëse e presim lëkurën, gjaku mpikset shpejt dhe i mbyll plagët për të ndaluar depërtimin e mikroorganizmave (linja e dytë e mbrojtjes). Në rast se në trupin tonë hyn ndonjë mikroorganizëm, qelizat e bardha të gjakut janë ato që i neutralizojnë (linja e tretë e mbrojtjes). Qelizat e bardha i neutralizojnë shpejt mikroorganizmat dhe ky mekanizëm mbrojtës quhet sistem imunitar. Ndonjëherë sistemi imunitar natyral i trupit nuk mund të përballlet me të gjithë mikroorganizmat që kanë hyrë në organizëm. Në këto raste duhet të përdorim ilaçe (antibiotikë), që e ndihmojnë trupin të luftojë mikroorganizmat që shkaktojnë sëmundje.

MËSIM I PËRQENDRUAR NË ARGUMENTE

Mësimdhënësi/ja u kërkon nxënësve të hapin librat dhe të lexojnë të ndarë në pjesë njësinë mësimore. Njëri grup lexon pjesën për: mbrojtjen natyrore, grupi tjetër lexon: veprimin e sistemit imunitar, grupi tjetër: vaksinimin, grupi tjetër: sëmundjet imunologjike, grupi tjetër: pezmatimin e nyjave, grupi tjetër: astmën dhe për sklerozën e shumëfishtë. Pasi të kenë lexuar praragrafët e dhënë, tani nxënësit me vëmendje përcjellin pyetjet e mësimdhënësit/es dhe, në bashkëpunim me grupin, përgjigjen, nëse ka dy grupe që kanë lexuar pjesën e njëjtë, atëherë mund të realizohet diskutimi i përbashkët.

1. Çfarë quajmë sëmundje imunologjike?
2. Shpjego si shkaktohen ato?
3. Krahaso sistemin imunitar natyral dhe sistemin imunitar artificial në trupin tonë.
4. Sqaro si fitohet imuniteti artificial dhe ai natyral.
5. Shpjego si bëhet imun një person i vaksinuar.
6. Emërto disa nga sëmundjet imunologjike dhe shpjego cilat pjesë të trupit i prekin ato.
7. Shpjego çfarë është artriti reumatoid?
8. Specifiko si manifestohet skleroza multiple.

(shtoni edhe pyetje të tjera)

RRJETI I DISKUTIMIT

Ndërkohë sa mësimdhënësi/ja lexon pyetjet, nxënësit përgjigjen dhe kështu rrjedh diskutimi. Dhe krejt në fund, mësimdhënësi/ja kërkon nga nxënësit që të lexojnë kartelat e tyre të vaksinimit dhe të diskutojnë për to.

VLERËSIMI I NXËNËSVE

Vlerësimi me gojë (diskutime, debate, prezantime).

DETYRAT DHE PUNA E PAVARUR

REFLEKTIM PËR RRJEDHËN E ORËS MËSIMORE

PLANIFIKIMI I ORËS MËSIMORE

ASPEKTET E PËRGJITHSHME TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE

Fusha kurrikulare: Shkencat e natyrës Lënda: Biologji Shkalla e kurrikulës: IV
Klasa: VIII

Tema (nga plani dymujor):
Indet, organet dhe sistemet e organeve te shtazët

Rezultati i të nxënës të temës (nga plani dymujor):
*Emërton dhe shpjegon rrugët e frymëmarrjes, ndërtimin dhe funksionin e tyre;
Përshkruan mekanizmat e frymëmarrjes mushkërore, branshiale dhe trakeidale si dhe rregullimin e saj.*

Rezultatet e të nxënës për kompetencat kryesore të shkallës (të synuara):

I 6. Analizon përmbajtjen dhe kuptimin e nocioneve (koncepteve) të reja, duke përdorur leksikun adekuat, të përshtatshëm dhe të saktë dhe i bën ato pjesë të dosjes mësimore.

III 6. Ndjek në mënyrë të pavarur udhëzimet apo skicat e dhëna në libër, skicë, plan, partiturë muzikore, skenar, koreografi etj., ose të ndonjë burimi tjetër, për të performuar një veprim, aktivitet ose detyrë që kërkohet prej tij/saj.

III 7. Shfrytëzon në mënyrë të efektshme teknika të ndryshme gjatë të nxënës të temës së dhënë, duke veçuar informatat që i kupton nga informatat e reja, të panjohura, si dhe informatat që për të mbeten ende të paqarta.

Rezultatet e fushës së kurrikulës (të synuara):

Dallon dhe krahason ndërtimin dhe funksionin e qelizës, indeve, organeve dhe sistemeve të organeve, duke u referuar biodiversitetit të qenieve të gjalla, shkaktarët e sëmundjeve të njeriut, shtazët, bimët dhe mënyrat e kontrollit të tyre, metabolizmin, zhvillimin individual të njeriut dhe evolucionin e qenieve të gjalla.
Shpjegon rolin e karbohidrateve, mineraleve, lipideve, proteinave, vitaminave, ujit dhe fibrave për dietë të shëndetshme dhe llogarit nevojën ditore për energji nga ushqimet e konsumuara.

ASPEKTET SPECIFIKE TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE

Njësia mësimore: Sistemi i organeve të frymëmarrjes te shtazët

Fjalët kyçe: *branshi, frymëmarrje, mushkëri, oksigjen, këmbim i gazeve.*

Rezultati/et e të nxënësve për orë mësimore:

Definon çfarë kuptoni me frymëkëmbim;

Vlerëson prezencën e trastave ajrore në sistemin respirativ të shpendëve;

Tregon se çfarë ndodh gjatë frymëmarrjes së jashtme dhe të brendshme.

Kriteret e suksesit:

Dallo organet e frymëmarrjes tek organizmat e ndryshëm;

Specifikon sistemin e frymëkëmbimit të shpezët;

Krahaso frymëmarrjen e brendshme edhe atë të jashtme.

Burimet, mjetet e konkretizimit dhe materialet mësimore: *Libri Biologjia 8, laptop, projektor.*

Lidhja me lëndët e tjera mësimore dhe/apo me çështjet ndërkurrikulare dhe situatat jetësore:

Gjuhë dhe komunikim, kimi, TIK

PËRSHKRIMI I METODOLOGJISË DHE VEPRIMTARITË E PUNËS ME NXËNËS GJATË ORËS MËSIMORE

IMAGJINATË E DREJTUAR

Mësimdhënësi/ja në fillim të orës u kërkon nxënësve që të shikojnë një video që do të shfaqet tani në ekran. Videoja sqaron përmes animacioneve procesin e këmbimit të gazeve te shtazët e ndryshme përfshirë këtu organizma pakurizorë dhe kurizorë.

<https://www.youtube.com/watch?v=LXGG-HqtJol>, (shembull i videos).

DRTA


Në vijim mësimdhënësi/ja u shpjegon nxënësve procedurën, e cila do të zhvillohet si më poshtë: Hapet teksti në temën mësimore “Sistemi i organeve të frymëmarrjes” dhe u kërkon nxënësve që të lexojnë vetëm paragrafin e parë dhe më pas t’i mbyllin librat dhe të komentojnë atë që lexuan. Kështu veprohet edhe me pjesën tjetër “traketë”, pastaj mbyllin librat dhe fillojnë komentimin. Vazhdojnë me pjesën “branshitë”, komentojnë çfarë kanë lexuar. Kështu vazhdohet deri në përfundim të gjithë mësimi.

PYETJE - PËRGJIGJE

Pasi nxënësit kanë realizuar leximin dhe kanë diskutuar për organet e frymëmarrjes, mësimdhënësi/ja ka përgatitur paraprakisht pyetjet e niveleve të ndryshme të menduarit dhe u kërkon nxënësve që përmes përzgjedhjes së rastësishtme të testojnë njohuritë e fituara.


- 1. Defino çfarë kuptoni me frymëkëmbim?*
- 2. Dallo organet e frymëmarrjes te organizmat e ndryshëm bazuar në fotografi.*
- 3. Numëro organizmat shtazorë që jetojnë dhe zhvillohen në mjedise ku mungon oksigjeni.*

4. Përmes trungut me degë, si në foto, rendit organet e frymëmarrjes të njeriu.
5. Vlerëso prezencën e trastave ajrore në sistemin respirativ të shpendëve.
6. Duke e ditur që rritja e bretkosës kalon përmes procesit të metamorfozës, specifikoj organet e frymëkëmbimit gjatë secilës fazë.
7. Krahaso frymëmarrjen e brendshme edhe atë të jashtme.



8. Specifikoj si frymëkëmbimi të ndryshëm.

9. Vlerëso këmbimit të gazeve shtazët. pyetje të tjera)



VLERËSIMI I NXËNËSVE

Vlerësimi me gojë (diskutime, debate, prezantime).

DETYRAT DHE PUNA E PAVARUR

REFLEKTIM PËR RRJEDHËN E ORËS MËSIMORE

PLANIFIKIMI I ORËS MËSIMORE

ASPEKTET E PËRGJITHSHME TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE		
Fusha kurrikulare: Shkencat e natyrës Klasa: VIII	Lënda: Biologji	Shkalla e kurrikulës: IV
Tema (nga plani dymujor): Indet, organet dhe sistemet e organeve te shtazët	Rezultati i të nxënit të temës (nga plani dymujor): <i>Emërton disa sëmundje kryesore të sistemit të frymëmarrjes; Aplikon masazhin e zemrës, frymëmarrjen artificiale dhe simulon reanimimin.</i>	
Rezultatet e të nxënit për kompetencat kryesore të shkallës (të synuara):		
<p>I 6. Analizon përmbajtjen dhe kuptimin e nocioneve (koncepteve) të reja, duke përdorur leksikun adekuat, të përshatshëm dhe të saktë dhe i bën ato pjesë të dosjes mësimore.</p> <p>II 2. Përzgjedh informata nga burime të ndryshme, për një temë konkrete, i klasifikon ato në bazë të një kriteri të caktuar dhe i përdor ato për marrjen e një vendimi apo për zgjidhjen e një problemi/detyre.</p> <p>II 5. Arsyeton ndërmarrjen e hapave konkretë, të cilët kanë rezultuar përfundimin e një detyre/aktiviteti, zgjidhjen e një problemi apo të ndonjë punimi në klasë/shkollë apo gjetiu.</p>		
Rezultatet e fushës së kurrikulës (të synuara):		
<p><i>Dallon dhe krahason ndërtimin dhe funksionin e qelizës, indeve, organeve dhe sistemeve të organeve, duke iu referuar biodiversitetit të qenieve të gjalla, shkaktarët e sëmundjeve të njeriut, shtazët, bimët dhe mënyrat e kontrollit të tyre, metabolizmin, zhvillimin individual të njeriut dhe evolucionin e qenieve të gjalla.</i></p> <p style="text-align: right;"><i>Shpjegon rolin e karbohidrateve, mineraleve, lipideve, proteinave, vitaminave, ujit dhe fibrave për dietë të shëndetshme dhe llogarit nevojën ditore për energji nga ushqimet e konsumuara.</i></p>		
ASPEKTET SPECIFIKE TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE		
Njësia mësimore: Sëmundjet e rrugëve të frymëmarrjes dhe mushkërive		
Fjalët kyçe: <i>frymëmarrje, oksigjen, tuberkuloz, kancer i mushkërive, ftohje.</i>		
Rezultati/et e të nxënit për orë mësimore:		
<p><i>Emërton sëmundjet e rrugëve të frymëmarrjes;</i></p> <p><i>Shpjegon se cilët janë shkaktarët e shfaqjes së tuberkulozit;</i></p> <p><i>Përshkruan mënyrën si duhet vepruar në raste shumë urgjente, të tilla si një sulm (atak) në zemër ose afër mbytjes.</i></p>		
Kriteret e suksesit:		
<p><i>Shpjego shkaktarët e gripit dhe të ftohjes;</i></p> <p><i>Vlerëso rëndësinë e vaksinimit kundër TBC;</i></p> <p><i>Demonstro mënyrën si duhet vepruar në raste si një sulm (atak) në zemër.</i></p>		

Burimet, mjetet e konkretizimit dhe materialet mësimore:

Libri Biologjia 8, laptop, projektor, kukull për ushtrimin e ndihmës së parë.

Lidhja me lëndët e tjera mësimore dhe/apo me çështjet ndërkurrikulare dhe situatat jetësore:

Gjuhë dhe komunikim, Kimi, TIK, Edukatë fizike.

PËRSHKRIMI I METODOLOGJISË DHE VEPRIMTARITË E PUNËS ME NXËNËS GJATË ORËS MËSIMORE

STUHI MENDIMESH

Mësimdhënësi/ja në fillim të orës u kërkon nxënësve që të diskutojnë rreth sëmundjeve të rrugëve të frymëmarrjes dhe të mushkërive. Sigurisht mendimet mund të jenë të ndryshme.

MBAJTJE E STRUKTURUAR E SHËNIMEVE

Mësimdhënësi/ja paraqet në tabelë një organizues grafik që thekson sëmundjet e sistemit të organeve të frymëmarrjes. Nxënësit do të mbajnë shënime për informacionin e duhur në hapësirat në skicën e grafikut duke përshkruar dhe analizuar rëndësinë e kujdesit ndaj organeve të frymëmarrjes. Mësimdhënësi/ja kërkon nga nxënësit që të respektojnë plotësimin e kutive në rrugë logjike pasi të kenë lexuar në dyshe një fragment të caktuar. Është me rëndësi që çdo kuti të ketë të dhëna të caktuara, fakte që ata i gjejnë në tekst dhe i plotësojnë hap pas hapi. Pasi kjo detyrë është individuale, nxënësit nxiten që pas përfundimit, vetë të prezantojnë para të tjerëve punën e tyre.

Tuberkulozi

Kanceri i mushkërive

Sëmundjet e rrugëve të frymëmarrjes dhe mushkërive

Ftohjet dhe infeksionet bakteriale

Ftohjet shkaktohen nga viruset. Gjatë të ftohurit, mukozat e fytit dhe hundës formojnë jargë (lëng i trashë) që rrjedhin nga hundët. Infeksioni bartet lehtësisht nga njëri-tjetri me pika të vogla të lëngjeve që dalin nga hunda dhe fyti kur teshtijmë dhe kollitemi. Ekzistojnë ilaçe efektive të cilat zbusin problemat që shkakton sëmundja.

PUNË PRAKTIKE

Pasi të ketë mbaruar diskutimi për pjesën e dytë të orës mësimore, tani është koha të demonstrohet ndihma e parë, më saktë frymëmarrja artificiale dhe masazhi i zemrës. Nëse është e mundur prezenca e kukullës për ushtrime (mjet konkretizimi) demonstrimi bëhet në të, nëse nuk ka mjete të konkretizimit, mësimdhënësi/ja shpjegon në detaje këtë procedurë, pra hapat si duhet të veprohet. Dhe në fund nxënësit ndjekin në ekran video të frymëmarrjes artificiale dhe të masazhit të zemrës.

<https://www.youtube.com/watch?v=wUJ-BIEY7HO>


Të njëjtin ushtrim e përsërisin dhe demonstrojnë edhe nxënësit. Nxënësit duhet të arsyetojnë ndërmarrjen e hapave konkretë, të cilët do të rezultojnë në përfundimin me sukses të dhënies së ndihmës në rast të atakut apo edhe mbyttjes.

Si duhet të veproni?

Shkudenti viktimën butësisht nga shpatullat dhe pyesni me zë të lartë: "A je në rregull?"

- 1. Nëse nuk ka përgjigje, kërkoni nga një ndihmës që të telefonojë shërbimet e urgjencës ose telefonoji ti vetë.*
- 2. Vendoseni viktimën në pozicionin në kurriz.*
- 3. Shikoni, dëgjoni dhe ndieni frymëmarrjen për rreth 10 sekonda. Një viktimë që mezi merr frymë, ose ka gulçime të rralla, por të zhurmshme, nuk merr frymë normalisht.*
- 4. Nëse nuk ka puls ose frymëmarrje brenda 10 sekondash, jepini dy frymëmarrje artificiale në gojë.*

5. Pas frymëmarrjes artificiale, filloni masazhin e zemrës me rreth 30 ngjeshje në qendër të gjoksit (sternum).
6. Nëse jeni i sigurt se viktimi po merr frymë normalisht, por ende nuk reagon, kthejeni personin në pozicion krahu.



VLERËSIMI I NXËNËSVE

Vlerësimi me gojë (diskutime, debate, prezantime).

DETYRAT DHE PUNA E PAVARUR

REFLEKTIM PËR RRJEDHËN E ORËS MËSIMORE

PLANIFIKIMI I ORËS MËSIMORE

ASPEKTET E PËRGJITHSHME TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE		
Fusha kurrikulare: Shkencat e natyrës	Lënda: Biologji	Shkalla e kurrikulës: IV
Klasa: VIII		
Tema (nga plani dymujor): Indet, organet dhe sistemet e organeve te shtazët	Rezultati i të nxënit të temës (nga plani dymujor): <i>Emërton dhe shpjegon organet dhe sistemin e organeve të tajitjes (ekskretimit); Përshkruan procesin e tajitjes te grupet e ndryshme shtazore, si dhe sëmundje të organeve për tajitje.</i>	
Rezultatet e të nxënit për kompetencat kryesore të shkallës (të synuara): <p>I 6. <i>Analizon përmbajtjen dhe kuptimin e nocioneve (koncepteve) të reja, duke përdorur leksikun adekuat, të përshtatshëm dhe të saktë dhe i bën ato pjesë të dosjes mësimore.</i></p> <p>II 7. <i>Interpreton me fjalë, me shkrim/me gojë një rregull, koncept apo proces të caktuar duke e ilustruar atë me shembuj konkretë nga situata të jetës së përditshme.</i></p> <p>II 8. <i>Identifikon me anë të krahasimit dallimet dhe ngjashmëritë midis ligjeve dhe dukurive që ndodhin në natyrë me ato në shoqëri, duke vënë në dukje lidhjen shkak-pasojë midis këtyre dukurive.</i></p>		
Rezultatet e fushës së kurrikulës (të synuara): <i>Dallon dhe krahason ndërtimin dhe funksionin e qelizës, indeve, organeve dhe sistemeve të organeve, duke iu referuar biodiversitetit të qenieve të gjalla, shkaktarët e sëmundjeve te njeriu, shtazët, bimët dhe mënyrat e kontrollit të tyre, metabolizmin, zhvillimin individual të njeriut dhe evolucionin e qenieve të gjalla. Shpjegon rolin e karbohidrateve, mineraleve, lipideve, proteinave, vitaminave, ujit dhe fibrave për dietë të shëndetshme dhe llogarit nevojën ditore për energji nga ushqimet e konsumuara.</i>		
ASPEKTET SPECIFIKE TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE		
Njësia mësimore: Sistemi i organeve të tajitjes (ekskretimit)		
Fjalët kyçe: <i>metanefridie, protonefridie, veshkë, mëshikëz urinare, gypa të Malpigut.</i>		
Rezultati/et e të nxënit për orë mësimore: <i>Krahason ndërtimin e organeve tajitëse te krimbat unazorë dhe këmbënyjëtuarit; Dallon ndërtimin e organeve tajitëse te shpendët dhe gjitharët; Vlerëson kujdesin ndaj organeve të ekskretimit.</i>		
Kriteret e suksesit: <i>Përshkruaj ndërtimin e organeve tajitëse te pakurrizorët dhe kurrizorët; Specifikon rolin e metanefridieve dhe gypave të Malpigut; Numëro disa nga çrregullimet e sistemit të tajitjes.</i>		

Burimet, mjetet e konkretizimit dhe materialet mësimore:

Libri Biologjia 8, tabela.

Lidhja me lëndët e tjera mësimore dhe/apo me çështjet ndërkurrikulare dhe situatat jetësore:

Gjuhë dhe komunikim, kimi.

PËRSHKRIMI I METODOLOGJISË DHE VEPRIMTARITË E PUNËS ME NXËNËS GJATË ORËS MËSIMORE

STUHI MENDIMESH

Në fillim të orës mësimore mësimdhënësi/ja u kërkon nxënësve që të shpalosin njohuritë e tyre në lidhje me sistemin e ekskretimit dhe kujdesin ndaj këtyre organeve. Fillimisht të mendojnë pak në heshtje dhe pastaj të fillojë diskutimi për të gjithë nxënësit. Mësimdhënësi/ja në tabelë paraqet konceptet kryesore që nxënësit mund të shprehin gjatë diskutimit, të cilat pastaj do t'i pohojnë ose mohojnë pasi ta kenë zhvilluar njësinë mësimore.

TABELA E KONCEPTEVE

Në vijim mësimdhënësi/ja u shpjegon nxënësve se duhet të hapin librat dhe të lexojnë në heshtje njësinë mësimore dhe pastaj në bashkëpunim me shokun e bankës (punë në dyshe) të punojnë tabelën e koncepteve.

<i>Sistemi i tajitjes te pakurrizorët</i>			<i>Sistemi i tajitjes te kurrizorët</i>				
<i>Krimbat e shtypur</i>	<i>Krimbat unzorë</i>	<i>Këmbënyjëtuarit</i>	<i>Peshqit</i>	<i>Ujëtokësorët</i>	<i>Zvarranikët</i>	<i>Shpendët</i>	<i>Gjitarët</i>
					<i>Veshkat gjenden në pjesën e prapme të zgavrës së barkut. Përbëhen nga një numër i madh kanalesh të holla, të cilat marrin nga gjaku produktet e tajimit. Urina kalon në pjesën e</i>		

					<p>zgjerruar të zorrës nëpërmjet dy kanaleve urinare. Ashtu si ujëtokësorët edhe hardhuca ka mëshikëz urinare.</p>		
--	--	--	--	--	--	--	--

DISKUTIM

Pasi nxënësit kanë lexuar dhe kanë punuar njësinë mësimore përmes tabelës së koncepteve, në pjesën e fundit fillon diskutimi rreth koncepteve kryesore. Sigurisht mësimitdhënësi/ja i orienton nxënësit drejt realizimit të tabelës së koncepteve në tabelë. Pastaj fillon diskutimi. Krejt në fund diskutojnë edhe për kujdesin ndaj organeve të ekskretimit dhe çrregullimet që mund të shfaqen ndaj moskujdesit.

VLERËSIMI I NXËNËSVE

Vlerësimi me gojë (diskutime, debate, prezantime).

DETYRAT DHE PUNA E PAVARUR

REFLEKTIM PËR RRJEDHËN E ORËS MËSIMORE

PLANIFIKIMI I ORËS MËSIMORE

ASPEKTET E PËRGJITHSHME TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE

Fusha kurrikulare: Shkencat e natyrës Lënda: Biologji Shkalla e kurrikulës: IV
Klasa: VIII

Tema (nga plani dymujor):
Indet, organet dhe sistemet e organeve te shtazët

Rezultati i të nxënit të temës (nga plani dymujor):
*Identifikon dhe shpjegon mbështjellësin trupor të grupet e ndryshme të shtazëve dhe derivatet e mbështjellsit trupor;
Vlerëson rolin e higjienës së lëkurës (posaçërisht të duarve) për të evituar sëmundjet e sistemit tretës.*

Rezultatet e të nxënit për kompetencat kryesore të shkallës (të synuara):

- I 6.** *Analizon përmbajtjen dhe kuptimin e nocioneve (koncepteve) të reja, duke përdorur leksikon adekuat, të përshtatshëm dhe të saktë dhe i bën ato pjesë të dosjes mësimore.*
- II 7.** *Interpreton me fjalë, me shkrim/me gojë një rregull, koncept apo proces të caktuar, duke e ilustruar atë me shembuj konkretë nga situata të jetës së përditshme.*
- II 8.** *Identifikon me anë të krahasimit dallimet dhe ngjashmëritë midis ligjeve dhe dukurive që ndodhin në natyrë me ato në shoqëri, duke vënë në dukje lidhjen shkak-pasojë midis këtyre dukurive.*

Rezultatet e fushës së kurrikulës (të synuara):

Dallon dhe krahason ndërtimin dhe funksionin e qelizës, indeve, organeve dhe sistemeve të organeve, duke iu referuar biodiversitetit të qenieve të gjalla, shkaktarët e sëmundjeve të njeriut, shtazët, bimët dhe mënyrat e kontrollit të tyre, metabolizmin, zhvillimin individual të njeriut dhe evolucionin e qenieve të gjalla.
Shpjegon rolin e karbohidrateve, mineraleve, lipideve, proteinave, vitaminave, ujit dhe fibrave për dietë të shëndetshme dhe llogarit nevojën ditore për energji nga ushqimet e konsumuara.

ASPEKTET SPECIFIKE TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE

Njësia mësimore: Mbulesa trupore te grupet e ndryshme të shtazëve

Fjalët kyçe: *lëkurë, luspa, qime, ngacmime, gjëndra djerësore, epiderma.*

Rezultati/et e të nxënit për orë mësimore:

*Përshkruan rolin e mbulesës trupore te shtazët e ndryshme;
Krahason ndërtimin dhe funksionin e lëkurës së pakurrizorëve të ndryshëm dhe kurrizorëve;
Shpjegon rëndësinë e higjienës së duarve dhe të lëkurës në përgjithësi në parandalimin e shfaqjes së infeksioneve të ndryshme.*

Kriteret e suksesit:

*Vlerëso rolin e lëkurës për ujëtokësorët;
Dallo shtesat e lëkurës te kurrizorët;
Specifikoj hapat ndaj kujdesit të lëkurës për parandalim të infeksioneve.*

Burimet, mjetet e konkretizimit dhe materialet mësimore:

Libri Biologjia 8, laptop, projektor.

Lidhja me lëndët e tjera mësimore dhe/apo me çështjet ndërkurrikulare dhe situatat jetësore:

Gjuhë dhe komunikim, kimi, TIK.

PËRSHKRIMI I METODOLOGJISË DHE VEPRIMTARITË E PUNËS ME NXËNËS GJATË ORËS MËSIMORE

IMAGJINATË E DREJTUAR

Mësimdhënësi/ja në fillim të orës u kërkon nxënësve që të përcjellin me vëmendje një video që përshkruan mbulesën trupore të kategoritë e shtazëve.

<https://www.youtube.com/watch?v=nw7Gv8FRBt0>

Pastaj nxënësit fillojnë diskutimin për videon që panë.

VLD (VEPRIMTARI ME LEXIM TË DREJTUAR)

Në vijim mësimdhënësi/ja u shpjegon nxënësve procedurën, i udhëzon nxënësit që, pasi të lexojnë temën mësimore me vëmendje, të nxjerrin përfundime mbi të, duke u shërbyer me pyetjet, si:

- 1. Përshkruaj rolin e lëkurës së organizmave të ndryshëm shtazorë (peshqit, ujëtokësorët, zvarranikët, shpendët dhe gjitarët).*
- 2. Krahaso ndërtimin dhe funksionin e lëkurës së pakurrizorëve të ndryshëm (insektet, krimbi i tokës).*
- 3. Analizo ndërtimin dhe funksionin e lëkurës (mbështjellësin trupor) të ujëtokësorëve dhe të zvarranikëve.*
- 4. Numëro produktet e lëkurës së zvarranikëve, të shpendëve dhe të gjitarëve.*
- 5. Shpjego rëndësinë e edukatës së higjienës së duarve në parandalimin e infeksioneve të organeve të tretjes.*

(shto pyetje shtesë)

KLLASTER

Pasi nxënësit kanë lexuar dhe komentuar njësinë mësimore, mësimdhënësi/ja i fton ata të punojnë një kllaster në formë të përmbledhjes, fillimisht punojnë në grupe. Pastaj mësimdhënësi/ja i fton ata që të njëjtin ta punojnë edhe në tabelë, duke bashkëpunuar njëri me tjetrin.

VLERËSIMI I NXËNËSVE

Vlerësimi me gojë (diskutime, debate, prezantime).

DETYRAT DHE PUNA E PAVARUR

Hulumtoni për ndërtimin e sistemit nervor të shtazët e ndryshme.

REFLEKTIM PËR RRJEDHËN E ORËS MËSIMORE

PLANIFIKIMI I ORËS MËSIMORE

ASPEKTET E PËRGJITHSHME TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE

Fusha kurrikulare: Shkencat e natyrës Lënda: Biologji Shkalla e kurrikulës: IV
Klasa: VIII

Tema (nga plani dymujor):
Indet, organet dhe sistemet e organeve te shtazët

Rezultati i të nxënit të temës (nga plani dymujor):

Emërton dhe shpjegon indin nervor, organet dhe sistemin e organeve nervore;

*Analizon evolucionin e sistemit nervor te shtazët;
Analizon procesin e funksionimit të sistemit nervor prej pranimit të ngacmimit deri te reagimi.*

Rezultatet e të nxënit për kompetencat kryesore të shkallës (të synuara):

I 6. *Analizon përmbajtjen dhe kuptimin e nocioneve (koncepteve) të reja, duke përdorur leksikon adekuat, të përshtatshëm dhe të saktë dhe i bën ato pjesë të dosjes mësimore.*

II 8. *Identifikon me anë të krahasimit dallimet dhe ngjashmëritë midis ligjeve dhe dukurive që ndodhin në natyrë me ato në shoqëri, duke vënë në dukje lidhjen shkak-pasojë midis këtyre dukurive.*

IV 1. *Vlerëson rëndësinë e punës individuale dhe në grupe për zhvillimin e komunitetit duke paraqitur, në forma të ndryshme të të shprehurit, shembuj konkretë nga jeta e përditshme.*

Rezultatet e fushës së kurrikulës (të synuara):

Dallon dhe krahason ndërtimin dhe funksionin e qelizës, indeve, organeve dhe sistemeve të organeve, duke iu referuar biodiversitetit të qenieve të gjalla, shkaktarët e sëmundjeve te njeriu, shtazët, bimët dhe mënyrat e kontrollit të tyre, metabolizmin, zhvillimin individual të njeriut dhe evolucionin e qenieve të gjalla.

Shpjegon rolin e karbohidrateve, mineraleve, lipideve, proteinave, vitaminave, ujit dhe fibrave për dietë të shëndetshme dhe llogarit nevojën ditore për energji nga ushqimet e konsumuara.

ASPEKTET SPECIFIKE TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE

Njësia mësimore: **Sistemi nervor - koordinator i funksioneve jetësore**

Fjalët kyçe: *truri, nervat, ngacmueshmëri, refleks.*

Rezultati/et e të nxënit për orë mësimore:

Definon rolin e sistemit nervor për organizmin;

Emërton pjesët e sistemit nervor;

Krahason ndërtimin e sistemit nervor te pakurrizorët dhe kurrizorët.

Kriteret e suksesit:

Specifikon rëndësinë e sistemit nervor te pakurrizorët (lëkurëgjemborët dhe butakët);

Dallo nga fotografia ndërtimin e trurit te kurrizorët (gjitarët);
Veço specifikat e sistemit nervor te shpendët dhe zvarranikët.

Burimet, mjetet e konkretizimit dhe materialet mësimore:

Libri Biologjia 8, laptop, projektor.


Lidhja me lëndët e tjera mësimore dhe/apo me çështjet ndërkurrikulare dhe situatat jetësore: *Gjuhë dhe komunikim, Kimi, TIK.*

PËRSHKRIMI I METODOLOGJISË DHE VEPRIMTARITË E PUNËS ME NXËNËS GJATË ORËS MËSIMORE

IMAGJINATË E DREJTUAR

Gjatë kësaj faze mësimdhënësi/ja u kërkon nxënësve të shikojnë në ekran një video, në të cilën bëhet fjalë për sistemin nervor. U kërkon nxënësve që të përcjellin me vëmendje videon, edhe pasi kanë përcjellë, fillon diskutimin, çfarë kanë parë në video, çfarë është e veçanta e videos etj.

<https://www.youtube.com/watch?v=fypf6Ec4750>




LEKSION I AVANCUAR

Mësimdhënësi/ja u shpjegon nxënësve në pika të shkurtra se gjatë evolucionit të botës shtazore, sistemi nervor paraqitet shumë herët. Ai ekziston te të gjitha shtazët, përveç te sfungjerët. **Grykorët** kanë sistemin nervor më të thjeshtë. Qelizat nervore me anë të zgjatimeve të tyre gërshetohen mes vete, duke formuar një rrjetë të dendur. Kështu sistemi nervor i këtyre shtazëve quhet sistem nervor rrjetor (difuz) dhe shtrihen në tërë sipërfaqen e trupit. **Krimbat** kanë sistem nervor të thjeshtë, por më të avancuar se grykorët. **Butakët** (p.sh., kërmilli i vreshtës) kanë sistem nervor të përbërë prej nyjave nervore, të cilat janë të vendosura kryesisht në kokë, e nga ku nisen fije të shumta nervore, që shpërndahen në të gjitha pjesët e trupit. **Këmbënyjtuarit** kanë sistem nervor më të ndërlikuar, sepse për herë të parë në to paraqitet truri. Sistemi nervor i tyre, përveç trurit, përbëhet edhe prej nyjave (ganglioneve) nervore, të pranishme në çdo segment të trupit dhe zinxhirit nervor që është i vendosur në anën barkore. **Sistemi nervor i kurrizorëve** ka arritur shkallën më të lartë të përsosjes. Ai është i përbërë nga truri, palca e kurrizit dhe nervat. Sistemi nervor i kurrizorëve është i tipit gypor dhe është i vendosur në pjesën e kokës dhe përgjatë tërë trupit. Në pjesën e kokës gjendet truri, ndërsa përgjatë trupit, në anën shpinore, shtrihet palca kurrizore. Truri dhe palca kurrizore përbëjnë sistemin nervor qendror, ndërsa


nervat, që degëzohen në trup, përbëjnë sistemin nervor periferik. (mësimdhënësi/ja përdor fotografi për të demonstruar sa më mirë njësinë mësimore).

KLLASTER

Pasi nxënësit kanë dëgjuar me vëmendje mësimdhënësin/en dhe më pas kanë lexuar në heshtje njësinë mësimore, në fund ata udhëzohen që të punojnë një kllaster në formë të përmbledhjes, fillimisht



punojnë në grupe. Pastaj mësimdhënësi/ja i fton ata që të njëjtin ta punojnë edhe në tabelë, duke bashkëpunuar njëri me tjetrin.



VLERËSIMI I NXËNËSVE

Vlerësimi me gojë (diskutime, debate, prezantime).

DETYRAT DHE PUNA E PAVARUR

Hulumtoni për ndërtimin e sistemit nervor të shtazët e ndryshme.

REFLEKTIM PËR RRJEDHËN E ORËS MËSIMORE

PLANIFIKIMI I ORËS MËSIMORE

ASPEKTET E PËRGJITHSHME TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE		
Fusha kurrikulare: Shkencat e natyrës Klasa: VIII	Lënda: Biologji	Shkalla e kurrikulës: IV
Tema (nga plani dymujor): Indet, organet dhe sistemet e organeve te shtazët	Rezultati i të nxënit të temës (nga plani dymujor): <i>Shpjegon ndërtimin e shqisës së të parit, dëgjuarit, ekuilibrit, shijes, muhatjes, shqisave lëkurore dhe analizon funksionin e tyre.</i>	
Rezultatet e të nxënit për kompetencat kryesore të shkallës (të synuara):		
<p>I 2. Përshkruan një ngjarje, të dhënë si detyrë, të lexuar ose të dëgjuar më parë, në formë verbale, vizuale ose me shkrim, duke ruajtur rrjedhën logjike të saj.</p> <p>II 8. Identifikon me anë të krahasimit dallimet dhe ngjashmëritë midis ligjeve dhe dukurive që ndodhin në natyrë me ato në shoqëri, duke vënë në dukje lidhjen shkak-pasojë midis këtyre dukurive.</p> <p>IV 1. Vlerëson rëndësinë e punës individuale dhe në grupe për zhvillimin e komunitetit duke paraqitur, në forma të ndryshme të të shprehurit, shembuj konkretë nga jeta e përditshme.</p>		
Rezultatet e fushës së kurrikulës (të synuara):		
<p><i>Dallon dhe krahason ndërtimin dhe funksionin e qelizës, indeve, organeve dhe sistemeve të organeve, duke iu referuar biodiversitetit të qenieve të gjalla, shkaktarët e sëmundjeve te njeriu, shtazët, bimët dhe mënyrat e kontrollit të tyre, metabolizmin, zhvillimin individual të njeriut dhe evolucionin e qenieve të gjalla.</i></p> <p style="text-align: right;"><i>Shpjegon rolin e karbohidrateve, mineraleve, lipideve, proteinave, vitaminave, ujit dhe fibrave për dietë të shëndetshme dhe llogarit nevojën ditore për energji nga ushqimet e konsumuara.</i></p>		
ASPEKTET SPECIFIKE TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE		
Njësia mësimore: Shqisat - sistem i organeve ndijore		
Fjalët kyçe: <i>receptor, shqisa, sy, vesh, lëkurë, termoreceptorë, kemoreceptor.</i>		
Rezultati/et e të nxënit për orë mësimore:		
<p><i>Emërton llojet e shqisave sipas natyrës së ngacmimit;</i></p> <p><i>Tregon se te cilat shtazë paraqitet veshi si shqisë e dëgjimit dhe ekuilibrit;</i></p> <p><i>Përshkruan ndërtimin e syrit si shqisë e të parit.</i></p>		
Kriteret e suksesit:		
<p><i>Specifikon vendndodhjen e shqisave duke specifikuar cilat shqisa kanë ndërlikueshmëri më të madhe e cilat jo;</i></p> <p><i>Krahaso ndërtimin e veshit te kurrizorët;</i></p> <p><i>Dallo shikimin e kurrizorëve të ndryshëm, bazuar në ndërlikueshmërinë e shqisës së shikimit.</i></p>		

Burimet, mjetet e konkretizimit dhe materialet mësimore:

Libri Biologjia 8, fotografi, laptop, projektor.

Lidhja me lëndët e tjera mësimore dhe/apo me çështjet ndërkurrikulare dhe situatat jetësore:

Gjuhë dhe komunikim, kimi, TIK.

PËRSHKRIMI I METODOLOGJISË DHE VEPRIMTARITË E PUNËS ME NXËNËS GJATË ORËS MËSIMORE

IMAGJINATË E DREJTUAR

Fillimisht mësimdhënësi/ja i kërkon një nxënësi që t'i mbyllë sytë dhe në dorë i jep të mbajë një kokërr mollë. Kështu, fillimisht nxënësi, përmes receptorëve të prekjes, dallon frutën që ka në dorë, a është e rrudhosur apo i lëmuar, pastaj i kërkon që t'i hapë sytë dhe, përmes shqisave të tjera, të tregojë se çfarë ngjyre ka, çfarë arome dhe në fund çfarë shije ka. Pastaj mësimdhënësi/ja u kërkon nxënësve të shikojnë në ekran disa fotografi dhe animacione që fokusi kryesor janë shqisat, funksioni i tyre. Fillimisht u kërkon nxënësve që të përcjellin me vëmendje fotografitë, edhe pastaj të fillojnë me diskutimin, çfarë kanë parë në foto, çfarë është e veçanta e tyre etj.






TABELA E KONCEPTEVE

Në vijim mësimdhënësi/ja i udhëzon nxënësit se duhet t'i hapin librat dhe të lexojnë në heshtje njësinë mësimore dhe pastaj në bashkëpunim me shokun e bankës (punë në dyshe) të punojnë tabelën e koncepteve.

<i>Shqisat e pakurrizorëve</i>			<i>Shqisat e kurrizorëve</i>						
<i>Grykorët</i>	<i>Butakët</i>	<i>Insektet</i>	<i>Shtaza</i>	<i>Syri</i>	<i>Veshi</i>	<i>Shqisat e të shijuarit</i>	<i>Shqisat e muhatjes</i>	<i>Shqisat në lëkurë</i>	
		Insektet kanë sy dhe një palë antena. Zakonisht kanë tre sy të thjeshtë dhe dy të përbërë. Sytë e thjeshtë e dallojnë dritën dhe errësirën, ndërsa sytë e përbërë i dallojnë ngjyrat dhe lëvizjen. Me antena e ndiejnë prekjen dhe nuhatjen.	<i>Peshq</i>						
			<i>Ujëtokësorë</i>						
				<i>Zvarranikë</i>					
				<i>Shpendë</i>					
				<i>Gjitarë</i>					

DISKUTIM

Mësimdhënësi/ja i udhëzon nxënësit që fillojnë diskutimin në lidhje me plotësimin e tabelës së koncepteve. Të njëjtën e punojnë edhe në tabelë të gjithë së bashku.

VLERËSIMI I NXËNËSVE

Vlerësimi me gojë (diskutime, debate, prezantime).

DETYRAT DHE PUNA E PAVARUR

Hulumtoni në lidhje me sistemin endokrin te shtazët.

REFLEKTIM PËR RRJEDHËN E ORËS MËSIMORE

PLANIFIKIMI I ORËS MËSIMORE

ASPEKTET E PËRGJITHSHME TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE

Fusha kurrikulare: Shkencat e natyrës
Klasa: VIII

Lënda: Biologji

Shkalla e kurrikulës: IV

Tema (nga plani dymujor):

Indet, organet dhe sistemet e organeve te shtazët

Rezultati i të nxënit të temës (nga plani dymujor):

Përshkruan dhe shpjegon ndërtimin dhe funksionin e gjëndrave endokrine; Liston hormonet më të rëndësishme të gjëndrave endokrine dhe përshkruan rolin fiziologjik të tyre te shtazët; Identifikon sëmundje që shfaqen si pasojë e çrregullimit të funksionit të sistemit endokrin.

Rezultatet e të nxënit për kompetencat kryesore të shkallës (të synuara):

- I 1.** *Transmeton saktë të dhënat e mbledhura për një temë konkrete, në formë tekstuale, numerike, verbale, elektronike apo në ndonjë formë tjetër të të shprehurit.*
- II 8.** *Identifikon me anë të krahasimit dallimet dhe ngjashmëritë midis ligjeve dhe dukurive që ndodhin në natyrë me ato në shoqëri, duke vënë në dukje lidhjen shkak-pasojë midis këtyre dukurive.*
- IV 1.** *Vlerëson rëndësinë e punës individuale dhe në grupe për zhvillimin e komunitetit, duke paraqitur në forma të ndryshme të të shprehurit, shembuj konkretë nga jeta e përditshme.*

Rezultatet e fushës së kurrikulës (të synuara):

Dallon dhe krahason ndërtimin dhe funksionin e qelizës, indeve, organeve dhe sistemeve të organeve, duke iu referuar biodiversitetit të qenieve të gjalla, shkaktarët e sëmundjeve te njeriu, shtazët, bimët dhe mënyrat e kontrollit të tyre, metabolizmin, zhvillimin individual të njeriut dhe evolucionin e qenieve të gjalla. Shpjegon rolin e karbohidrateve, mineraleve, lipideve, proteinave, vitaminave, ujit dhe fibrave për dietë të shëndetshme dhe llogarit nevojën ditore për energji nga ushqimet e konsumuara.

ASPEKTET SPECIFIKE TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE

Njësia mësimore: **Sistemi endokrin**

Fjalët kyçe: *gjëndër, hormone, hipofizë, adrenalinë, testosteron.*

Rezultati/et e të nxënit për orë mësimore:

Emërton gjëndrat hormonale endokrine;

Krahason pankreasin endokrin nga ai ekzokrin;

Numëron disa nga sëmundjet/çrregullimet, që mund të shfaqen si pasojë e mosfunksionimit të sistemit endokrin.

Kriteret e suksesit:

Specifikon veprimin e hipofizës, tiroidit, paratiroidit;

Shpjego se si niveli i sheqerit në gjak kontrollohet nga hormonet;

Analizo efektet e prodhimit jo të mjaftueshëm ose të tepërt të tiroksinës për organizmin.

Burimet, mjetet e konkretizimit dhe materialet mësimore:

Libri Biologjia 8.

Lidhja me lëndët e tjera mësimore dhe/apo me çështjet ndërkurrikulare dhe situatat jetësore:

Gjuhë dhe komunikim, kimi.

PËRSHKRIMI I METODOLOGJISË DHE VEPRIMTARITË E PUNËS ME NXËNËS GJATË ORËS MËSIMORE

GRUPI GUMËZHITËS

Mësimdhënësi/ja shkruan në tabelë titullin e njësisë së re mësimore “Sistemi endokrin”, dhe u kërkon nxënësve të mendojnë për disa minuta lidhur me temën e dhënë. Pasi kanë menduar në heshtje, u kërkon që të gumëzhisin (bisedojnë me zë të ulët) në çifte që të shkëmbejnë idetë e tyre, pastaj u jep fjalën të shprehin atë çfarë kanë menduar, mendimet e tyre mësimdhënësi/ja i shkruan në tabelë, pa i mohuar apo pohuar ato, pasi këto mendime do të vlerësohen nga nxënësit si të sakta apo të gabuara në fund të orës mësimore.

MËSIM I PËRQENDRUAR NË ARGUMENTE

Mësimdhënësi/ja u kërkon nxënësve t'i hapin librat dhe të lexojnë të ndarë në pjesë njësinë mësimore.

Njëri grup lexon: hormonet, grupi tjetër lexon: rolin e gjëndrave hormonale, grupi tjetër: çrregullimet hormonale. Pasi të kenë lexuar praragrafët e dhënë, tani nxënësit me vëmendje përcjellin pyetjet e mësimdhënësit/es dhe, në bashkëpunim me grupin, përgjigjen, nëse ka dy grupe që kanë lexuar pjesën e njëjtë, atëherë mund të realizohet diskutimi.

- 1. Cilat janë sistemet e transmetimit të informacionit në trupin e njeriut?*
- 2. Sqaro mënyrën e transmetimit të informacionit përmes sistemit hormonal..*
- 3. Emërto gjëndrat hormonale endokrine.*

4. Emërto gjëndrat eksokrine.
5. Përshkruaj rolin e gjëndrës hipofizë.
6. Shpjego rolin e pankreasit në organizëm.
7. Cili hormon ndikon në sistemin nervor, në mënyrë që të rritet vigjilenca, reagimi dhe rrahjet e zemrës?
8. Trego se cilat hormone përdoren në mjekësi.
9. Shpjego me fjalët tuaja se si niveli i sheqerit në gjak kontrollohet nga hormonet.
10. Përshkruaj efektet e prodhimit jo të mjaftueshëm ose të tepërt të tiroksinës për organizmin.

(shto pyetje të tjera)

DISKUTIM

Mësimdhënësi/ja i udhëzon nxënësit që fillojnë diskutimin në lidhje me plotësimin e tabelës së koncepteve. Të njëjtën e punojnë edhe në tabelë të gjithë së bashku.

VLERËSIMI I NXËNËSVE

Vlerësimi me gojë (diskutime, debate, prezantime).

DETYRAT DHE PUNA E PAVARUR

REFLEKTIM PËR RRJEDHËN E ORËS MËSIMORE

Fusha kurrikulare: Shkencat e natyrës
Klasa: VIII

Lënda: Biologji

Shkalla e kurrikulës: IV

Tema (nga plani dymujor):
Indet, organet dhe sistemet e organeve te shtazët

Rezultati i të nxënit të temës (nga plani dymujor):
*Emërton dhe shpjegon ndërtimin dhe funksionin e sistemit për riprodhim të grupeve shtazore;
Shpjegon mënyrat e shumimit të grupeve të ndryshme shtazore.*

Rezultatet e të nxënit për kompetencat kryesore të shkallës (të synuara):

I 6. *Inicion biseda shoqërore me moshatarët dhe me të rriturit për tema me interes mësimor/shoqëror, duke shtruar pyetje për temën dhe duke u përgjigjur dhe veçuar informatën kryesore.*

II 8. *Identifikon me anë të krahasimit dallimet dhe ngjashmëritë midis ligjeve dhe dukurive që ndodhin në natyrë me ato në shoqëri, duke vënë në dukje lidhjen shkak-pasojë midis këtyre dukurive.*

IV 1. *Vlerëson rëndësinë e punës individuale dhe në grupe për zhvillimin e komunitetit duke paraqitur, në forma të ndryshme të të shprehurit, shembuj konkretë nga jeta e përditshme.*

Rezultatet e fushës së kurrikulës (të synuara):

*Dallon dhe krahason ndërtimin dhe funksionin e qelizës, indeve, organeve dhe sistemeve të organeve, duke iu referuar biodiversitetit të qenieve të gjalla, shkaktarët e sëmundjeve të njeriut, shtazët, bimët dhe mënyrat e kontrollit të tyre, metabolizmin, zhvillimin individual të njeriut dhe evolucionin e qenieve të gjalla.
Shpjegon rolin e karbohidrateve, mineraleve, lipideve, proteinave, vitaminave, ujit dhe fibrave për dietë të shëndetshme dhe llogarit nevojën ditore për energji nga ushqimet e konsumuara.*

ASPEKTET SPECIFIKE TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE

Njësia mësimore: **Sistemi i riprodhimit te shtazët**

Fjalët kyçe: *gjëndra, riprodhim, vezë, pllenim.*

Rezultati/et e të nxënit për orë mësimore:

*Dallon mënyrat e riprodhimi te pakurrizorët dhe kurrizorët;
Krahason procesin e pllenimit të lëkurëgjemborëve dhe të zvarranikëve;
Shpjegon riprodhimin e peshqve dhe ujëtokësorëve.*

Kriteret e suksesit

*Krahaso riprodhimin aseksual me atë seksual;
Shpjego se si niveli i sheqerit në gjak kontrollohet nga hormonet;
Specifiko si ndodh riprodhimi te kurrizorët.*

Burimet, mjetet e konkretizimit dhe materialet mësimore:

Libri Biologjia 8.

Lidhja me lëndët e tjera mësimore dhe/apo me çështjet ndërkurrikulare dhe situatat jetësore:
Gjuhë dhe komunikim, kimi.

PËRSHKRIMI I METODOLOGJISË DHE VEPRIMTARITË E PUNËS ME NXËNËS GJATË ORËS MËSIMORE

Stuhi mendimesh

Mësimdhënësi/ja shkruan në tabelë titullin e njësisë së re mësimore “Sistemi i riprodhimit të shtazët”, dhe u kërkon nxënësve të mendojnë për disa minuta lidhur me temën e dhënë. Pasi kanë menduar në heshtje, u kërkon që të fillojnë diskutimin të shprehin atë çfarë kanë menduar, mendimet e tyre mësimdhënësi/ja i shkruan në tabelë, pa i mohuar apo pohuar ato, pasi këto mendime do të vlerësohen nga nxënësit si të sakta apo të gabuara në fund të orës mësimore.

GRUPET E EKSPERTËVE

Mësimdhënësi/ja zgjedh të punojë përmes grupeve të ekspertëve. Nxënësit ndahen në grupe pune dhe cakton numrat nga 1-6 për secilin nxënës të çdo grupi, i udhëzon të orientohen në libër dhe të lexojnë secili nxënës nga një pjesë.

Pasi nxënësit të kenë kuptuar pjesën e tyre, fton që në një grup të bashkohen numrat 1 nga të gjitha grupet, pastaj në grupin tjetër 2-shat, në grupin tjetër 3-shat, në grupin tjetër 4-shat, në grupin e fundit 6-shat. Kështu, të bashkuar fton nxënësit të diskutojnë në mes tyre lidhur me atë çfarë lexuan, sa kanë mbajtur në mend, dhe këto informacione t’i shkëmbejnë me njëri-tjetrin. Pas pak minutash, fton nxënësit të kthehen në grupet e tyre fillestare dhe aty të diskutojnë prapë për atë çfarë mbajtën në mend secili për pjesën e tyre.

RRJETI I DISKUTIMIT

Mësimdhënësi/ja i udhëzon nxënësit që fillojnë diskutimin në lidhje me numrat që ata kishin. Zgjidhet një përfaqësues i njëshave, të cilët kishin për detyrë të lexonin për riprodhimin të lëkurëgjemborët, grupet e tjera bëjnë pyetje dhe kërkojnë sqarime të nevojshme. Kështu vazhdohet me numrat dy, që kishin për detyrë të lexonin për riprodhimin të peshqit, ata sqarojnë se te peshqit sekset janë të ndara. Mashkulli ka dy gjëndra seksuale mashkullore (farorë), të cilat prodhojnë spermatozoide dhe në kohën e riprodhimit i lëshojnë në ujë spermatozoidet, ndërsa femra po ashtu ka dy gjëndra seksuale femërore (vezore), të cilat prodhojnë vezë dhe i lëshojnë në ujë. Pra, te këto shtazë pllenimi është i jashtëm dhe bëhet në ujë. Kështu vazhdohet edhe me grupet e tjera derisa të arrihet te gjitarët. Grupi i fundit sqaron se te gjitarët sekset janë të ndara. Dy gjëndrat seksuale mashkullore të mashkullit (farorët) janë në formë vezake dhe prodhojnë qeliza seksuale mashkullore (spermatozoide). Te femra janë të zhvilluara dy gjëndra seksuale femërore (vezore), të cilat gjenden në zgavrën e barkut dhe prodhojnë qeliza seksuale femërore (vezë). Vezët e formuara më vonë në këto gjëndra, kalojnë në kanalet e vezëve e pastaj zbresin në mitër, që është organ karakteristik për gjitarët. Zhvillimi i embrionit te ky grup i shtazëve është i brendshëm dhe zhvillohet brenda trupit të nënës. Kur embrioni arrin zhvillimin e plotë, ai lind.

VLERËSIMI I NXËNËSVE

Vlerësimi me gojë (diskutime, debate, prezantime).

DETYRAT DHE PUNA E PAVARUR

REFLEKTIM PËR RRJEDHËN E ORËS MËSIMORE

PLANIFIKIMI I ORËS MËSIMORE

ASPEKTET E PËRGJITHSHME TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE

Fusha kurrikulare: Shkencat e natyrës Lënda: biologji Shkalla e kurrikulës: IV
Klasa: VIII

Tema (nga plani dymujor):

Indet, organet dhe sistemet e organeve te bimët

Rezultati i të nxënit të temës (nga plani dymujor):

*Hulumton dhe përshkruan ndërtimin dhe funksionin e indeve dhe organeve bimore;
Përshkruan veçoritë themelore të bimëve duke u bazuar në ndërtimin e indeve dhe organeve;
eEmërton dhe dallon indet dhe organet e specializuara të bimëve.*

Rezultatet e të nxënit për kompetencat kryesore të shkallës (të synuara):

1. Transmeton saktë të dhënat e mbledhura për një temë konkrete, në formë tekstuale, numerike, verbale, elektronike apo në ndonjë formë tjetër të të shprehurit.

6. Analizon përmbajtjen dhe kuptimin e nocioneve (koncepteve) të reja, duke përdorur leksikon adekuat, të përshtatshëm dhe të saktë dhe i bën ato pjesë të dosjes mësimore.

Rezultatet e fushës së kurrikulës (të synuara):

Dallon dhe krahason ndërtimin dhe funksionin e qelizës, indeve, organeve dhe sistemeve të organeve, duke iu referuar biodiversitetit të qenieve të gjalla, si dhe dallon dhe krahason shkaktarët e sëmundjeve te njeriu, shtazët, bimët dhe mënyrat e kontrollit të tyre, metabolizmin, zhvillimin individual të njeriut dhe evolucionin e qenieve të gjalla.

Shpjegon rolin e karbohidrateve, mineraleve, lipideve, proteinave, vitaminave, ujit dhe fibrave për dietë të shëndetshme dhe llogarit nevojën ditore për energji nga ushqimet e konsumuara.

ASPEKTET SPECIFIKE TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE

Njësia mësimore: **Indet e bimëve**

Fjalët kyçe: meristematike, inde përfundimtare, sytha, rrënja, kërcelli, kambiumi, floema, ksilema.

Rezultati/et e të nxënit për orë mësimore:

*Shpjegon rolin e indeve krijuese të bimëve;
Përshkruan rolin e indit mekanik;*

Numëron rëndësitë biologjike, ekonomike dhe mjekësore të indit sekretues.

Kriteret e suksesit:

Emërto indet krijuese të bimëve;

Vlerëso rolin e indit mekanik;

Komento rëndësinë biologjike, ekonomike dhe mjekësore të indit sekretues.

Burimet, mjetet e konkretizimit dhe materialet mësimore: Libri *Biologjia 8*, laptop, projektor, video.

Lidhja me lëndët e tjera mësimore dhe/apo me çështjet ndërkurrikulare dhe situatat jetësore: *Gjuhë dhe komunikim, kimi, gjeografi, ekologjia dhe mjedisi, TIK.*

PËRSHKRIMI I METODOLOGJISË DHE VEPRIMTARITË E PUNËS ME NXËNËS GJATË ORËS MËSIMORE

IMAGJINATË E DREJTUAR

Gjatë kësaj faze, mësimitdhënësi/ja u kërkon nxënësve të shikojnë në ekran një video, në të cilën bëhet fjalë për indet bimore, ndërtimin dhe rolin e tyre. U kërkon nxënësve që ta përcjellin me vëmendje videon dhe, pasi e kanë këqyrur, fillon diskutimin duke i pyetur se çfarë kanë parë në video, çfarë është e veçanta e videos etj.


<https://www.youtube.com/watch?v=JsJUz4JsOEI>

LEKSION I AVANCUAR

Mësimitdhënësi/ja u shpjegon nxënësve në pika të shkurta se bimët janë të ndërtuara nga qelizat e ndryshme të specializuara, të grupuara në inde. Indet e bimëve ndahen në dy grupe: inde krijuese - meristemmatike dhe inde përfundimtare. Indi krijues gjendet në majë të bisqeve të kërcejve (në sytha) dhe në majë të rrënjëve, i cili rrit bimën në gjatësi gjatë gjithë jetës, sepse ky ind vazhdimisht krijon qeliza për formimin e indeve të tjera. Indi krijues gjendet edhe në kërcell dhe në rrënjë, në formë unaze (kambiumi), i cili krijon qeliza për rritjen e bimës në trashësi. Kurse indet e përfundimtare përbëhen nga qelizat bimore që nuk ndahen më në mënyrë aktive. Indet përfundimtare janë: indi mbrojtës, indi themelor (parenkimor), indi mbështetës (mekanik), indi përçues, indi sekretor (pronditës). Pastaj u kërkon ta hapin librin dhe ta lexojnë në heshtje njësinë mësimore.

KLLASTER

Pasi nxënësit ta kenë lexuar njësinë mësimore, mësimitdhënësi/ja i fton ata të punojnë një kllaster në formë të përmbledhjes, fillimisht punojnë në grupe. Pastaj mësimitdhënësi/ja i fton ata që të njëjtin ta punojnë edhe në tabelë, duke bashkëpunuar njëri me tjetrin.



VLERËSIMI I NXËNËSVE

Vlerësim për nxënie (informatë kthyesë, vlerësim i ndërsjellë).

DETYRAT DHE PUNA E PAVARUR

REFLEKTIM PËR RRJEDHËN E ORËS MËSIMORE

PLANIFIKIMI I ORËS MËSIMORE

ASPEKTET E PËRGJITHSHME TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE		
Fusha kurrikulare: Shkencat e natyrës	Lënda: biologji	Shkalla e kurrikulës: IV
Klasa: VIII		
Tema (nga plani dymujor): Indet, organet dhe sistemet e organeve te bimët	Rezultati i të nxënit të temës (nga plani dymujor): <i>Përshkruan veçoritë themelore të bimëve duke u bazuar në ndërtimin e indeve dhe organeve.</i> <i>Emërton dhe dallon indet dhe organet e specializuara të bimëve.</i> <i>Përshkruan strukturat që mundësojnë transportin e materieve te bimët vaskulare (enëzore).</i> <i>Përshkruan ndërlidhjen e ndërtimit dhe të funksionit ndërmjet organeve të ndryshme bimore.</i> <i>Shpjegon çka do të ndodhë kur një organ bimor nuk funksionon.</i>	
Rezultatet e të nxënit për kompetencat kryesore të shkallës (të synuara): <p>I 6. <i>Analizon përmbajtjen dhe kuptimin e nocioneve (koncepteve) të reja, duke përdorur leksikun adekuat, të përshtatshëm dhe të saktë dhe i bën ato pjesë të dosjes mësimore.</i></p> <p>II 7. <i>Interpreton me fjalë, me shkrim/me gojë një rregull, koncept apo proces të caktuar duke e ilustruar atë me shembuj konkretë nga situata të jetës së përditshme.</i></p> <p>III 7. <i>Shfrytëzon në mënyrë të efektshme teknika të ndryshme gjatë të nxënit të temës së dhënë duke veçuar informatat që i kupton nga informatat e reja, të panjohura, si dhe informatat që për të mbeten ende të paqarta.</i></p>		
Rezultatet e fushës së kurrikulës (të synuara): <i>Dallon dhe krahason ndërtimin dhe funksionin e qelizës, indeve, organeve dhe sistemeve të organeve, duke iu referuar biodiversitetit të qenieve të gjalla, si dhe dallon dhe krahason shkaktarët e sëmundjeve te njeriu, shtazët, bimët dhe mënyrat e kontrollit të tyre, metabolizmin, zhvillimin individual të njeriut dhe evolucionin e qenieve të gjalla. Shpjegon rolin e karbohidrateve, mineraleve, lipideve, proteinave, vitaminave, ujit dhe fibrave për dietë të shëndetshme dhe llogarit nevojën ditore për energji nga ushqimet e konsumuara.</i>		
ASPEKTET SPECIFIKE TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE		
Njësia mësimore: ORGANET DHE SISTEMET E ORGANEVE TË BIMËVE		
Fjalët kyçe: <i>gjethi, lulja, fara, fruti, kërcelli, rrënja, myshqe, fierna, farëveshura, farëzhveshura.</i>		
Rezultati/et e të nxënit për orë mësimore: <i>Shpjegon rolin e organeve bimore;</i> <i>Përshkruan sistemet e organeve të bimëve.</i>		
Kriteret e suksesit:		

*Numëro organet bimore;
Vlerëso rolin e organeve bimore.*

Burimet, mjetet e konkretizimit dhe materialet mësimore: Libri *Biologjia 8*, laptop, projektor, video, modele të organeve bimore.

Lidhja me lëndët e tjera mësimore dhe/apo me çështjet ndërkurrikulare dhe situatat jetësore: *Gjuhë dhe komunikim, kimi, gjeografi, ekologjia dhe mjedisi, TIK.*

PËRSHKRIMI I METODOLOGJISË DHE VEPRIMTARITË E PUNËS ME NXËNËS GJATË ORËS MËSIMORE

IMAGJINATË E DREJTUAR

Gjatë kësaj faze, mësimdhënësi/ja u kërkon nxënësve të shikojnë në ekran një video, në të cilën bëhet fjalë për organet bimore, ndërtimin dhe rolin e tyre. U kërkon nxënësve që të përcjellin me vëmendje videon dhe, pasi e kanë këqyrur, fillon diskutimin se çfarë kanë parë në video, çfarë është e veçanta e videos etj.

https://www.youtube.com/watch?v=qEfr1_ZNkGE

<https://www.youtube.com/watch?v=QZ94xoy1bJk>

<https://www.youtube.com/watch?v=EoC17n73ygM>

<https://www.youtube.com/watch?v=OkIluHLMeko>

LEKSION I AVANCUAR

Mësimdhënësi/ja u shpjegon nxënësve në pika të shkurta se bimët enëzore kanë gjithsej gjashtë organe, tri vegjetative (gjethi, kërcelli, rrënja) dhe tri riprodhuese (lulja, fara, fruta). Gjethi, kërcelli dhe rrënja formojnë sistemin vegjetativ, ndërsa lulja, fara dhe fruta formojnë sistemin riprodhues. Të dyja këto sisteme formojnë trupin e bimës. Trupi i bimës dallohet me pjesën nëntokësore, që e përbën rrënja dhe pjesën mbitokësore, që e përbëjnë: kërcelli, gjethet, lulet, farat dhe frutat. Gjatë shpjegimit, përdor mjete demonstruese, si lulet, gjethet, farat, frutat e kërcellin. (Nëse është e mundur, mjetet demonstruese të jenë të freskëta, nëse nuk është e mundur, mund të përdoren modele apo edhe fotografi).

TABELA E KONCEPTEVE

Pasi nxënësit e kanë përcjellë me vëmendje shpjegimin e mësimdhënësit/es dhe kanë lexuar njësinë mësimore në pjesë, ata udhëzohen nga mësimdhënësi/ja që ta plotësojnë tabelën e koncepteve, në bashkëpunim me grupin si më poshtë:

(Shembull si mund të plotësohet një tabelë e koncepteve)

Konceptet	Shpjegimet
Gjethi	<i>Përbën organin kryesor të bimës, sepse aty ndodh fenomeni më i rëndësishëm në natyrë - fotosinteza. Procesi i fotosintezës mundëson krijimin e ushqimit për vetë bimën, e cila pastaj si hallkë e parë e zingjirit ushqimor, në mënyrë të drejtpërdrejtë ose jo të drejtpërdrejtë, shërben për ushqimin e të gjitha gjallesave të tjera.</i>
Kërçelli	<i>Mund të ketë gjatësi nga disa milimetra deri në dhjetëra metra dhe, gjithashtu, të ndryshojnë në diametër, në varësi të llojit të bimës. Kërcejtë mund të jenë barishtorë dhe drunorë. Kërcejtë barishtorë zakonisht janë të butë dhe të gjelbër, si kërçelli i një zambaku, ndërsa drurët dhe shkurret kanë kërcej drunorë të fortë, si p.sh., kërçelli drunor i ahut ose ai shkurre i trëndafil të egër. Kërçelli shërben për mbajtjen e pjesëve të tjera të bimës, si: degët, sythat, gjethet, lulet, frutat dhe farat.</i>
Rrënja	<i>Ka role të shumta në bimë, ajo është e specializuar që ta përforcojë bimën për tokë, me anën e qimeve thithëse që ka, thith ujin dhe lëndët minerale (azotin, fosforin, kaliumin etj.) nga toka dhe i përcjell në pjesët e tjera të bimës me anën e indit përçues. Forca lëvizëse, që shkakton përthithjen e ujit nga rrënja dhe bartjen e lëndëve minerale, është ndryshimi i përqendrimit të lëngut qelizor që quhet osmozë.</i>
Lulja	<i>Përbën organin e riprodhimit seksual, në të cilin prodhohet pjalmi - qelizat seksuale (spermatozoidet) ose vezët.</i>
Sistemet e organeve bimore	<i>Sistemi vegjetativ dhe sistemi riprodhues.</i>

VLERËSIMI I NXËNËSVE

Vlerësim për nxënie (informatë kthyesë, vlerësim i ndërsjellë).

DETYRAT DHE PUNA E PAVARUR

REFLEKTIM PËR RRJEDHËN E ORËS MËSIMORE

PLANIFIKIMI I ORËS MËSIMORE

ASPEKTET E PËRGJITHSHME TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE	
Fusha kurrikulare: Shkencat e natyrës Lënda: biologji Shkalla e kurrikulës: IV Klasa: VIII	
Tema (nga plani dymujor): Indet, organet dhe sistemet e organeve të bimëve	Rezultati i të nxënit të temës (nga plani dymujor): <i>Shpjegon pse fiernat u përkasin bimëve.</i>
Rezultatet e të nxënit për kompetencat kryesore të shkallës (të synuara):	
<p>II 2. Përzgjedh informata nga burime të ndryshme, për një temë konkrete, i klasifikon ato në bazë të një kriteri të caktuar dhe i përdor ato për marrjen e një vendimi apo për zgjidhjen e një problemi/detyre.</p> <p>III 6. Ndjek në mënyrë të pavarur udhëzimet apo skicat e dhëna në libër, skicë, plan, partiturë muzikore, skenar, koreografi etj., ose të ndonjë burimi tjetër, për të performuar një veprim, aktivitet ose detyrë që kërkohet prej tij/saj.</p> <p>IV 1. Vlerëson rëndësinë e punës individuale dhe në grupe për zhvillimin e komunitetit duke paraqitur, në formë të ndryshme të të shprehurit, shembuj konkretë nga jeta e përditshme.</p>	
Rezultatet e fushës së kurrikulës (të synuara):	
<p><i>Dallon dhe krahason ndërtimin dhe funksionin e qelizës, indeve, organeve dhe sistemeve të organeve, duke iu referuar biodiversitetit të qenieve të gjalla, shkaktarët e sëmundjeve të njeriut, shtazët, bimët dhe mënyrat e kontrollit të tyre, metabolizmin, zhvillimin individual të njeriut dhe evolucionin e qenieve të gjalla. Shpjegon rolin e karbohidrateve, mineraleve, lipideve, proteinave, vitaminave, ujit dhe fibrave për dietë të shëndetshme dhe llogarit nevojën ditore për energji nga ushqimet e konsumuara.</i></p>	
ASPEKTET SPECIFIKE TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE	
Njësia mësimore: Bimët joenëzore dhe bimët enëzore pa fara	
Fjalët kyçe: <i>myshqet, hepatike, rizoidet, protonemë, spore.</i>	
Rezultati/et e të nxënit për orë mësimore:	
<p><i>Shpjegon si e përcjellin ujin me lëndë ushqyese myshqet dhe fiernat;</i> <i>Sqaron shumimin e fiernave;</i> <i>Vlerëson rolin e myshqeve.</i></p>	
Kriteret e suksesit:	
<p><i>Vlerëso rolin e rizoideve;</i> <i>Detajo rrugën e shumimit të fiernave.</i></p>	
Burimet, mjetet e konkretizimit dhe materialet mësimore: <i>Libri “Biologjia 8”, laptop, projektor.</i>	

Lidhja me lëndët e tjera mësimore dhe/apo me çështjet ndërkurrikulare dhe situatat jetësore: *Gjuhë dhe komunikim, kimi, gjeografi, ekologjia dhe mjedisi.*

PËRSHKRIMI I METODOLOGJISË DHE VEPRIMTARITË E PUNËS ME NXËNËS GJATË ORËS MËSIMORE

IMAGJINATË E DREJTUAR-

Gjatë kësaj faze, mësimmhënësi/ja u kërkon nxënësve të shikojnë në ekran një video, në të cilën bëhet fjalë për myshqet, mënyrën e jetesës së myshqeve, përhapjen të ushqyerit etj. U kërkon nxënësve që të përcjellin me vëmendje videon dhe, pasi e kanë përcjellë, fillon diskutimin se çfarë kanë parë në video, çfarë është e veçanta e videos etj.

[https://www.youtube.com/watch?v=mY0PydNqYHI,](https://www.youtube.com/watch?v=mY0PydNqYHI)

<https://www.youtube.com/watch?v=JBISTZedBE>

TABELA E KONCEPTEVE

Pasi nxënësit e kanë përcjellë videon, mësimmhënësi/ja i udhëzon ata që ta lexojnë njësinë mësimore dhe pastaj ta plotësojnë tabelën e koncepteve në bashkëpunim me shokun/shoqen e bankës:

Konceptet	Shpjegimi
Veçoritë e myshqeve	
Veçoritë e fiernave	
Rëndësia e myshqeve dhe fiernave	

(Shembulli si mund të jetë një tabelë)

RRJETI I DISKUTIMIT

Pasi nxënësit ta kenë plotësuar tabelën e koncepteve, mësimmhënësi/ja i fton për diskutim lidhur me sqarimet e koncepteve. Ftohen nxënësit që të prezantojnë para të tjerëve sqarimet e koncepteve për temën e dhënë, të përgatitur në bashkëpunim me shokun apo shoqen e bankës, duke gërshetuar format e komunikimit.

VLERËSIMI I NXËNËSVE

Vlerësim për nxënie (informatë kthyese, vlerësim i ndërsjellë).

DETYRAT DHE PUNA E PAVARUR

REFLEKTIM PËR RRJEDHËN E ORËS MËSIMORE

PLANIFIKIMI I ORËS MËSIMORE

ASPEKTET E PËRGJITHSHME TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE	
Fusha kurrikulare: Shkencat e natyrës Lënda: biologji Shkalla e kurrikulës: IV Klasa: VIII	
Tema (nga plani dymujor): Indet, organet dhe sistemet e organeve të bimëve	Rezultati i të nxënit të temës (nga plani dymujor): <i>Përshkruan sistemin e organeve reprodutive të bimët. Identifikon dallimet thelbësore sa i përket ndërtimit të lules së bimëve farëzhveshura dhe farëveshura.</i>
Rezultatet e të nxënit për kompetencat kryesore të shkallës (të synuara): I 6. <i>Analizon përmbajtjen dhe kuptimin e nocioneve (koncepteve) të reja, duke përdorur leksikun adekuat, të përshtatshëm dhe të saktë dhe i bën ato pjesë të dosjes mësimore.</i> II 2. <i>Përzgjedh informata nga burime të ndryshme, për një temë konkrete, i klasifikon ato në bazë të një kriteri të caktuar dhe i përdor ato për marrjen e një vendimi apo për zgjidhjen e një problemi/detyre.</i> II 8. <i>Identifikon me anë të krahasimit dallimet dhe ngjashmëritë midis ligjeve dhe dukurive që ndodhin në natyrë me ato në shoqëri, duke vënë në dukje lidhjen shkak-pasojë midis këtyre dukurive.</i>	
Rezultatet e fushës së kurrikulës (të synuara): <i>Dallon dhe krahason ndërtimin dhe funksionin e qelizës, indeve, organeve dhe sistemeve të organeve, duke iu referuar biodiversitetit të qenieve të gjalla, shkaktarët e sëmundjeve të njeriut, shtazët, bimët dhe mënyrat e kontrollit të tyre, metabolizmin, zhvillimin individual të njeriut dhe evolucionin e qenieve të gjalla. Shpjegon rolin e karbohidrateve, mineraleve, lipideve, proteinave, vitaminave, ujit dhe fibrave për dietë të shëndetshme dhe llogarit nevojën ditore për energji nga ushqimet e konsumuara.</i>	
ASPEKTET SPECIFIKE TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE	
Njësia mësimore: Bimët me farë të zhveshur	
Fjalët kyçe: <i>boça, ovula, bredhi, hormoqi, dëllinja, trakeide.</i>	
Rezultati/et e të nxënit për orë mësimore: <i>Shpjegon karakteristikat e bimëve me farë të zhveshur; Përshkruan mënyrën e riprodhimit; Sqaron disa llojet të bimëve me farë të zhveshur (përhapjen, shumimin etj.).</i>	
Kriteret e suksesit: <i>Aryeto pse quhen bimë me farë të zhveshur; Veço rolin e erës gjatë riprodhimit të bimëve me farë të zhveshur; Numëro të paktën pesë lloje bimore me farë të zhveshur.</i>	
Burimet, mjetet e konkretizimit dhe materialet mësimore: <i>Libri “Biologjia 8”, laptop, projektor, video, hala, boça, copa të kërcellit.</i>	

Lidhja me lëndët e tjera mësimore dhe/apo me çështjet ndërkurrikulare dhe situatat jetësore: *Gjuhë dhe komunikim, kimi, gjeografi, ekologjia dhe mjedisi, TIK.*

PËRSHKRIMI I METODOLOGJISË DHE VEPRIMTARITË E PUNËS ME NXËNËS GJATË ORËS MËSIMORE

IMAGJINATË E DREJTUAR

Gjatë kësaj faze, mësimmhdhënësi/ja u kërkon nxënësve të shikojnë në ekran një video, në të cilën bëhet fjalë për bimët me farë të zhveshur, përhapjen të ushqyerit etj. U kërkon nxënësve që të përcjellin me vëmendje videon dhe, pasi e kanë përcjellë, fillon diskutimin se çfarë kanë parë në video, çfarë është e veçanta e videos etj.

<https://www.youtube.com/watch?v=0Zd4p0NQ6CM>

DRTA

Në vijim, mësimmhdhënësi/ja u shpjegon nxënësve procedurën, e cila do të zhvillohet si më poshtë:

Hapet teksti në temën mësimore “BIMËT ME FARA” dhe u kërkon nxënësve që të lexojnë dhe, më pas, t’i mbyllin librat dhe ta komentojnë atë që lexuan. Kështu veprohet edhe me pjesën tjetër “BIMËT ME FARË TË ZHVESHUR”, pastaj mbyllin librat dhe fillojnë komentimin. Vazhdojnë me pjesën “Halorët” dhe komentojnë çfarë kanë lexuar. Kështu veprohet edhe me pjesën tjetër: “Riprodhimi te bimët me farë të zhveshur”, pastaj mbyllin librat dhe fillojnë komentimin. Dhe në fund, pjesa e fundit “Çfarë përhapje kanë llojet e bimëve me farë të zhveshur”, “Cila është rëndësia e farëzhveshurave”. Dhe fillon komentimi pas pjesës së lexuar. (Gjatë komentimit të pjesëve të lexuara, mësimmhdhënësi përdor mjete të konkretizimit: boça, copa të kërcellit, halat etj.)

KLLASTER

Pasi nxënësit kanë lexuar dhe komentuar njësinë mësimore, mësimmhdhënësi/ja i fton ata të punojnë një kllaster në formë të përmbledhjes, fillimisht punojnë në grupe. Pastaj mësimmhdhënësi/ja i fton ata që të njëjtin ta punojnë edhe në tabelë, duke bashkëpunuar njëri me tjetrin.

VLERËSIMI I NXËNËSVE

Vlerësim për nxënie (informatë kthyese, vlerësim i ndërsjellë).

DETYRAT DHE PUNA E PAVARUR

Hulumtim “BIMËT ME FARË TË ZHVESHUR”

REFLEKTIM PËR RRJEDHËN E ORËS MËSIMORE

PLANIFIKIMI I ORËS MËSIMORE

ASPEKTET E PËRGJITHSHME TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE	
Fusha kurrikulare: Shkencat e natyrës Lënda: biologji Shkalla e kurrikulës: IV Klasa: VIII	
Tema (nga plani dymujor): Indet, organet dhe sistemet e organeve të bimëve	Rezultati i të nxënit të temës (nga plani dymujor): <i>Analizon dallimet bazë mes bimve monokotiledone dhe dikotiledone.</i> <i>Krahason ndërtimin e organeve vegjetative (p.sh., kërcellit) të bimëve njëthelbore dhe dythelbore.</i>
Rezultatet e të nxënit për kompetencat kryesore të shkallës (të synuara): <p>II 2. Përzgjedh informata nga burime të ndryshme, për një temë konkrete, i klasifikon ato në bazë të një kriteri të caktuar dhe i përdor ato për marrjen e një vendimi apo për zgjidhjen e një problemi/detyre.</p> <p>II 7. Interpreton me fjalë, me shkrim/me gojë një rregull, koncept apo proces të caktuar, duke e ilustruar atë me shembuj konkretë nga situata të jetës së përditshme.</p> <p>III 8. Zbaton elementet e dosjes personale për identifikimin e anëve të veta të forta, i shfrytëzon ato për orientim në profesionin e ardhshëm, si dhe për vetëvlerësimin e përparimit, qoftë përmirësimin apo ngecjen në fusha të ndryshme mësimore.</p>	
Rezultatet e fushës së kurrikulës (të synuara): <p><i>Dallon dhe krahason ndërtimin dhe funksionin e qelizës, indeve, organeve dhe sistemeve të organeve, duken iu referuar biodiversitetit të qenieve të gjalla, shkaktarët e sëmundjeve të njeriut, shtazët, bimët dhe mënyrat e kontrollit të tyre, metabolizmin, zhvillimin individual të njeriut dhe evolucionin e qenieve të gjalla.</i> <i>Shpjegon rolin e karbohidrateve, mineraleve, lipideve, proteinave, vitaminave, ujit dhe fibrave për dietë të shëndetshme dhe llogarit nevojën ditore për energji nga ushqimet e konsumuara.</i></p>	
ASPEKTET SPECIFIKE TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE	
Njësia mësimore: Bimët me farë të veshur	
Fjalët kyçe: angjospermat, barishtore, shkurre, drunore, ksilema.	
Rezultati/et e të nxënit për orë mësimore: <i>Dallon bimët drunore nga barishtoret dhe shkurret;</i> <i>Përshkruan dallimin në mes të bimëve barishtore njëvjeçare, dyvjeçare dhe shumëvjeçare;</i> <i>Sqaron shumimin e bimëve me farë të veshur.</i>	
Kriteret e suksesit: <i>Krahaso bimët drunore-shkurre e barishtore;</i> <i>Numëro llojet e bimëve barishtore;</i> <i>Trego rëndësinë ekonomike të bimëve me farë.</i>	

Burimet, mjetet e konkretizimit dhe materialet mësimore: *Libri Biologjia 8, laptop, projektor, video, kokrra gruri, thekre ose misri, rrepë, karotë, kumbull.*

Lidhja me lëndët e tjera mësimore dhe/apo me çështjet ndërkurrikulare dhe situatat jetësore: *Gjuhë dhe komunikim, kimi, gjeografi, ekologjia dhe mjedisi, TIK.*

PËRSHKRIMI I METODOLOGJISË DHE VEPRIMTARITË E PUNËS ME NXËNËS GJATË ORËS MËSIMORE

IMAGJINATË E DREJTUAR

Gjatë kësaj faze, mësimdhënësi/ja u kërkon nxënësve të shikojnë në ekran një video, në të cilën bëhet fjalë për bimët me farë të veshur, përhapjen të ushqyerit etj. U kërkon nxënësve që të përcjellin me vëmendje videon dhe, pasi e kanë përcjellë, fillon diskutimin se çfarë kanë parë në video, çfarë është e veçanta e videos etj. Duke ditur që nxënësit kishin hulumtuar paraprakisht për bimët me farë të veshur, diskutimi do të jetë më i produktiv.

<https://www.youtube.com/watch?v=M0-V1V086OQ>

LEKSION I AVANCUAR

Mësimdhënësi/ja u shpjegon nxënësve në pika të shkurta se shumica e bimëve me fara në Tokë janë bimë me farë të veshur. Të gjitha bimët me farë të veshur kanë lule. Këto bimë dallohen si barishtore, drunore dhe shkurre. Gjithashtu, dallohen si njëvjeçare, dyvjeçare dhe shumëvjeçare. Bimët barishtore mund të jenë njëvjeçare, dyvjeçare dhe shumëvjeçare. Kërçelli i tyre është i butë, i gjelbër dhe pa kambium. Kërçelli i shumë bimëve të drithërave quhet kashtë, pasi palca është shkatërruar dhe kërçelli është i zbrazët.

Bimë barishtore njëvjeçare. Cikli jetësor i këtyre bimëve përfundon brenda një viti. Në fund të periudhës vegetative thahen plotësisht. Këto bimë duhet të rriten nga farat çdo vit. Hyjnë shumë bimë të egra dhe të kultivuara, si: gruri, thekra, misri, elbi.

Bimë dyvjeçare. Cikli jetësor i tyre kryhet brenda dy vjetësh, në vitin e parë të jetës zhvillojnë rrënjën, kërçellin dhe gjethet, ndërsa në pjesët nëntokësore (rrënjë, rizomë) grumbullohen lëndë ushqyese rezervë, p.sh., rrepa, karota, panxhari. Në pranverën e vitit të dytë, këto bimë prodhojnë lule dhe fara, pastaj thahen plotësisht.

Bimë shumëvjeçare. Pjesët mbitokësore të bimëve barishtore thahen çdo dimër, por ripërtërihen dhe prodhojnë lule çdo pranverë. Bimët, si drurët frutorë, prodhojnë lule dhe fruta në kërçell që mbijetojnë për shumë vjet. Këto bimë riprodhohen në mënyrë joseksuale dhe seksuale. Janë bimët më të përhapura në rruzullin tokësor.

(Nëse është e mundur, gjatë leksionit mësimdhënësi të përdorë mjetet demonstruese si kokrra gruri, thekre ose misri, rrep, karotë, kumbull, nëse nuk është e mundur, mund të përdoren modele apo edhe fotografi.) Dhe në fund, udhëzohen nxënësit të lexojnë njësinë mësimore në heshtje.

RRJETI I DISKUTIMIT

Pasi nxënësit ta kenë lexuar njësinë mësimore, mësimdhënësi/ja fton nxënësit për diskutim. Mund të shërbejnë pyetjet nga libri si orientim për diskutim.

1. Pse quhen bimë me farë të veshur?
2. Përshkruaj bimët barishtore, drunore dhe shkurre.
3. Emërto dy grupet e bimëve me farë të veshur dhe krahaso ndërtimin e tyre.
4. Përmend mënyrat e riprodhimit të bimëve me farë të veshur dhe shpjego si zhvillohen ato.
5. Ç'është pjalmimi?
6. Përshkruaj ciklin jetësor të bimëve me farë.
7. Mendo në mënyrë kritike: shikojeni një bimë që ju pëlqen dhe doni ta rritni një të njëjtë. Çfarë lloj riprodhimi bimësh do të përdorni? Pse?
8. Trego rëndësinë ekonomike të bimëve me farë.

VLERËSIMI I NXËNËSVE

Vlerësim për nxënie (informatë kthyesë, vlerësim i ndërsjellë).

DETYRAT DHE PUNA E PAVARUR

Hulumtim: "Si formohen farat dhe frutat?"

REFLEKTIM PËR RRJEDHËN E ORËS MËSIMORE

PLANIFIKIMI I ORËS MËSIMORE

ASPEKTET E PËRGJITHSHME TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE	
Fusha kurrikulare: Shkencat e natyrës Klasa: VIII	Lënda: biologji Shkalla e kurrikulës: IV
Tema (nga plani dymujor): Indet, organet dhe sistemet e organeve të bimëve	Rezultati i të nxënit të temës (nga plani dymujor): <i>Definon dhe shpjegon termat polenizim dhe frytnim Shpjegon si formohet fryti dhe fara dhe dallon llojet e fryteve e farave. Shpjegon rëndësinë e frytnimit artificial për fisnikërimin e bimëve.</i>
Rezultatet e të nxënit për kompetencat kryesore të shkallës (të synuara):	
<p>II 2. Përzgjedh informata nga burime të ndryshme, për një temë konkrete, i klasifikon ato në bazë të një kriteri të caktuar dhe i përdor ato për marrjen e një vendimi apo për zgjidhjen e një problemi/detyre.</p> <p>II 7. Interpreton me fjalë, me shkrim/me gojë një rregull, koncept apo proces të caktuar, duke e ilustruar atë me shembuj konkretë nga situata të jetës së përditshme.</p> <p>V 1. Vlerëson përmbajtjen dhe vlerat ushqyese të llojeve të ushqimeve, të cilat njeriu i konsumon, duke i kategorizuar ato në bazë të nevojave të individit për to në situata të ndryshme, si: gjatë stinëve, sëmundjeve etj.</p>	
Rezultatet e fushës së kurrikulës (të synuara):	
<p><i>Dallon dhe krahason ndërtimin dhe funksionin e qelizës, indeve, organeve dhe sistemeve të organeve, duke iu referuar biodiversitetit të qenieve të gjalla, shkaktarët e sëmundjeve të njeriu, shtazët, bimët dhe mënyrat e kontrollit të tyre, metabolizmin, zhvillimin individual të njeriut dhe evolucionin e qenieve të gjalla.</i></p> <p style="text-align: right;"><i>Shpjegon rolin e karbohidrateve, mineraleve, lipideve, proteinave, vitaminave, ujit dhe fibrave për dietë të shëndetshme dhe llogarit nevojën ditore për energji nga ushqimet e konsumuara.</i></p>	
ASPEKTET SPECIFIKE TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE	
Njësia mësimore: Si formohen farat dhe frutat	
Fjalët kyçe: <i>farë, frutë, avokado, mango, kivi, lule, thelba, ovula.</i>	
Rezultati/et e të nxënit për orë mësimore:	
<i>Përshkruan formimin e farave dhe të frutave; Tregon rëndësinë e frutave dhe të farave.</i>	
Kriteret e suksesit:	
<i>Trego si krijohet fruta; Përmend disa nga frutat më të përdorshme për nevojat ushqyese.</i>	

Burimet, mjetet e konkretizimit dhe materialet mësimore: *Libri Biologjia 8, laptop, projektor, video, avokado, mango, kivi.*

Lidhja me lëndët e tjera mësimore dhe/apo me çështjet ndërkurrikulare dhe situatat jetësore: *Gjuhë dhe komunikim, kimi, gjeografi, ekologjia dhe mjedisi, TIK.*

PËRSHKRIMI I METODOLOGJISË DHE VEPRIMTARITË E PUNËS ME NXËNËS GJATË ORËS MËSIMORE

IMAGJINATË E DREJTUAR

Gjatë kësaj faze, mësimdhënësi/ja u kërkon nxënësve të shikojnë në ekran një video, në të cilën bëhet fjalë për mënyrën e krijimit të farës dhe fruta. U kërkon nxënësve që të përcjellin me vëmendje videon dhe, pasi e kanë përcjellë, fillon diskutimin se çfarë kanë parë në video, çfarë është e veçanta e videos etj. Duke ditur që nxënësit kishin hulumtuar paraprakisht për mënyrën e krijimit të farës dhe frutës, diskutimi do të jetë më i produktiv.

https://www.youtube.com/watch?v=_HPGoyJLIfo

INSERT

Në këtë fazë, bëhet leximi i pjesës, duke vendosur shenjat , =, -, ?. Shenja vendoset për atë pjesë që nxënësit dinë, shenja + për pjesën që është shtuar e re, shenja – për pjesën që nuk e dinë, dhe shenja ? për pjesën që nuk kuptojnë. (Pas përfundimit të tabelës, mësimdhënësi shfaq para nxënësve disa fruta: avokado, mango, kivi, duke u dhënë sqarime përkatëse.)

<input checked="" type="checkbox"/>	+	-	?

KLLASTER

Pasi nxënësit e kanë lexuar dhe komentuar njësinë mësimore, mësimdhënësi/ja i fton ata të punojnë një kllaster në formë të përmbledhjes, fillimisht punojnë në grupe. Pastaj mësimdhënësi/ja i fton ata që të njëjtin ta punojnë edhe në tabelë, duke bashkëpunuar njëri me tjetrin.

VLERËSIMI I NXËNËSVE

Vlerësim për nxënie (informatë kthyesë, vlerësim i ndërsjellë).

DETYRAT DHE PUNA E PAVARUR

Hulumtim: “Ushqimi dhe shëndeti i njeriut”

REFLEKTIM PËR RRJEDHËN E ORËS MËSIMORE

PLANIFIKIMI I ORËS MËSIMORE

ASPEKTET E PËRGJITHSHME TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE		
Fusha kurrikulare: Shkencat e natyrës	Lënda: biologji	Shkalla e kurrikulës: IV
Klasa: VIII		
Tema (nga plani dymujor): Ushqimet e njeriut	Rezultati i të nxënit të temës (nga plani dymujor): <i>Emërton disa lloje bimore sipas vlerave përdoruese: ushqim, mjekësi, ekonomi etj.</i> <i>Shpjegon rolin dhe rëndësinë e përbërësve të ushqimit.</i> <i>Emërton lloje të vitaminave dhe identifikon ushqime më përbërje vitaminoze.</i>	
Rezultatet e të nxënit për kompetencat kryesore të shkallës (të synuara): <p>III 6. <i>Ndjek në mënyrë të pavarur udhëzimet apo skicat e dhëna në libër, skicë, plan, partiturë muzikore, skenar, koreografi etj., ose të ndonjë burimi tjetër, për të performuar një veprim, aktivitet ose detyrë që kërkohet prej tij/saj.</i></p> <p>V 1. <i>Vlerëson përmbajtjen dhe vlerat ushqyese të llojeve të ushqimeve, të cilat njeriu i konsumon, duke i kategorizuar ato në bazë të nevojave të individit për to në situata të ndryshme, si: gjatë stinëve, sëmundjeve etj.</i></p> <p>V 2. <i>Argumenton nevojën e respektimit të regjimit për ushqyerje të shëndetshme dhe rekreacion ditor, javor apo mujor, sipas udhëzimeve të lexuara ose të dëgjuara nga mjeku, gjatë një diskutimi në klasë, në shkollë apo në familje.</i></p>		
Rezultatet e fushës së kurrikulës (të synuara): <i>Dallon dhe krahason ndërtimin dhe funksionin e qelizës, indeve, organeve dhe sistemeve të organeve, duke iu referuar biodiversitetit të qenieve të gjalla, shkaktarët e sëmundjeve të njeriut, shtazët, bimët dhe mënyrat e kontrollit të tyre, metabolizmin, zhvillimin individual të njeriut dhe evolucionin e qenieve të gjalla.</i> <i>Shpjegon rolin e karbohidrateve, mineraleve, lipideve, proteinave, vitaminave, ujit dhe fibrave për dietë të shëndetshme dhe llogarit nevojën ditore për energji nga ushqimet e konsumuara.</i>		
ASPEKTET SPECIFIKE TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE		
Njësia mësimore: Lëndët ushqyese që sigurojnë energji		
Fjalët kyçe: <i>karbohidratet, yndyrat, proteinat, energjia.</i>		
Rezultati/et e të nxënit për orë mësimore: <i>Shpjegon lëndët ushqyese që japin energji;</i> <i>Tregon rëndësinë e karbohidrateve;</i> <i>Sqaron rëndësinë e yndyrave dhe proteinave për organizmin.</i>		
Kriteret e suksesit: <i>Emërto lëndët ushqyese që japin energji;</i>		

Përmend si ndahen karbohidratet;

Jep shembuj të ushqimeve që përmbajnë yndyra dhe proteina.

Burimet, mjetet e konkretizimit dhe materialet mësimore: *Libri Biologjia 8, laptop, projektor, fotografi.*

Lidhja me lëndët e tjera mësimore dhe/apo me çështjet ndërkurrikulare dhe situatat jetësore: *Gjuhë dhe komunikim, kimi, gjeografi, ekologjia dhe mjedisi, TIK.*

PËRSHKRIMI I METODOLOGJISË DHE VEPRIMTARITË E PUNËS ME NXËNËS GJATË ORËS MËSIMORE

IMAGJINATË E DREJTUAR

Gjatë kësaj faze, mësimdhënësi/ja u kërkon nxënësve të shikojnë në ekran disa fotografi. Pastaj kërkon nga ta që t'i përcjellin me vëmendje dhe, pasi i kanë përcjellë të gjitha fotot, fillon diskutimin se çfarë paraqesin fotografitë. Duke ditur që nxënësit kishin hulumtuar paraprakisht për ushqimin dhe shëndetin e njeriut, diskutimi do të jetë më i produktiv.

<https://www.youtube.com/watch?v=HPGoyJLIFo>



MBAJTJE E STRUKTURUAR E SHËNIMEVE

Mësimdhënësi/ja paraqet në tabelë një organizues grafik, që thekson veçoritë e lëndëve ushqimore. Nxënësit do të mbajnë shënime për informacionin e duhur, në hapësirat në skicën e grafikut, duke përshkruar dhe analizuar rolin e karbohidrateve, yndyrave, fibrave ushqimore dhe proteinave. Mësuesi/ja kërkon nga nxënësit që të respektojnë plotësimin e kutive në rrugë logjike, pasi të kenë lexuar në dyshe një fragment të caktuar. Është me rëndësi që çdo kuti të ketë të dhëna të caktuara, fakte që ata i gjejnë në tekst dhe i plotësojnë hap pas hapi.

Përfshijnë amidonin, glikogjenin dhe sheqernat e ndryshëm që na japin energji. Sheqernat janë karbohidrate të thjeshta, janë të ëmbël dhe treten lehtë, siç është glukozoza. Ajo kryesisht gjendet në rrush dhe në fruta të tjerë.

Sheqernat e tjerë të rëndësishëm vijnë nga frutat si fruktoza, qumështi si laktoza dhe sheqeri i mjaltit, maltoza

Karbohidratet

**LËNDËT
USHQYESE QË
SIGUROJNË ENERGI**

Yndyrat

Proteinat-

RRJETI I DISKUTIMIT

Pasi nxënësit të kenë plotësuar organizuesin grafik, mësimmshënësi/ja i fton për diskutim lidhur me sqarimet e koncepteve. Fillimisht, fton nxënësit që janë më të tërhequr që të japin mendimet e tyre, pastaj vazhdon me diskutimin, nëse ndonjë sqarim nuk është interpretuar saktë nga nxënësit, atëherë sqarimet përkatëse i jep mësimmshënësi/ja.

VLERËSIMI I NXËNËSVE

Vlerësim për nxënie (informatë kthyesë, vlerësim i ndërsjellë).

DETYRAT DHE PUNA E PAVARUR

Hulumtim: "Lëndët ushqyese që nuk sigurojnë energji".

REFLEKTIM PËR RRJEDHËN E ORËS MËSIMORE

PLANIFIKIMI I ORËS MËSIMORE

ASPEKTET E PËRGJITHSHME TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE

Fusha kurrikulare: Shkencat e natyrës
Klasa: VIII

Lënda: biologji

Shkalla e kurrikulës: IV

Tema (nga plani dymujor):
Ushqimet e njeriut

Rezultati i të nxënit të temës (nga plani dymujor):

*Emërton disa lloje bimore sipas vlerave përdoruese: ushqim, mjekësi, ekonomi etj.
Ushqime të njeriut.
Shpjegon rolin dhe rëndësinë e përbërësve të ushqimit.
Emërton lloje të vitaminave dhe identifikon ushqime më përbërje vitaminoze.*

Rezultatet e të nxënit për kompetencat kryesore të shkallës (të synuara):

III 6. *Ndjek, në mënyrë të pavarur, udhëzimet apo skicat e dhëna në libër, skicë, plan, partiturë muzikore, skenar, koreografi etj., ose të ndonjë burimi tjetër, për të performuar një veprim, aktivitet ose detyrë që kërkohet prej tij/saj.*

V 1. *Vlerëson përmbajtjen dhe vlerat ushqyese të llojeve të ushqimeve, të cilat njeriu i konsumon, duke i kategorizuar ato në bazë të nevojave të individit për to në situata të ndryshme, si: gjatë stinëve, sëmundjeve etj.*

V 2. *Argumenton nevojën e respektimit të regjimit për ushqyerje të shëndetshme dhe rekreacion ditor, javor apo mujor, sipas udhëzimeve të lexuara ose të dëgjua nga mjeku, gjatë një diskutimi në klasë, në shkollë apo në familje.*

Rezultatet e fushës së kurrikulës (të synuara):

Dallon dhe krahason ndërtimin dhe funksionin e qelizës, indeve, organeve dhe sistemeve të organeve, duke iu referuar biodiversitetit të qenieve të gjalla, shkaktarët e sëmundjeve të njeriut, shtazët, bimët dhe mënyrat e kontrollit të tyre, metabolizmin, zhvillimin individual të njeriut dhe evolucionin e qenieve të gjalla.

Shpjegon rolin e karbohidrateve, mineraleve, lipideve, proteinave, vitaminave, ujit dhe fibrave për dietë të shëndetshme dhe llogarit nevojën ditore për energji nga ushqimet e konsumuara.

ASPEKTET SPECIFIKE TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE

Njësia mësimore: Lëndët ushqyese që nuk sigurojnë energji

Fjalët kyçe: *kripërat minerale, vitamina, fibra, ujë.*

Rezultati/et e të nxënit për orë mësimore:

*Shpjegon lëndët ushqyese që nuk japin energji;
Tregon rëndësinë e kripërave minerale, vitaminave;
Sqaron rëndësinë e fibrave dhe ujit për organizmin.*

Kriteret e suksesit:

*Emërto lëndët ushqyese që nuk japin energji
Përmend shembuj të ushqimeve të pasura me vitamina dhe minerale;
Jep shembuj të ushqimeve që përmbajnë fibra dhe sasi më të madhe të ujit.*

Burimet, mjetet e konkretizimit dhe materialet mësimore: *Libri Biologjia 8.*

Lidhja me lëndët e tjera mësimore dhe/apo me çështjet ndërkurrikulare dhe situatat jetësore: *Gjuhë dhe komunikim, Kimi, gjeografi, ekologjia dhe mjedisi, TIK.*

PËRSHKRIMI I METODOLOGJISË DHE VEPRIMTARITË E PUNËS ME NXËNËS GJATË ORËS MËSIMORE

DI / DUA TË DI / MËSOVA

Mësimdhënësi/ja vizaton tabelën “Di / Dua të di / mësova” dhe u kërkon nxënësve që të punojnë të njëjtën në fletoret e tyre. Në kolonën **Di** ata do të shkruajnë çfarë dinë për ushqimet që nuk sjellin energji, duke ditur që ata tashmë kanë informacione, pasi kishin për detyrë shtëpie të bëjnë një hulumtim për ushqimin që nuk sjellë energji. Pasi ta plotësojnë këtë kolonë për disa minuta, u kërkon disa nxënësve që mendimet e tyre t’i shkruajnë në tabelë.

Pataj kërkon nga nxënësit që ta lexojnë tekstin nga libri. Pas leximit, i udhëzon ata që të shkruajnë pyetje në kolonën **Dua të di**, pra, çfarë ata duan të dinë më shumë lidhur me tekstin që lexuan. Ndërsa, për pyetjet që nxënësit kanë shkruar, fillimisht pyeten nxënësit nëse dinë të përgjigjen, pastaj, nëse nuk ka përgjigje, atëherë, mësimdhënësi u jep përgjigje. Kështu nxënësit plotësojnë kolonën **Mësova**.

Di	Dua të di	Mësova

VLERËSIMI I NXËNËSVE

Vlerësim për nxënie (informatë kthyesë, vlerësim i ndërsjellë).

DETYRAT DHE PUNA E PAVARUR

Hulumtim “Ushqimi jo i shëndetshëm dhe jo i rregullt - me pasoja të mëdha”

REFLEKTIM PËR RRJEDHËN E ORËS MËSIMORE

PLANIFIKIMI I ORËS MËSIMORE

ASPEKTET E PËRGJITHSHME TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE		
Fusha kurrikulare: Shkencat e natyrës	Lënda: biologji	Shkalla e kurrikulës: IV
Klasa: VIII		
Tema (nga plani dymujor): Ushqimet e njeriut	Rezultati i të nxënit të temës (nga plani dymujor): <i>Shpjegon pasojat e ushqyeshmërisë jo të rregullt. Hulumton informacione për dietë. Diskuton për rregullat e ushqyeshmërisë në fazat e jetës së njeriut. Identifikon dhe shpjegon për ushqimet jo të shëndetshme.</i>	
Rezultatet e të nxënit për kompetencat kryesore të shkallës (të synuara):		
<p>I 4. Harton një tekst, deri në pesëqind fjalë, duke e vazhduar një rrëfim gojor apo tekst të lexuar paraprakisht, duke u bazuar në imagjinatën e vet.</p> <p>V 1. Vlerëson përmbajtjen dhe vlerat ushqyese të llojeve të ushqimeve, të cilat njeriu i konsumon, duke i kategorizuar ato në bazë të nevojave të individit për to në situata të ndryshme, si: gjatë stinëve, sëmundjeve etj.</p> <p>V 2. Argumenton nevojën e respektimit të regjimit për ushqyerje të shëndetshme dhe rekreacion ditor, javor apo mujor, sipas udhëzimeve të lexuara ose të dëgjuara nga mjeku, gjatë një diskutimi në klasë, në shkollë apo në familje.</p>		
Rezultatet e fushës së kurrikulës (të synuara):		
<p><i>Dallon dhe krahason ndërtimin dhe funksionin e qelizës, indeve, organeve dhe sistemeve të organeve, duke iu referuar biodiversitetit të qenieve të gjalla, shkaktarët e sëmundjeve të njeriut, shtazët, bimët dhe mënyrat e kontrollit të tyre, metabolizmin, zhvillimin individual të njeriut dhe evolucionin e qenieve të gjalla.</i></p> <p><i>Shpjegon rolin e karbohidrateve, mineraleve, lipideve, proteinave, vitaminave, ujit dhe fibrave për dietë të shëndetshme dhe llogarit nevojën ditore për energji nga ushqimet e konsumuara.</i></p>		
ASPEKTET SPECIFIKE TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE		
Njësia mësimore: Ushqimi jo i shëndetshëm dhe jo i rregullt - me pasoja të mëdha		
Fjalët kyçe: <i>energji, shëndet, vitamina, fibra, drithëra, fruta, kolesterol, arteroskleroza.</i>		
Rezultati/et e të nxënit për orë mësimore:		
<p><i>Shpjegon konceptin ushqim i shëndetshëm;</i></p> <p><i>Specifikon rëndësinë e të ushqyerit të shëndetshëm;</i></p> <p><i>Sqaron mënyrat e të ushqyerit të një adoleshenti.</i></p>		
Kriteret e suksesit:		
<i>Përpilo një dietë të shëndetshme (të paktën një ditë - tri shujta ditore);</i>		

*Numëro disa çrregullime që mund të vijnë nga kequshqyerja;
Përmend ushqimet që duhet të përdoren në fazën e pubertetit.*

Burimet, mjetet e konkretizimit dhe materialet mësimore: *Libri Biologjia 8, tabela.*

Lidhja me lëndët e tjera mësimore dhe/apo me çështjet ndërkurrikulare dhe situatat jetësore: *Gjuhë dhe komunikim, kimi.*

PËRSHKRIMI I METODOLOGJISË DHE VEPRIMTARITË E PUNËS ME NXËNËS GJATË ORËS MËSIMORE

PARASHIKIMI ME TERMAT PARAPRAKË

Përpara fillimit të mësimit, mësimehmënësi/ja zgjedh disa fjalë kryesore, si: lëndë ushqimore, karbohidrate, proteina, vitamina, dieta ditore, qeliza, energji bimore, shtazore, drithëra, fruta, organizmi dhe i shkruan ato në tabelë. Mësimehmënësi/ja u kërkon nxënësve që të punojnë në dyshe për të shkruar një paragraf apo një ese që mund të lidhet me përdorimin e këtyre fjalëve. Pas 5 minutash, nxënësit lexojnë para klasës tregimin (tekstin) esenë e shkruar, ku janë përdorur fjalët e mësipërme. Mësuesi/ja i porositi nxënësit që të dëgjojnë me vëmendje pjesën që ka përgatitur shoku, duke përdorur të njëjtat terma paraprakë dhe më pas t'i krahasojë me ato që kanë krijuar vetë ata.

LEXIMI I IMËT ME KODIM TEKSTI

Mësimehmënësi/ja u kërkon nxënësve ta lexojnë mësimin në dyshe dhe përcakton kodet, të cilat janë: (P) - përkufizim, (Sh-P) shkak - pasojë, (I) – interpretim, (K) - krahasim. I orienton nxënësit që të vendosin shenjat në tekst, pas një leximi të kujdesshëm. Dhe pastaj të përkatësojnë konceptet njëra me tjetrën. P.sh.: “Një çrregullim i madh nga ushqimi jo i rregullt është dhe anoreksia: anoreksikët kanë humbje të rëndë oreksi për të ngrënë, shkaqet e së cilës janë emocionale.”

P - anoreksia një çrregullim i madh i ngrëniës së ushqimit.

Sh-P - gjendja emocionale, humbje të peshës etj.

RRJETI I DISKUTIMIT

Mësimehmënësi/ja u udhëzon nxënësit që të fillojnë diskutimin lidhur me temën. Pra, i fton nxënësit për të diskutuar shembujt e tyre. Diskutimi bëhet në formë gare, nxënësit garojnë njëri me tjetrin për gjetjen e shembujve më të mirë.

VLERËSIMI I NXËNËSVE

Vlerësim për nxënie (informatë kthyese, vlerësim i ndërsjellë).

DETYRAT DHE PUNA E PAVARUR

REFLEKTIM PËR RRJEDHËN E ORËS MËSIMORE

PLANIFIKIMI I ORËS MËSIMORE

ASPEKTET E PËRGJITHSHME TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE		
Fusha kurrikulare: Shkencat e natyrës Klasa: VIII	Lënda: biologji	Shkalla e kurrikulës: IV
Tema (nga plani dymujor): Shëndeti, sjelljet dhe emocionet e njeriut	Rezultati i të nxënit të temës (nga plani dymujor): <i>Shpjegon ndërtimin dhe funksionin e organeve riprodhuese dhe kupton proceset si menstruacioni, spermatogjeneza, ovulimi dhe fertilizimi.</i>	
Rezultatet e të nxënit për kompetencat kryesore të shkallës (të synuara):		
IV 1. <i>Vlerëson rëndësinë e punës individuale dhe në grupe, për zhvillimin e komunitetit, duke paraqitur, në forma të ndryshme të të shprehurit, shembuj konkretë nga jeta e përditshme.</i>		
V 7. <i>U shpjegon moshatarëve, me forma dhe mjete të ndryshme të komunikimit, rëndësinë e identifikimit të personave dhe shërbimeve kompetente, veç e veç, të nevojshme për mbështetje në situata që konsiderohen potencialisht të rrezikshme për shëndetin fizik dhe mendor.</i>		
VI 8. <i>Përshkruan, në forma të ndryshme të të shprehurit, procedurat dhe institucionet përgjegjëse për hartimin dhe ndryshimin e ligjeve, duke argumentuar domosdoshmërinë e zbatimit të tyre në jetën e përditshme.</i>		
Rezultatet e fushës së kurrikulës (të synuara):		
<i>Dallon dhe krahason ndërtimin dhe funksionin e qelizës, indeve, organeve dhe sistemeve të organeve, duke iu referuar biodiversitetit të qenieve të gjalla, shkaktarët e sëmundjeve të njeriut, shtazët, bimët dhe mënyrat e kontrollit të tyre, metabolizmin, zhvillimin individual të njeriut dhe evolucionin e qenieve të gjalla.</i>		
<i>Shpjegon rolin e karbohidrateve, mineraleve, lipideve, proteinave, vitaminave, ujit dhe fibrave për dietë të shëndetshme dhe llogarit nevojën ditore për energji nga ushqimet e konsumuara.</i>		
ASPEKTET SPECIFIKE TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE		
Njësia mësimore: Ndërtimi dhe funksioni i organeve riprodhuese të njeriut		
Fjalët kyçe: <i>spermë, organ gjenital, marrëdhënia seksuale, shtatzënia, periudha menstruale.</i>		
Rezultati/et e të nxënit për orë mësimore:		
<i>Shpjegon ndërtimin e organeve riprodhuese të mashkullit dhe të femrës të njeriut;</i>		
<i>Përshkruan spermatogjenezën, ovulimin dhe pllenimin, fertilizimin;</i>		
<i>Kupton rëndësinë e vetëkontrollit të trupit dhe di ku duhet të drejtohet për të marrë këshilla dhe ndihmë.</i>		
Kriteret e suksesit:		
<i>Emërto ndërtimin e organeve riprodhuese të mashkullit dhe të femrës të njeriut;</i>		
<i>Veço karakteristikat e spermatogjenezës, ovulimin dhe pllenimin, fertilizimin;</i>		

Dallo mënyrat e vetëkontrollit të trupit dhe gjej disa vende ku duhet të drejtohemi për të marrë këshilla dhe ndihmë adekuate.

Burimet, mjetet e konkretizimit dhe materialet mësimore: *Libri Biologjia 8, tabela.*

Lidhja me lëndët e tjera mësimore dhe/apo me çështjet ndërkurrikulare dhe situatat jetësore: *Gjuhë dhe komunikim, kimi, TIK.*

PËRSHKRIMI I METODOLOGJISË DHE VEPRIMTARITË E PUNËS ME NXËNËS GJATË ORËS MËSIMORE

STUHI MENDIMESH

Mësimdhënësi/ja shkruan në tabelë titullin “Ndërtimi dhe funksioni i organeve riprodhuese të njeriut” dhe u kërkon nxënësve të shpalosin njohuritë e tyre lidhur me temën, duke u bazuar në njohuritë e tyre paraprake që kanë marrë nga klasa e 7-të.

TABELA E KONCEPTEVE

Mësimdhënësi-ja i udhëzon nxënësit që të lexojnë njësinë mësimore dhe pastaj të plotësojnë tabelën e koncepteve, në bashkëpunim me shokun/shoqen e bankës, si më poshtë:

Konceptet	Shpjegimi
<i>Organet gjenitale të mashkullit</i>	
<i>Organet gjenitale të femrës</i>	
<i>Si ndodh pllenimi (fekondimi, fertilizimi)</i>	
<i>Periudha menstruale</i>	
<i>Kujdesi për shëndetin dhe vizita te gjinekologu është domosdoshmëri.</i>	

RRJETI I DISKUTIMIT

Mësimdhënësi/ja i udhëzon nxënësit që të fillojnë diskutimin, duke përdorur shpjegimet e koncepteve që kanë bërë më parë, pra, fton nxënësit për të diskutuar gjetjet e tyre.

VLERËSIMI I NXËNËSVE

Vlerësim për nxënie (informatë kthyesë, vlerësim i ndërsjellë).

DETYRAT DHE PUNA E PAVARUR

REFLEKTIM PËR RRJEDHËN E ORËS MËSIMORE

PLANIFIKIMI I ORËS MËSIMORE

ASPEKTET E PËRGJITHSHME TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE	
Fusha kurrikulare: Shkencat e natyrës Lënda: biologji Shkalla e kurrikulës: IV Klasa: VIII	
Tema (nga plani dymujor): Shëndeti, sjelljet dhe emocionet e njeriut	Rezultati i të nxënit të temës (nga plani dymujor): <i>Përshkruan metodat tradicionale dhe moderne kontraceptive. Kupton rëndësinë, mënyrat e vetëkontrollit të trupit dhe di ku duhet të drejtohet për të marrë këshilla dhe ndihmë.</i>
Rezultatet e të nxënit për kompetencat kryesore të shkallës (të synuara): III 7. <i>Shfrytëzon në mënyrë të efektshme teknika të ndryshme gjatë të nxënit të temës së dhënë, duke veçuar informatat që i kupton nga informatat e reja, të panjohura, si dhe informatat që për të mbeten ende të paqarta.</i> V 8. <i>Përshkruan mundësitë, rreziqet dhe pasojat e infeksioneve dhe sëmundjeve seksualisht të transmetueshme dhe sqaron mënyrat dhe mjetet për parandalimin e tyre, duke përdorur forma të ndryshme të prezantimit (të folur, të shkruar, grafike, pllakate, pamflete, lojë teatrale, performancë artistike etj.).</i> VI 1. <i>Praktikon të drejtat dhe detyrimet e qytetarisë në situata konkrete jetësore të përditshme, qoftë në klasë, qoftë në shkollë apo gjetiu (si: gjatë diskutimit, respektimit të mendimit të tjetrit etj.).</i>	
Rezultatet e fushës së kurrikulës (të synuara): <i>Dallon dhe krahason ndërtimin dhe funksionin e qelizës, indeve, organeve dhe sistemeve të organeve, duke iu referuar biodiversitetit të qenieve të gjalla, shkaktarët e sëmundjeve të njeriut, shtazët, bimët dhe mënyrat e kontrollit të tyre, metabolizmin, zhvillimin individual të njeriut dhe evolucionin e qenieve të gjalla. Shpjegon rolin e karbohidrateve, mineraleve, lipideve, proteinave, vitaminave, ujit dhe fibrave për dietë të shëndetshme dhe llogarit nevojën ditore për energji nga ushqimet e konsumuara.</i>	
ASPEKTET SPECIFIKE TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE	
Njësia mësimore: Metodat dhe mjetet e parandalimit të shtatzënisë dhe sëmundjeve seksualisht të transmetueshme (kontraktivët)	
Fjalët kyçe: <i>kontraktivë, metodat kontraceptive natyrale, mekanike, hormonale, ovulacioni.</i>	
Rezultati/et e të nxënit për orë mësimore: <i>Shpjegon funksionin e kontraktivëve; Përshkruan secilën metodë të kontraktivëve; Analizon rëndësinë e përdorimit të kontraktivëve.</i>	

Kriteret e suksesit:

Emërto mënyrat e kontracepsionit;

Krahaso metodën e kontrceptive mekanike me kontraktivë hormonalë;

Veç metodën më të mirë të sigurt të kontracepsionit.

Burimet, mjetet e konkretizimit dhe materialet mësimore: *Libri Biologjia 8, tabela.*

Lidhja me lëndët e tjera mësimore dhe/apo me çështjet ndërkurrikulare dhe situatat

jetësore: *Gjuhë dhe komunikim, kimi.*

PËRSHKRIMI I METODOLOGJISË DHE VEPRIMTARITË E PUNËS ME NXËNËS GJATË ORËS MËSIMORE

STUHI MENDIMESH

Mësimdhënësi/ja shkruan në tabelë titullin “Metodat dhe mjetet e parandalimit të shtatzënisë dhe sëmundjeve seksualisht të transmetueshme (kontraktivët)”, dhe u kërkon nxënësve që fillimisht të mendojnë për temën, pastaj të shpalosin njohuritë e tyre, duke diskutuar së bashku.

DRTA

Në vijim, mësimdhënësi/ja u shpjegon nxënësve procedurën, e cila do të zhvillohet si më poshtë:

Hapet teksti në temën mësimore “Metodat dhe mjetet e parandalimit të shtatzënisë dhe sëmundjeve seksualisht të transmetueshme (kontraktivët)” dhe u kërkon nxënësve që të lexojnë dhe më pas t’i mbyllin librat dhe ta komentojnë atë që lexuan. Kështu veprohet me pjesë të ndara të librit: fillimisht fillohet me paragrafin “Kur mund të mbetet një vajzë shtatzënë?”, mbyllen librat, komentohet ajo që u lexua, dhe pastaj vazhdohet me pjesën tjetër, duke realizuar të njëjtën formë të punës deri në përfundim të tekstit.

(Gjatë diskutimit përdoren fotografite nga libri ose edhe të zgjedhura nga interneti, për mjetet kontrceptive.)

KLLASTER

Pasi nxënësit kanë lexuar dhe komentuar njësinë mësimore, mësimdhënësi/ja i fton ata të punojnë një kllaster në formë të përmbledhjes, fillimisht punojnë në grupe. Pastaj mësimdhënësi/ja i fton ata që të njëjtin ta punojnë edhe në tabelë, duke bashkëpunuar njëri me tjetrin.

VLERËSIMI I NXËNËSVE

Vlerësim për nxënie (informatë kthyese, vlerësim i ndërsjellë).

DETYRAT DHE PUNA E PAVARUR

Hulumtim: “Përdorimi i drogave me pasoja të mëdha”.

REFLEKTIM PËR RRJEDHËN E ORËS MËSIMORE

PLANIFIKIMI I ORËS MËSIMORE

ASPEKTET E PËRGJITHSHME TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE		
Fusha kurrikulare: Shkencat e natyrës Klasa: VIII	Lënda: Biologji	Shkalla e kurrikulës: IV
Tema (nga plani dymujor): Shëndeti, sjelljet dhe emocionet e njeriut	Rezultati i të nxënit të temës (nga plani dymujor): <i>Diskuton ndikimin e alkoolit dhe drogave në sjelljen e vendimeve të përgjegjshme.</i>	
Rezultatet e të nxënit për kompetencat kryesore të shkallës (të synuara):		
<p>V 9. <i>Reagon ndaj sjelljeve asociale të moshatarëve, duke identifikuar shkaqet e shfaqjes dhe pasojat e mundshme për shëndetin dhe mirëqenien e individit nga dukuritë dhe shprehjet negative (p.sh., përdorimi i duhanit, i alkoolit apo drogës etj.).</i></p> <p>VI 5. <i>Reagon me maturi ndaj sjelljeve apo veprimeve jo të mira që ndodhin në klasë/shkollë apo jashtë saj, promovon sjelljet dhe veprimet e mira, duke vënë në pah shkaqet dhe pasojat e manifestimit të tyre për individin dhe për të tjerët.</i></p> <p>VI 1. <i>Praktikon të drejtat dhe detyrimet e qytetarisë në situata konkrete jetësore të përditshme, qoftë në klasë, qoftë në shkollë apo gjetiu (si: gjatë diskutimit, respektimit të mendimit të tjetrit etj.).</i></p>		
Rezultatet e fushës së kurrikulës (të synuara):		
<p><i>Dallon dhe krahason ndërtimin dhe funksionin e qelizës, indeve, organeve dhe sistemeve të organeve, duke iu referuar biodiversitetit të qenieve të gjalla, shkaktarët e sëmundjeve të njeriut, shtazët, bimët dhe mënyrat e kontrollit të tyre, metabolizmin, zhvillimin individual të njeriut dhe evolucionin e qenieve të gjalla.</i></p> <p><i>Shpjegon rolin e karbohidrateve, mineraleve, lipideve, proteinave, vitaminave, ujit dhe fibrave për dietë të shëndetshme dhe llogarit nevojën ditore për energji nga ushqimet e konsumuara.</i></p>		
ASPEKTET SPECIFIKE TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE		
Njësia mësimore: Përdorimi i drogave me pasoja të mëdha për organizmin		
Fjalët kyçe: <i>drogë, varësia, rrezikshmëri, trajtim mjekësor, heroina.</i>		
Rezultati/et e të nxënit për orë mësimore:		
<p><i>Shpjegon shkaqet që dërgojnë në përdorimin e drogave;</i></p> <p><i>Tregon veprimet e drogave të ndryshme;</i></p> <p><i>Përshkruan format e parandalimit të përdorimit të drogave.</i></p>		
Kriteret e suksesit:		
<p><i>Listo arsyet pse individët përdorin droga;</i></p> <p><i>Krahaso efektet e përdorimit të kokainës dhe të nikotinës;</i></p> <p><i>Vlerëso ndikimin e shogërisë në përdorimin e substancave narkotike.</i></p>		
Burimet, mjetet e konkretizimit dhe materialet mësimore: <i>Libri Biologjia 8, tabela.</i>		

Lidhja me lëndët e tjera mësimore dhe/apo me çështjet ndërkurrikulare dhe situatat jetësore: *Gjuhë dhe komunikim, kimi.*

PËRSHKRIMI I METODOLOGJISË DHE VEPRIMTARITË E PUNËS ME NXËNËS GJATË ORËS MËSIMORE

DISKUTIM PARAPRAK

Mësimdhënësi/ja i orienton nxënësit për të mbledhur informacione prej tyre, bazuar në njohuritë që ata kanë nga burime të ndryshme të informacionit, lidhur me ndikimin e drogave, siç është heroina, në organizmin tonë dhe pasojat që sjell konsumimi i saj për individin, familjen dhe shoqërinë.

Mësimdhënësi/ja drejton pyetjet:

- *A ka midis jush që ka provuar të konsumojë ndonjë prej llojeve të drogave?*
- *Po ndonjë shok apo mik juaj, a e konsumon drogën?*
- *Nëse po, cilat janë shenjat apo simptomat që i shkakton përdorimi i drogës?*

VLD (VEPRIMTARI ME LEXIM TË DREJTUAR)

Në vijim mësimdhënësi/ja u shpjegon nxënësve procedurën, i udhëzon nxënësit që, pasi ta lexojnë temën mësimore me vëmendje, të nxjerrin përfundime mbi të, duke u shërbyer me pyetjet, si:

Si fillohet të përdoret droga?

Cilat janë shenjat e tërheqjes?

Cilët konsiderohen shkaktarët e përdorimit të drogave?

Cilat janë drogat e lejuara dhe cili është ndikimi i tyre?

Cilat janë drogat e palejuara dhe cili është ndikimi i tyre?

Si duhet të jetë "ndihma e parë" për përdoruesit e drogës?

KLLASTER

Pasi nxënësit kanë lexuar dhe komentuar njësinë mësimore, mësimdhënësi/ja i fton ata të punojnë një kllaster në formë të përmbledhjes, fillimisht punojnë në grupe. Pastaj mësimdhënësi/ja i fton ata që të njëjtin ta punojnë edhe në tabelë, duke bashkëpunuar njëri me tjetrin.

VLERËSIMI I NXËNËSVE


Vlerësim për nxënie (informatë kthyese, vlerësim i ndërsjellë).

DETYRAT DHE PUNA E PAVARUR


REFLEKTIM PËR RRJEDHËN E ORËS MËSIMORE

Test vlerësues

1. Defino termin qelizë.
2. Krahaso qelizën eukariote me qelizën prokariote.
3. Veço të përbashkëtat dhe dallimet në mes të qelizës bimore dhe shtazore.



4. Identifiko pjesët e qelizës, duke u bazuar në fotografi:



5. Emërto indet kryesore shtazore.
6. Sqaro si riprodhohen sfungjerët.
7. Përshkruaj mënyrën e marrjes së ushqimit te grykorët.
8. Vlerëso rolin e higjienës së lëkurës (posaçërisht të duarve), për t'i evituar sëmundjet e sistemit tretës.
9. Krahaso qarkullimin e gjakut te butakët dhe te krimbat unazorë.
10. Analizo rëndësinë e ekzoskeletit te insektet.

Vlerësimi	0-39	40-59	60-79	80-89	90-100
Pikët					